

RAMADAN QEHAJA

# TË BËSH NJË KARRIERË USHTARAKE





RAMADAN QEHAJA

TË BËSH NJË  
KARRIERË  
USHTARAKE

**Ramadan Qehaja**  
**“Të bësh një karrierë ushtarake”**

Recensues  
**Halil Matoshi**  
**Vesel Latifi**

Lektor  
**Qemajl Kallaba**

Realizimi kompjuterik dhe kopertina  
**Refresh**

**Prishtinë, 2012**

# PËRMBAJTJA

Hyrje .....	12
<b>PJESA E PARË FËMIJËRIA IME .....</b>	<b>14</b>
Në kërkim të ekzistencës .....	19
Fillimi i një shkollimi ushtarak .....	24
Fillimi i ngritjes profesionale - ushtarake .....	26
<b>PJESA E DYTË FILLIMI I NGRITJES PROFESIONALE-USHTARAKE .....</b>	<b>30</b>
Kadet i Akademisë Ushtarake .....	34
Fillimi i karrierës si oficer .....	40
<b>PJESA E TRETË MARTESA DHE ANGAZHIMI IM NË UNIVERSITET .....</b>	<b>42</b>
Demonstratat e vitit 1968 .....	44
Angazhimi në procesin mësimor në UP .....	45
<b>PJESA E KATËRT NGRITJA E MËTEJME NË PLANIN USHTARAK .....</b>	<b>48</b>
Amendamentet Kushtetuese dhe Kosova .....	50
Përgatitjet për transferim nga Beogradi .....	52
<b>PJESA E PESTË MBROJTJA E TEMËS SË DIPLOMË DHE TRANSFERIMI .....</b>	<b>56</b>
Organizimi i ushtrimit demonstrues dhe afirmimi .....	58
Përgatitja dhe zbatimi i një ushtrimi të madh taktik .....	59
<b>PJESA E GJASHTË TRANSFERIMI NË PRISHTINË DHE AVANCIMET E MËTEJME .....</b>	<b>62</b>
Shkollimi në Shkollën e Mbrojtjes Nacionale (SHMN) .....	65
Shpërthimi i demonstratave të marsit '81 dhe pozicioni im .....	67
Shpëtimi nga burgosja .....	70
<b>PJESA E SHTATË EMËRIMI NË MBROJTJEN TERRITORIALE .....</b>	<b>74</b>
Puna e mëtejme në Mbrojtjen Territoriale dhe ballafaqimi me nacionalizmin serb ...	80
<b>PJESA E TETË TRANSFERIMI NË GARNIZONIN E ZAJEÇARIT .....</b>	<b>84</b>
Shkuarja në Zajeçar dhe përgatitja për pranimin e detyrës së re .....	86
Rasti i Paraçinit .....	86
<b>PJESA E NËNTË VEPRIMTARIA IME NË NJË SITUATË, THUAJA SE, TË LUFTËS .....</b>	<b>90</b>
Ballafaqimi i sërishëm me organet e Sigurimit Ushtarak .....	93
Transferimi në Beograd në detyrë të mësimdhënies .....	95
<b>PJESA E DHJETË TRANSFERIMI NË PRISHTINË DHE KTHIMI I SËRISHËM NË MBROJTJEN TERRITORIALE .....</b>	<b>96</b>
Obstruksionet dhe mënjanimi im nga detyrat zyrtare .....	99
Pensionimi im nga Forcat e Armatosura të Jugosllavisë .....	100
<b>PJESA E NJËMBËDHJETË PERIUDHA PAS PENSIONIMIT .....</b>	<b>102</b>
Takimi me Hajzer Hajzerajn .....	104
Rreziqet për burgosje të mundshme .....	106
<b>PJESA E DYMBËDHJETË ANGAZHIMI NË BIZNES PRIVAT .....</b>	<b>110</b>
Inkuadrimi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës .....	118
<b>PJESA E TREMBËDHJETË ANGAZHIMI NË ZYRËN E KOORDINATORIT TË TMK-së ...</b>	<b>126</b>
Angazhimi im i rastësishëm në Qeveri .....	128
Aktiviteti në Shoqërinë Civile .....	132
<b>FOTOGALERIA .....</b>	<b>134</b>
<b>FAKTOGRAFIA .....</b>	<b>152</b>



***Nënës sime që më ngriti, edukoi dhe aq shumë më deshi.  
Bashkëshortës sime që në pjesën më të madhe  
të rrugëtimit tim, më përcolli dhe përkrahi.***

**PARATHËNIE**



Janë shumë arsye që më kanë shtyrë të shkruaj një autobiografi. E para ka të bëjë me karrierën time të bujshme, e cila kaloi nëpër disa etapa sfiduese e që e bën përshkrimin e jetës time interesant për lexuesin. E dyta ka të bëjë me kërkesat e shumë miqve të mi, të cilët, në vazhdimësi, më kërkuan që të gjitha aktivitetet e mia jetësore, në vija të gjera, t'i shpalosi në këtë autobiografi. Dhe, disa vite më parë, vendosa me kënaqësi që të punoj në drejtim të finalizimit të kësaj autobiografie, me qëllim që të konkretizoj në vjeshtën e vitit 2012, me rastin e ditëlindjes sime të 70-të. I bindur se ky ishte moment më i mirë që t'i përmbledh përvojat e mia në një libër të vetëm, megjithatë këto përbëjnë momentet kyçe të zhvillimit të karrierës sime dhe assesit të gjitha nivelet dhe detajet. Kjo për arsye se do të kërkonte shumë mund dhe kohë që unë t'i detajoja tutje disa ngjarje aq më parë që kjo do të ishte ndoshta edhe ngarkesë për lexuesin. E kur flasim për lexuesin, pikërisht këtu jam kujdesur me përpikëri. Kam dashur që t'i shtjelloj disa momente kyçe të karrierës sime, që konsistojnë jodomsdoshmërisht vetëm me sfidat e ngritjes sime, mirëpo që gjithsesi ndërldihen me procese sociale e politike. Si ushtarak, gjithsesi se i nënshtrohesh ndryshimeve të konstelacioneve politike e sidomos në rajon e vendin tonë. Mirëpo, gjitha këto e bëjnë edhe më interesante ngritjen time.

Gjatë shkrimit të këtij libri, kam përdorur një metodologji që kryesisht përdoret për një autobiografi. Në vazhdimësi kam mbledhur dhe reflektuar mbi ngjarjet në të kaluarën, sepse fjala është për një periudhë të gjatë kohore. Kujtesa ime ishte ajo që bëri formësimin e kësaj autobiografie, sepse shumicën e ngjarjeve i mbaj mend me kthjelltësi, kurse disa të tjera më kujtoheshin si rezultat i shtjellitimit të ngjarjeve në kontekst. Në fakt, të gjitha rastet që i kam paraqitur janë bërë prej prizmit të biografisë interpretuese, ku kam paraqitur ngjarjet nga perspektiva subjektive, në këtë rast bazuar në reflektimet e mia personale. Pavarësisht se jam munduar maksimalisht që t'i përfshij në mënyrë complete disa ngjarje kyçe, ka pasur mundësi që disa elemente të më kenë ikur apo edhe ndoshta të kem harruar përmendjen e disa personave. Por, edhe në disa raste, qëllimisht nuk i kam përmendur disa emra e mbi të gjitha disa ngjarje, mbase të rënda, i kam shmangur sepse nuk kam dashur t'i përfshij në këtë libër.

Sidoqoftë, mospërmendja e këtyre ngjarjeve dhe këtyre individëve nuk e përjashton qëndrimin tim negativ që kam shprehur në vazhdimësi.

Libri është i strukturuar në mënyrë kronologjike, sepse kësisoj lexuesi do ta kuptojë zhvillimin e karrierës sime në kontekst të zhvillimeve të periudhave të ndryshme. Unë pres që kjo autobiografi t’u shërbejë gjeneratave të ardhshme për të vlerësuar zhvillimin tim të karrierës që është po aq i bujshëm aq edhe sfidues. Librin e kam titulluar qëllimisht “Të bësh një karrierë ushtarake” ngase gati gjysmë shekulli të jetës sime ia kam kushtuar ushtrisë dhe çështjeve të sigurisë. Autobiografia ime sadopak mbulon boshllëkun e librave në këtë sferë dhe padyshim se hyn në kategorinë e librave të historisë ushtarake. Madje, zhvillimi i karrierës time dhe vet faktet e ofruara në këtë libër konfirmojnë një çështje madhore – se Kosova ka pasur identitetin e vet edhe në sferën ushtarake e të sigurisë dhe i ka mbijetuar në momente dhe periudha të ndryshme politike e historike. Gjithsesi se mbetet në lexuesin ta vlerësojë.

*Autori*

## *Falenderime*

*Janë shumë persona qe më kanë ndihmuar në formësimin e librit tim. I jam të gjithëve mirënjohës pa dallim dhe cmoj kontributin e tyre. Megjithatë, do të doja të i veçoja disa të cilët vërtetë u përkushtuan: fillimisht falënderoj Skender Përteshin për kontributin e dhënë në formësimin teknik të librit në versionin e parë si dhe përmirësimet e ndryshimet e bëra më pas. Falënderoj Profesor Qemajl Kallabën për lekturimin e bërë pjesës më të madhe të tekstit të formësuar dhe të disa ndërhyrjeve si dhe z. Safet Zejnullahut për lekturim shtesë e sygjerrime të çmuara. Tutje, falenderim i takonë Shpend Reçicës për angazhimin e pashoq në strukturimin dhe faqosjen fillestare të teksit. Kuptohet se e veçoj kontributin e Florian Qehajës (djalit tim) dhënë në forma udhëzimeve metodologjike, të sugjerimeve si dhe për nevojën e përfshirjes së disa ngjarjeve e ndodhive që ishin të domosdoshme të përfshihen në tekst bazuar në observimet e tij duke qenë afër meje sidomos në periudhën e pasluftës.*

## Recension

Libri autobiografik “Të bësh një karrierë ushtarake” i Ramadan Qehajës është një biografi e menduar personale, por ajo në sfond flet për jetën dhe trajtimin e shqiptarëve etnik nën regjimin komunist të Federatës Jugosllave, përgjatë gjysmës së dytë të shekullit 20, deri në pavarësimin e Kosovës.

Jeta, shkollimi fillor e pastaj ai i mesëm ushtarak deri në ngritje në majat e hierarkisë ushtarake të Armatës Popullore të Jugosllavisë është një përshkrim interesant i autorit Ramadan Qehaja, përmes të cilit shkruhet një histori e ringjalljes dhe ngritjes së shqiptarëve në ish Jugosllavi. Nga nënçmimi deri te pranimi; Nga shpërfillja deri te ndjekja; Nga “ikja” deri te kryengritja; Nga lufta deri te paqja...

Suksesi i një të riu shqiptar nga Kosova nën Jugosllavi nuk ishte vetëm sukses personal, ngase secili sukses personal dëshmonte edhe për gjendjen dhe perspektivat e shqiptarëve si tërësi, që të shumtën, gjatë periudhës 1956-1966 i ishin nënshtruar regjimit policor të Aleksandar Rankoviçit, Ministër i Brendshëm, i cili me masa represive të terrorit shtetëror i kishte shndërruar shqiptarët në qytetarë të rendit të dytë në shtetin e përbashkët federal.

Libri është i shkruar thjeshtë dhe qartë, ndonëse lexuesi i etur për të mësuar më shumë informata nga një epror i lartë i ushtrisë jugosllave do të priste më shumë, posaçërisht për periudhën e demonstratave të vitit 1968 për ‘Pranverën e vitit 1981’ dhe mbi të gjitha për të ashtuquajturin “Proces i Paraqinit”, ngase Qehaja ka qenë në inspektim në kazermën e Paraqinit menjëherë pas incidentit që kishte ndodhur më 4 shtator të vitit 1987. Dëshmia e Qehajës është mjaft interesante për të hulumtuar më tej këtë ngjarje tragjike, që morri pesë jetë njerëzore, katër të plagosur dhe si pasojë edhe “prodhoi” mbi një shekull burg për kinse të involvuarit në të.

Por dëshmia e Qehajës nbetët e turbullt dhe jo e hulumtuar në detaje. Sidoqoftë me një fjali autori sikur dëshmon se incidenti ishte i inskenuar nga KOS-i (Shërbimi Kundërinformativ i Ushtrisë Jugosllave.)

Autori shkruan: *“Papritmas, m’u ofrua një ushtar dhe m’u drejtua më këto fjalë: “Shok kolonel, merreni me mend, po të mos më urdhëronte kapteri që ta ndërroja krevatin e fjetjes (duke më treguar krevatin ku ishte i vrarë një ushtar e që më parë kishte qenë krevati i tij), sot do të isha i vrarë”. Në pyetjen time se pse e kishte urdhëruar eprori që ta ndërronte krevatin, ai nuk pati përgjigje. Kjo dhe çështje të tjera ma shtuan dyshimin se kjo ngjarje nuk kishte ndodhur rastësisht, por si duket ishte përgatitur mirë e me plan vetëm e vetëm që në vrasje të përfshihen, përveç serbëve, edhe nacionalitetet e tjera”.*

Ky rrëfim i ushtarakut të lindur në Kranidell të Kamenicës, Ramadan Qehaja, është interesant edhe për sa u përket dëshmimeve të tij lidhur me mënyrën e transformimit të ish UÇK-së në TMK dhe themelimit të Akademisë së saj të cilën e kishte ideuar vet ai, por që ishte “përrjashtuar” nga komandimi i saj pa asnjë shpjegim nga komandanti i kësaj trupe Agim Çeku. Qehaja flet edhe për trajtimin e parasyeshëm dhe joprofesional, madje shpesh cinik e johuman të oficerëve të karrierës nga disa komandantë të UÇK-së. Njëkohësisht autori rrëfen edhe për keq-menaxhimin e vendit nga administrata e UNMIK-ut dhe paqartësitë në shtetndërtim.

Me pak fjalë, ky libër autobiografik flet për një shqiptar etnik nën ish Jugosllavinë, nën trysni të vazhdueshme ekonomike e politike; për ngritjet dhe rëniet e tij në një regjim që shqiptarët i donte ose të nënshtruar (sharaxhi!?), spiunë ose të vdekur, por jo konkurrues, të barabartë dhe me integritet moral e profesional. Sëkëndejmi vlerësoj se ky libër e pasuron fondin e autobiografive në shkrimin shqip në Kosovë dhe sjell të dhëna me interes për lexuesin por shërben edhe si referencë për historiografinë e Kosovës.

*Në Prishtinë, 3 korrik 2012*

**Halil Matoshi**

## Hyrje

Libri ngërthen në vete ngjarje dhe momente të shumta gjatë periudhave të ndryshme kohore, në të cilat kam jetuar e vepruar. Ka reflektim të ngjarjeve që nga fëmijëria e hershme e imja e deri në ditët e sotit. Në fakt, i gjithë zhvillimi im i karrierës kalon nëpër faza shumë sfiduese i cili gjithsesi se ndërlidhen me faktorët social-ekonomik në familje e deri të sfidat politike. Kjo tregon edhe implikimet anësore në ngritjen time profesionale e që gjithsesi se patën vend të theksuar.

Gradimet nëpër të cilat kam kaluar duke filluar nga ato të nivelit më të ulët taktik e deri te ato të nivelit operativo-strategjik në fakt ishin cikle të ngritjes konform detyrave të ushtruara kryesisht të karakterit komandues-drejtues. Nuk pati asnjë, ta quaj, dhurim për çkado qoftë por vetëm ngritje në bazë të punës, aktivitetit dhe prirjeve të mia si ushtarak. Me fjalë të tjera, isha një ndër të rrallët që kalova nëpër të gjitha ciklet e ngritjes dhe gradimit.

Dhe rrjedhimisht, në të kaluarën e afërt, mbase isha një ndër të vetmit në Trupat Mbrojtëse të Kosovës që isha i kyçur me njohurit superiore ushtarake dhe vija nga një pozicion shumë i lartë që i përkiste gradës së gjeneral majorit. Mirëpo përkundër tentimeve të mia (sidomos në detyrën e komandantit të Akademisë së Mbrojtjes por edhe në shtabin e përgjithshëm të TMK-së) që të avancoj këtë trupë në nivel më të lartë që në start isha jo mjaft i përkrahur, i penguar dhe nganjëherë i keqkuptuar. S'do mend se po të mos ishte ky fakt, kontributi im në sferën e sigurisë së Kosovës në tërësi, do të ishte akoma më i theksuar. Kuptohet se në bazë të aktivitetit tim vetanak në forma të ndryshme, e që i kam përshkruar në disa kapituj të librit, kontributi im për çështjet e sigurisë së vendit tonë, nuk mund të mos vlerësohet pozitivisht.

Ngase memoaret e paraqitura në këtë libër janë shkruar në kontekst, vlen të theksoj se periudhat kyçe të zhvillimit tim janë elaboruar në këto periudha: fëmijëria ime e hershme dhe vështirësitë socio-ekonomike; regjistrimi në shkollën e mesme ushtarake në Sarajevë; marrja e titullit nënoficer si dhe fillimi i detyrave në Travnik; përfundimi i Akademisë Ushtarake në Beograd si dhe marrja e titullit nëntoger; detyrat ushtarake në Prishtinë, Gjakovë, Beograd dhe më vonë Zajeçar; ushtrimi i funksioneve të ndryshme përfshirë dhe angazhimin në Universitetin e Prishtinës; pozita ime gjatë viteve të 90-ta; inkuadrimi në TMK dhe më vonë angazhimi në cilësinë e këshilltarit për çështje të sigurisë së Kryeministrit; themelimi i institutit dhe për fund pozita ime aktuale e Mbikëqyrësit Shtetëror në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

**PJESA E PARË**  
**FËMIJËRIA IME**



U lindi më 16 shtator 1942 në fshatin Rogaçicë, komuna e Kamenicës, Kosovë. Isha fëmija parë i babait, Bahtiar Shaban Qehaja, i lindur më 1914, në fshatin Kranidell (Komuna e Kamenicës) dhe i nënës, Hazbije Shefki Morina, e lindur më 1923 në fshatin Topanicë (po ashtu nga Komuna e Kamenicës). Sipas disa të dhënash, babai im, me disa familjarë (kushërinj) të tij, u shpërngul në fshatin Rogaçicë në vitin 1925. Kjo ndodhi në kërkim të kushteve diç më të mira për jetesë. Toka ishte më pjellore, mali ishte në afërsi dhe kushtet shumë të përshtatshme për blegtori, kishte lëndë drusore të mjaftueshme për djegie, por ishin edhe më afër rrugës që shpinte në drejtim të Bujanovcit dhe Gjilanit. Babai kishte mbetur jetim në moshën trevjeçare. Babai i tij, Shabani, nuk ishte kthyer as i gjallë, as i vdekur nga Lufta e Dytë Ballkanike dhe kurrë nuk u kuptua fati i tij. Atë e kishin mobilizuar si rezervist të ushtrisë së atëhershme të “kralevinës” (mbretërisë) së Serbisë. Babai im kishte mbetur vetëm me nënën e vet, Ajeten. Në ndërkohë, vdes edhe gjyshi i babit, Lutfiu. Familjarët e nënës së tij, nga fshati Marovc, në kufi me Serbinë, e ndajnë nënën e tij nga gjiri familjar dhe e kthejnë në fshatin kufitar, në Marovc. Tanimë, babai mbeti edhe pa nënën. Për të përkujdesej kushëriri i babait të tij, Hamiti, dhe ca kushërinj të tjerë. Kuptohet, për të përkujdeseshin edhe dy hallat e tij, Arifja dhe Shefija, derisa u martuan, njëra në Rogaçicë e tjetra në fshatin Hodanovc. Angazhimi i tij si fëmijë jetim kishte të bëjë kryesisht me ruajtjen e bagëtisë në malet që e rrethonin fshatin Kranidell. Pas shpërnguljes së kushërirut të parë të tij me familje në Rogaçicë (Mahalla e Kranidellëve), edhe ky shpërngulet me ta. Një kohë e kishte strehuar një Mixha Selim, kushëri më i largët me mbiemrin Thaçi. Thuhet se te Mixha Selim kishte qëndruar plot tri vite, derisa kushërinjtë e tij nuk e kishin ndërtuar shtëpinë dhe nuk i kishin krijuar kushtet e jetës në fshat të huaj - Rogaçicë. Kthehet sërish tek kushërinjtë dhe, në ndërkohë, vdes kushëri i parë i babait të tij, Hamiti. Derisa ishte gjallë Hamiti, ia kishte ndarë një pjesë të tokës babait tim, aq sa kishte menduar se i takonte këtij, por jo në përpjesëtim të pasurisë që e kishte babai i tij, Shabani. Kjo, siç thoshte babai, ishte vetëm 1/3 e pasurisë së tij, përkatësisht e pasurisë që kishte disponuar babai i tij. Njëkohësisht iu ndërtua shtëpia prej dy dhomash nga qerpiçet që në atë kohë përdoreshin për ndërtim. Në moshën 25 vjeçare, me nismën e gruas së djalit të madh të kushërirut Hamit, Fazliut, babai im u martua me Hazbien, vajzën e motrës së saj nga fshati Topanicë. Edhe ajo, nëna

ime Hazbia, kishte mbetur jetime, përkatësisht pa nënën e cila i kishte vdekur kur kjo ishte katërvjeçare. Kështu, ky çift bashkëshortor, e filloi jetën pa ndonjë pasuri, siç thuhet, nga zeroja.

Në jetën bashkëshortore të prindërve të mi u lindën dhjetë fëmijë, katër djem dhe gjashtë vajza (unë, Rexhija, Qamilja, Zymriti, Lutfiu, Nailja, Shabani, Kadirja, Bilalli dhe Havishja). Sot janë të gjithë të gjallë. Ditën kur u lindi unë, fëmija i parë, babai i gëzuar ia kishte mësyre zyrës së vendit në fshatin Muçivërc për të më regjistruar me emrin Shaban (emër i babait të tij, të cilin as që e kishte njohur). Mirëpo, me të arritur në qendër të fshatit Rogaçicë, afër xhamisë, e takon hoxhën e fshatit, Mulla Hafiz Kallabën. Në bisedë e sipër me të, i tregon për lindjen time dhe për emrin me të cilin kishte dashur të më pagëzonte. Pasi që ishte muaji i Ramazanit, hoxha i kishte thënë se unë kisha lindur me emrin tim – Ramadan. Babai e ndërroi mendjen dhe më regjistroi me emrin Ramadan.

Në fakt, fëmijëria ime, e motrave dhe e vëllezërve të mi, në 15 vitet e para, ishte aq e vështirë sa që, nga këndvështrimi material, mund të quhej skajshmërisht e rëndë, përkatësisht e mjerë. Ushqimi nuk na mjaftonte, sepse toka me të cilën ne dispononim ishte e pakët dhe, kryesisht, e bënte misrin, thekrën dhe duhanin. Kuptohet, një pjesë të saj e kishim lënë për kultivimin e barit, përkatësisht e kishim shndërruar në livadh, sepse duhej të ushqenim dy lopët dhe gomarin. Babai vuante nga ishiasi dhe me shumë vështirësi i bënte punët e rënda, siç ishin: mihja, korrja etj.

Më kujtohet se nëna shpesh i kryente edhe punët e burrave, bile me shpejtësi dhe shkathhtësi të pabesueshme. Kur ishte shtatzënë, sa më kujtohet, me fëmijën e katërt, në vazhdimësi punonte punë të rënda. Më kujtohet shumë mirë, kur ishim duke mihur misrin, për një moment e la shatin dhe, duke shkuar në shtëpi, e ftoi tezën e saj, abën Xhemë, për t'i ndihmuar në lindje. Tezja Xhemë ishte ajo që kishte ndërmjetësuar në martesën e saj me babën tim, edhe pse kjo ishte më e re se babai diç më tepër se 10 vjet. Shumë punë të fushës i kryeja unë me motrën time, Rexhijen. Shkoja edhe në mulli, e sidomos në fshatin Muhovc, kuptohet me gomarin e ngarkuar, i cili nganjëherë me vështirësi e përballonte peshën e ngarkuar. Kështu furnizoheshim me miell misri,

thekre e shumë rrallë me miell gruri, për një periudhë dyjavore. Shumë shpesh shkoja në mal për të prerë drurë dhe për t'i tërhequr deri në shtëpi për djegie. Në rastet kur drurët i preja dhe i ngarkoja në gomar, sillja në shtëpi një sasi më të madhe drurësh. Së paku një herë në muaj shkoja më babën në pazar (treg), qoftë në Vranjë, qoftë në Bujanovc e, diç më rrallë, në Gjilan. Shkonim për të shitur ve dhe pula. Ndonjëherë e nxirrnim në shitje edhe ndonjë lopë ose viç. Në të kthyer, blinim gjëra ushqimore dhe gjësende të ndryshme, që nevojiteshin për shtëpi. Rrallëherë blinim rroba të përdorura, apo opinga, siç i quanin atëherë “të Pirotit”, që për atë kohë ishin të mira. Rrobat ishin kryesisht nga fijet e konopit dhe ishin shumë të vrazhda për bartje. Ka ndodhur që kofshët e këmbëve të më përgjakeshin gjatë udhëtimit me pantallona të konopta. Mirëpo, përqendrimi im ishte shumë i theksuar në shkollim. Babai më thoshte se vetëm shkollimi im mund t'i nxirrte ata nga varfëria dhe nga ky mes i njerëzve, siç i quante ai, mjaft problematikë dhe belaxhinj.

Më 1 shtator të vitit 1950, vetëm dy javë pa i mbushur tetë vjet, babai më shoqëroi në shkollën e fshatit, e cila ishte larg shtëpisë sonë, diku rreth 5 km. Atë ditë isha shumë i shqetësuar dhe i frikësuar. Në oborrin e shkollës takova shumë njerëz, kryesisht nxënës e arsimtarë, por edhe fshatarë. U takova edhe me mësuesin tim të parë, me Ismet Dërmakun, i cili, duke parë shqetësimin tim, më ledhatoi dhe më ofroi një mollë, që i kishte qëlluar aty mbi tavolinë. Më tha se ai do të ishte mësuesi im dhe se do të kujdesej për mua posaçërisht, sepse kishte “muhabet” me babën tim. Babai e mori nga mësuesi një regjistër të librave dhe të fletoreve me të cilat duhej të pajisesha për shkollim. Pas dy ditësh, ai shkoi në Kamenicë dhe i siguroi ato, pavarësisht varfërisë së skajshme në të cilën jetonim. Kështu, ia fillova mësimin në shkollën fillore “1 Maji” në Rogaçicë. Pas një muaji, mësuesi im, Ismeti, shkoi, si duket, diku në shkollim dhe klasa jonë e parë u bashkua me të dytën. Gjysma e klasës (e dhomës) i takonte klasës së parë dhe gjysma tjetër klasës së dytë. Mësues ishte Fehmi Morina nga fshati Topanicë, prej nga unë i kisha dajët. Mësimin e zhvillonte mësuesi, duke i shpjeguar njëherë klasës së parë, pastaj klasës së dytë. Kuptohet, mësimet ngatërroheshin në kokat tona të njoma dhe mbanim në mend diçka edhe nga mësimet e klasës së dytë. Më vonë, klasa jonë u pavarësua. Isha një ndër nxënësit më të mirë në klasë. Kur mësuesi kërkonte për të përsëritur mësimin e

zhvilluar, e ngritja dorën dhe përgjigjesha me një zë të lartë. Lëvdatat e mësuesit më jepnin kurajo për të mësuar edhe më shumë. Edhe në ditët vijuese veçohesha në mësim dhe merrja nota të shkëlqyeshme. Vlen të theksohet edhe kontributi i babait në këtë aspekt, sepse kur mësoja nuk më angazhonte në punë të tjera. Vështirësitë më të mëdha i kisha deri në mbarim të klasës së katërt, sepse udhëtoja nga lagjja e Kranidellëve, pa ndonjë shok tjetër. Isha i rrezikuar nga qentë endacakë, që në Rogaçicë ishin shumë. I mbaja nga dy-tre gurë në duar për t'u mbrojtur prej tyre. Fillova ta adhuroja futbollin dhe shpeshherë lozja me shokët në shkollë. Një ditë, kur isha në klasën e katërt, duke lozur me shokët në oborrin e shkollës me një top gome, u vonova. Babai ishte brengosur për vonesën time, sepse nuk kishte ndodhur një gjë e këtillë më parë. Me të arritur në shtëpi, në orët e vona të pasdites, me top në duar, i lodhur dhe i raskapitur nga loja dhe udhëtimi i gjatë 5 km, babai u afrua ngadalë dhe m'i "fali" ca flakaresha dhe me sëpatën e vogël që kishte topin e bëri copë e grimë. Më qortoi shumë për këtë vonesë e që mbase e kishte brengosur shumë. Që nga kjo ditë, përveç në orët e kulturës fizike, loja e futbollit për mua mori fund.

Edhe në klasat e larta, siç i quanim atëherë, nga klasa e pestë deri në klasën e tetë, mësoja me vrull të madh. Përherë isha i shkëlqyeshëm. Nëse ndonjëherë, rastësisht, e merrja ndonjë katërshe, nuk qetësohesha derisa e bëja pesë. Ndonjëherë e mësoja në tërësi mësimin përmendësh, vetëm e vetëm për të marrë notën pesë.

Neve, që ishim nga lagjja e Kranidellëve, si muhaxhirë në Rogaçicë, disa nga moshatarët tanë, nxënës vendës, na ngacmonin, na shanin, na gjuanin me gurë, bile edhe na goditnin, duke na quajtur muhaxhirë, njerëz të malit etj. për arsye të mungesës së edukatës dhe emancipimit. Kisha bindjen se urrejtja ishte e shprehur më tepër ndaj meje, sepse isha nxënësi më i mirë. Dallohesha edhe në aktivitetet jashtë mësimi. Garonim në lëmi të ndryshme. Po e veçoj vetëm një nga rastet që më ka mbetur në kujtesë. Fizikisht isha ndër nxënësit më të zhvilluar, po edhe përdorja një teknikë të veçantë e të përsosur në hedhjen e gurit. Rifati, nxënës i klasës së tetë, i cili ishte fqinj i hallës së babës, ndonëse ishte më i fuqishëm se unë, nuk ia arrinte dot të më kalonte në hedhjen e gurit. Nervozohet tej mase dhe më përcillte hap pas hapi. Kërkonte gjithnjë në duel me mua. Një ditë, kur isha i lodhur, më përcolli deri te

“Ara e Hajrës”, në veri të fshatit. Më mundi, se nuk largohej ndryshe nga unë. Shpeshherë, babai ishte i detyruar të më përcillte nga shtëpia deri në shkollë, në mënyrë që t’i ikja provokimeve të ndryshme. Babai, me mençuri e urtësi, kërkonte nga prindërit e këtyre nxënësve që të mos ngatërroheshin me mua. Si fëmijë që isha, më dukej se ata frikësoheshin nga babai im, sepse ai ishte mjaft i fuqishëm dhe kishte një qëndrim burrëror. Ishte në gjendje edhe të kacafytej, vetëm e vetëm për të më mbrojtur mua. Ato ishin kohëra të vështira. Përveç varfërisë me të cilën u përballëm ne si familje, problem tjetër ishte edhe largësia e shkollës nga shtëpia, që në dy drejtimet shkuarje-ardhje duhej të udhëtoja këmbë rreth 10 km në ditë. Problemet shtoheshin kur binte shi, sepse rrugën që e përgjysmonte fshatin e mbulonte balta. Shpeshherë “Përroi i Madh” dilte nga shtrati dhe e vërshonte rrugën nga ujërat e thuajse të të gjithë përrrenjve të Malësisë. Atëherë kërkoja rrugë alternative për të shkuar në shkollë. Zakonisht shkoja rrugës “nëpër kodër”, që karakterizohej me një baltë specifike dhe ishte rrugë më e gjatë për të arritur në shkollë. Rreziku nga qentë endacakë ishte edhe më i madh, se kur kaloja rrugës së fshatit, sepse në të mund të mbështetesh përdonjë mur, ose të kërkoja ndihmë nga ndonjë fshatar, kurse nga kjo rrugë që gjarpëronte midis arash, mund të shihej, aty-këtu, vetëm ndonjë lavërtar duke lëvruar në arë, apo ndonjë bari duke kullotur bagëtinë.

## Në kërkim të ekzistencës

Ishte muaji prill i vitit 1958. Tanimë isha i notuar dhe prisja ta kryeja klasën e tetë në shkollën fillore “1 Maji” në fshatin Rogaçicë, komuna e Kamenicës. Prindërit e mi, sidomos babai, ishin shumë të brengosur se si dhe në çfarë mënyre do ta vazhdoja shkollimin e mëtejshëm. Varfëria ishte shumë e madhe. Për ta vazhduar shkollimin në ndonjërin nga shkollat e mesme në qytetin e Gjilanit nuk kishim para. Të mbetesh i pashkolluar ishte sikur të bëja vetëvrasje, siç thoshte babai im, Bahtiari. Shpesh, ndër të tjera, ai më thoshte: Nëse mbetesh këtu, në këtë tokë të pakët, me këta fqinj që i kemi, në këtë skaj të botës, kurdoherë do të jesh i detyruar të vrasësh dikë ose të jesh i vrarë. Rrugëdalje tjetër, përveç shkollës, më thoshte ai, nuk ka. Një ditë, në një gazetë serbe, ishte publikuar një konkurs. Babai im nuk e kishte kuptuar në tërësi

atë, por e kishte kuptuar vetëm pjesën ku shkruante se shkollimi ishte pa pagesë. Mirëpo, doli se me atë konkurs kërkoheshin nxënës për kryerjen e zanatit për pastrimin e oxhaqeve. Në ato ditë u publikua edhe konkursi për shkollat e mesme dhe për akademi ushtarake. Babai e kishte parë konkursin dhe, po atë ditë, ishte ndalur në fshat, ku e kishte shtëpinë mësuesi im, Sejdi Zylfi Kryeziu, për t'u konsultuar me të. Ai sikur e kishte bindur babën tim se ky do të ishte hapi më i mirë për mua, aq më parë, se isha nxënës i shkëlqyeshëm dhe do të mësoja mirë edhe në shkollë ushtarake. Njëkohësisht, mësuesi Sejdi i paskësh thënë se, shikuar në perspektivë, ne si shqiptarë kishim nevojë për shkollim ushtarak, përkatësisht për kuadro ushtarake. Në bazë të kësaj, te ai (babai) ishte formësuar qëndrimi se unë duhej të konkurroja në ndonjërin nga shkollat e mesme ushtarake. Duke mos pasur as njohuritë më të vogla për ushtrinë dhe duke ditur se do të duhej të largohesha nga shtëpia etj., nuk isha i pajtimit që të shkoja në shkollë ushtarake. Kisha për synim vijimin e shkollimit në gjimnazin e Gjilanit dhe, nga ana tjetër, ëndërroja të bëhesha mësues, por me gjendjen ekonomike që kisha, ishte e pamundur të realizoheshin dëshirat e mia. Tanimë, pas marrjes së dëftesës së klasës së tetë, babai filloi përgatitjen e dokumentacionit të duhur për të konkurruar në shkollë të mesme ushtarake, sipas përzgjedhjes së tij, në degën e shëndetësisë. Pasi që, përveç tri fotografish në grup, nuk kisha fotografi të veçantë për autobiografi dhe lutje, u detyrova të shkoja në Bujanovc (25 km larg shtëpisë) për t'u fotografuar. Për t'i marrë të nesërmen fotografitë, bujta në fshatin Tërrnovc. Ishte kjo rrugë e mundimshme, por e kreuva detyrën. Kjo fotografi për këtë dokument do të më mbetet në kujtesë gjatë tërë jetës sime. Logjika e babës tim ishte se kjo shkollë do të më shërbente si zanat dhe, në rast të largimit nga Armata Popullore Jugosllave (APJ), do të mund të punoja si teknik mjekësor, diku në institucionet shëndetësore. Pas disa ditësh të angazhimit për kompletimin e dokumentacionit, morëm rrugën për Gjilan - në Sekretariatit e Mbrojtjes Popullore. Me të arritur në Sektorin ushtarak ("Vojni odsek", siç e quanin atëherë), hasëm në një tollovi mjaft të madhe të të interesuarve, që kishin shkuar për të konkurruar për regjistrim në shkolla të mesme dhe akademi ushtarake. Pjesa dërrmuese e tyre ishin të përkatësisë serbe. Pas një pritjeje të gjatë në radhë, kërkesa jonë për regjistrim në shkollë të mesme ushtarake të mjekësisë u refuzua kategorikisht nga një kapiten serb, me arsyetimin

se ishte plotësuar numri i paraparë për regjistrim në atë shkollë. Me atë rast, ai i propozoi babait tim, si alternativë të vetme, regjistrimin në shkollë të mesme (të nënoficerëve) të këmbësores. Babai paksa u hamend dhe filloi të më pyeste se çka po mendoja unë lidhur me këtë propozim. Pasi që unë isha i papërcaktuar dhe pa njohuri elementare për lëminë ushtarake, nuk dija të përgjigjesha. Ai vendosi vetë. I tha kapitenit se po pranoja edhe për këmbësori. Në këtë mënyrë ishte kryer faza e konkurrimit për nënoficer të APJ-së. U kthyer në shtëpi. Isha, në fakt, si i humbur dhe i dëshpëruar. Nuk dija se çka do të bëhej me mua. Ditët kalonin derisa isha në pushim. Lëvizjet e mia ishin të kufizuara deri te ndonjë i afërt yni, në fshatrat Rogaçicë, Hodonovc apo Topanicë, tek dajallarët e mi. Merrja ndonjë gazetë dhe e lexoja në tërësi. Dilja në mal për të grumbulluar dru për djegie. Marrë në tërësi, ishte një monotoni e papërshkrueshme.

Një ditë, papritmas, erdhi një postier dhe ia dorëzoi babait tim një dërgesë postare, me nënshkrim. Kjo ishte ftesë për mua. Duhej të lajmërohesha në PU 9010 në Sarajevë për të kryer kontrollimin specialistik mjekësor. Më kujtohet se thirrja ishte në gjuhën serbe dhe në këndin e djathtë kishte tri vija të trasha të kuqe, që ishte një informacion i klasifikuar, përkatësisht dërgesë speciale për atë kohë. Nuk më kujtohet data se kur do të duhej të lajmërohesha atje, por e di se ishte diku në gjysmën e dytë të muajit qershor të vitit 1958. Kjo thirrje ishte, njëkohësisht, edhe biletë për udhëtim falas, por vetëm me tren. Më kishin mbetur vetëm edhe shtatë ditë deri në datën e udhëtimit tim të parë me tren dhe atë, nga qyteti i Ferizajt. Isha mjaft i demoralizuar dhe i shqetësuar që po ndahesha nga shokët, shumica e të cilëve do të vazhdonin shkollimin në Gjilan, Prishtinë, Gjakovë. Nganjëherë sikur e lutja Zotin të mos pranohesha në këtë shkollë dhe t'u bashkëngjitesha shokëve të mi. Por, po ashtu, kur mendoja për varfërinë e skajshme, me të cilën përballeshim, sikur thosha në vete, mbase është më mirë të pranohesha në shkollë ushtarake, sepse atje të gjitha shpenzimet i kisha falas. Udhëtimi im i parë me tren nga Ferizaj deri në Sarajevë zgjati më tepër se 12 orë. Pritjen më të gjatë e monotone (afro 6 orë), e përjetova në qytetin serb, Çaçak, derisa erdhi treni i quajtur "Çira". Me të, të nesërmen, në orët e hershme të mëngjesit, arritëm në Sarajevë. Na vendosën në disa dhoma të mëdha, të shtruara me dyshekë ushtarake. Në grupe na dërgonin në spitalin ushtarak për vizitë specialistike. Më

kujtohet si sot, kur një mjek, kardiolog, që na kontrollonte, duke më dëgjuar me stetoskop, i thoshte kolegut të vet, përafërsisht kështu: “Eja, dëgjoje këtë zemër të këtij djaloshi që me siguri është rritur vetëm me bukë misri”. Sikur ishte habitur me të rrahurat e zemrës sime. Aq më parë, kur pa se me çfarë rrobash isha i veshur. Gjatë vizitës mjekësore, në ditën e nesërme, njëri nga mjekët (ortoped) konstatoi se “i kisha” tabanët e këmbëve të rrafshët dhe se nuk mund të rekrutohesha në këmbësori. Në fakt, ky konstatim i mjekut sikur e pamundësoi regjistrimin tim në shkollë të nënoficerëve. Atë natë as që bëra gjumë. Mendoja se çka do të bëhej me mua, kur të kthehesha në shtëpi dhe pyesja veten se ku do të shkoja në rast të mospranimi. Papritmas, të nesërmen, mua dhe tre-katër kandidatë të tjerë, një oficer me mbiemrin Roksandiq (si duket ishte major me gradë), na rreshtoi dhe na urdhëroi që të shkonim pas tij. Sapo arritëm tek mjeku, i cili kishte konstatuar paaftësinë tonë (ortopedi) për shkak të tabanëve, oficeri bisedoi diçka me mjekun lidhur me këtë konstatim dhe, sikur ishte bërë një gabim gjatë vizitës mjekësore dhe duhej përsëritur ajo. Më pas, në fletë të njëjtë, duke anuluar konstatimin e mëhershëm, shënohet “Sposoban” (i aftë) për shkollim të mëtejme. Një gjë e tillë ndodhi edhe me tre kandidatët e tjerë. Kështu rrodhi konstatimi se unë isha i aftë për shkollim në shkollë të mesme për nënoficer të këmbësorisë. Kuptohet, nuk mjaftonte vetëm kontrollimi mjekësor. Më thanë se do të pasonte thirrja për shkollim të mëtejme. Në mënyrë të organizuar hynim në tren, për t’u kthyer në shtëpi. Rrugëtimi nga Sarajeva deri në shtëpi ishte i vështirë dhe i mundimshëm. Rrugës hanim ushqim të thatë që na kishin dhënë me vete. Ashtu i lodhur, arrita në shtëpi. Prindërit, vëllezërit dhe motrat, me vëmendje të posaçme, dëgjonin rrëfimin tim. Çështja e regjistrimit tim në këtë shkollë ende ishte pezull. Ditët kalonin dhe mendja më thoshte se mund të mos pranohesha. Gjatë qëndrimit në kazermë ushtarake, siç thash, me rastin e vizitës mjekësore, krijova një përshtypje për disiplinën e vështirë ushtarake dhe mendoja se si do ta përballoja atë. I vizitova të afërmit e mi. Pas dy javësh pritjeje, një ditë u shfaq postieri para shtëpisë sonë. U mblodhën me vrap të gjithë anëtarët e familjes sime para tij. Ai kërkoi që babai im të nënshkruante fletë-dërgesën me arsyetimin se letra ishte dorëzuar. Në të vërtetë, ky ishte vendimi i komisionit për pranimin tim në shkollë të nënoficerëve të këmbësorisë. Data e paraqitjes në PU 9010 në Sarajevë ishte 25 shtator 1958. Emocionet ishin të përziera. Sa thosha se ishte bërë



mirë, sa mendoja se ndoshta ishte dashur të kërkoja ndonjë zgjidhje tjetër. Për këtë gjithnjë e fajësoja babën tim, i cili me këmbëngulësi insistonte që të shkoja në shkollën ushtarake, pa dëshirën time. Filluan të më vizitonin fqinjët dhe të më uronin për pranim. Filluan edhe thashethemet, kinse unë do ta humbja fenë e kombësinë, do të bëhesha serb, e gjëra të tjera. Babai sikur nuk i dëgjonte ato thashetheme, megjithatë, në fytyrën e tij herë-herë vërehej zhgënjimi. Shpjegimi dhe arsyetimi i tij për regjistrimin në shkollë ushtarake ishte i bazuar në gjendjen tonë të vështirë materiale. Sikur të shitej një pjesë, edhe ashtu e pakët e tokës, babai nuk do ta kursente për shkollimin tim. Blerës të tokës nuk kishte. Rrethi i njerëzve ku jetonim nuk ishte edhe aq i mirë. Kishte njerëz problematikë, apo siç i quante babai im, “belaxhinj”. Në një të ardhme, jo të largët, unë do të mund të përballesha me ndonjë të keqe, etj., aq më parë, se ne ishim shumë të varfër dhe sic thuhet në popull “pa krahë”. Ditët në vijim ishin shumë të vështira për mua. Nuk më zinte gjumi. Isha i shqetësuar, herë-herë shikoja në një pikë. Nëna ime, si me rregull, nuk guxonte “t’ia prishte” babait. Më kujtohet një ditë kur, pas disa thashethemesh të ndryshme, që ishin dëgjuar nga disa njerëz, erdhi deri te grindja ndërmjet tyre. Nëna, sikur ia bëri me dije babait se po ngutej në marrjen e vendimeve, se nuk po konsultohet me askënd dhe sikur kishte vendosur ta humbiste djalin. Kjo grindje nuk zgjati shumë, sepse babai me ashpërsi e ndërpreu nënën, duke ia bërë me dije se ishte ai që vendoste për mua dhe jo ajo. Unë hezitova të ndërhyja apo të deklarohesha për mendimin tim. Vetvetiu më dukej sikur e përkrahja mendimin e nënës sime.

Ishte fillim i shtatorit 1958. Lexoja ndonjë libër çka më binte në dorë. Brengosesha, sepse nuk e njihja gjuhën serbe. I dija vetëm disa fjalë që i kisha mësuar nga Miroslav Simiqi, kujdestari im i klasës së tetë. Thuhej se ky ishte nga një fshat i rrethit të Smederevës. Në afërsi të lagjes sonë nuk kishte serbë. Stojadini, një kolon serb, e kishte shtëpinë rreth dy kilometra larg shtëpisë sonë. Ai na vizitonte për festën e Bajramit. Para se të nisesha për Sarajevë, e vizitova dy herë. Në njëfarë mënyre, duke biseduar me të, doja ta testoja veten se sa e dija gjuhën serbe. Ai u habit, kur kuptoi se unë isha pranuar në shkollë ushtarake. Po ashtu, disa fjalë e fjali të gjuhës serbe i kisha mësuar nga një pastrues serb, që punonte në shkollën tonë. Sidoqoftë, shqetësimin më të madh e kisha nga mosnjohja e gjuhës serbe.

## Fillimi i një shkollimi ushtarak

Pas shumë peripecish, lidhur me regjistrimin tim në shkollë ushtarake për nënoficerë, si dhe peripecive të tjera, arriti edhe thirrja zyrtare për t'u lajmëruar në shkollë, në Sarajevë, më 22 shtator 1958. Në rrugën e filluar për në Sarajevë, deri në Gjilan, më përcolli babai im, Bahtiari. Pas rreth 4 orësh udhëtimi, u ndalëm për të pushuar në Kodër të Përlepnicës,<sup>1</sup> në periferi të Gjilanit. Derisa pushonim aty, babai më fliste se si unë në të ardhmen duhej të martohesha patjetër me ndonjë vajzë shqiptare. Atëherë nuk e kuptoja arsyen pse ai më fliste për martesë (kur i kisha vetëm 16 vjet), në vend se të më fliste për angazhimin tim në mësim. Mjaft i shqetësuar për temën e papritur të bisedës, mbase me një nervozë të theksuar, e ndërpreva fjalën e babait, duke i thënë se nuk ishte koha e vendi për biseda të këtilla. Si për çudi, ai zbuti tonin e bisedës dhe, sikur të më lutej, më tha: "Biri im, shumë shpejt vjen edhe koha e martesës...dhe duhet të kesh kujdes, se je nisur një rrugë të gjatë e të mundimshme, se do të takohesh me njerëz të llojllojshëm e...mos po shkel në dërrasë të kalbët!". Sa munda të kuptoja në atë kohë dhe në atë moshë, sa munda të lexoja mes rreshtash, siç thuhet, kushërinjtë, fqinjët, fshatarët e miqtë i kishin bërë trysni, duke i thënë se unë në atë shkollë ushtarake me serbë, do të "serbizohesha". Meqë ishim lodhur, babai vendosi që atë natë të qëndrojmë në Përlepnicë, te Kadri Dalipi, burri i vajzës së hallës së tij, në mënyrë që të nesërmen, pas mëngjesit, të vazhdonim rrugën këmbë deri në Gjilan. Në shenjë respekti për ardhjen e mysafirëve, siç ishte zakon, në shtëpinë e Kadri Dalipit u mblodhën shumë njerëz, të cilët bisedonin me babën për shumë tema të ndryshme. Meqë isha lodhur fizikisht e psikikisht, mua herët më kishte zënë gjumi. Të nesërmen, ashtu si e kishim planifikuar, u nisëm herët për në Gjilan. Kur arritëm para ndërtesës së komunës, përkatësisht para Sekretariatit të Mbrojtjes Popullore, apo siç i thoshin atëherë, "Vojni odsek", pash shumë rekrutë që ishin nisur për kryerjen e shërbimit ushtarak. Ata ishin të moshës mbi 20 vjeçare. Më kujtohet se edhe mua më urdhëruan që të ngjitesha në një rimorkio të një kamioni. U nisëm për Ferizaj. Rruga ishte e paasfaltuar. Nga pluhuri, që shtresohej mbi ne, i përngjanim më tepër mullixhive. Në stacionin

1 Më saktësisht, lokacioni ishte pikërisht tashmë të objekti privat i njohur si "Vali Ranch".

hekurudhor të Ferizajt, shumica e rekrutëve pritnin trenin që shkonte në drejtim të Kralevës. Pritja ishte e gjatë e monotone. Derisa prisja, u njoftova me një kadet të ardhshëm me mbiemrin Svetkoviç. Ai ishte nga fshati Partesh (Komuna e Gjilanit) dhe ai gjithashtu shkonte në Sarajevë për t'i ndjekur mësimet në shkollën e nënoficerëve të këmbësores. Njoftimi me të sikur ma lehtësoi sadopak udhëtimin dyditor deri në Sarajevë. Edhe pse nuk e dija mirë gjuhën, disi merresha vesh me të. Më 25 shtator 1958, në kazermën "Marshall Tito", gjithçka ishte gati për pritjen dhe sistemimin e kadetëve nëpër çeta krejtësisht ushtarake, e jo nëpër paralele, siç kisha menduar unë. Çetat kishin nga 90 deri në 100 kadetë. Mua më caktuan në togun e dytë të çetës së V-të, me kapitenin Jotiq në krye. Togun e parë e udhëhiqte kapiteni Kukanjac Milutin. Ai ishte edhe kryetar i organizatës së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë (LKJ) për çetën e pestë.<sup>2</sup>

Siç e përmenda edhe më lart, sistemimi ynë ishte krejtësisht në baza ushtarake, sipas modelit rus "të disiplinës së hekurt". Isha shumë i revoltuar. Gjithnjë mendoja se si të kthehesha në shtëpi. Mirëpo, një gjë e tillë ishte shumë vështirë e realizueshme, sepse çdo gjë ishte e programuar dhe ishte e pamundshme të largohesha nga rreshti. Ishim nën mbikëqyrjen e nënoficerëve, të cilët në fakt ishin edhe asistentë të kapitenit Jotiq.<sup>3</sup>

Vetëm pas përshtatjes me ambientin, më ngarkuan me armë. Pasi që isha i gjatë dhe i fuqishëm, "më takoi" pushkomitralozi i rëndë 12 kg, i quajtur "Sharac", i prodhimit gjerman. Kështu edhe filloi kalitja jonë ushtarake. Gjuhën serbe (serbo-kroate) e mësova brenda 30 ditësh. Trajnimet ishin të karakterit taktik, të përdorimit sa më të mirë të të gjitha armëve të këmbësores dhe atë, deri në minahedhësin e kalibrit 82 mm. Nuk mungonin edhe mësimet për armët më të rënda,

---

2 Për t'ia rikujtuar lexuesit, ishte ky kapiten i cili më 1993, si gjeneral dhe komandant armatës së Sarajevës nuk desh ta vriste Alia Izetbegoviçin, gjatë prangosjes së tij në kazermën e Lukavicës në Sarajevë. Si duket, moslikuidimi i Izetbegoviçit nuk ishte shkaku i vetëm që ai të zëvendësohej shumë shpejt me gjeneralin Ratko Mladiç, por edhe maturia dhe butësia e tij, ishin shkaqet kryesore për shkarkimin e tij.

3 Njëri ndër këta asistentë ishte edhe Nikolla Ojdaniç, i cili më vonë do ta kryente Akademinë Ushtarake (dy vite para meje) dhe do të gradohej në mënyrë të përshpejtuar. Ai merr gradën e gjeneralit dhe udhëheq Sekretariatit Federativ gjatë luftërave në BeH dhe Kosovë. Tani është i dënuar nga Gjykata e Hagës për Krime të Luftës.

por për ato flitej më tepër në mënyrë informative. Lëndët e karakterit të përgjithshëm më tepër i mësonim në orët e pasdites. Zakonisht, përveç të dielave, dy orë i kushtoheshin sistemit shoqëror, gjeografisë, njohurive të natyrës etj. Mësimi mbahej me nga dy togje, kryesisht me togun e parë dhe të dytë, së bashku. Me fjalë të tjera, kishte një angazhim intensiv, qoftë praktikë apo teorik.

## Fillimi i ngritjes profesionale - ushtarake

Isha një ndër kadetët më të mirë. Literaturën e lexoja disa herë, ose e përsëritja ndonjë veprim praktik deri në përsosmëri. Më kujtohet, në një amfiteatër, ku prezantonin këto dy togje dhe ku shtjellohej një temë nga sistemi shoqëror, nënkoloneli, para se të fillonte ligjërimin, kërkoi që ndonjëri nga kadetët ta përsëriste temën e fundit. Pasi që nuk u paraqit askush, kërkoi nga unë që ta përsërisja mësimin e fundit. E kishte kuptuar se isha shqiptar dhe këtë e bëri, si duket, më shumë nga kureshtja. U ngrita në këmbë dhe u prezantova. Fillova ta përsërisja temën e caktuar. Gabimet gramatikore që i bëja gjatë përsëritjes së temës në gjuhën serbe ishin të paevitueshme. Pas një gabimi që e bëra në të folur, dikush nga kadetët sikur filloi të qeshte. Nënkoloneli që mbante ligjëratën e qortoi me zë të ngritur atë që qeshte, duke iu drejtuar atij dhe të tjerëve me fjalët: “A po e shihni sa bukur e ka mësuar kadeti mësimin. Gabimet gjuhësore janë normale. Sikur ju të flisnit në gjuhën e tij, si do të ndiheshit”. Me këtë rast nënkoloneli i dha urdhër kapitenit tim që të më shënojë notën pesë. Dhe kështu, ditët kalonin, trajnimet vazhdonin dhe inkorporimi i plotë në atë sistem tanimë kishte pasur sukses.

Ndërkohë kontaktet i mbaja me familjen duke përdorur mjetet e atëhershme të komunikimit. Një herë në muaj, nga babai, merrja ndonjë letër. Ai i shkruante letrat me alfabet cirilik, por me përmbajtje në gjuhën shqipe. Atë shkrim vetëm unë e kuptoja. Edhe unë u shkruaja prindërve rregullisht. Gjatë shkrimit të letrave, tinëzisht më rridhte ndonjë lot. Përmallohesha për prindërit, vëllezërit dhe motrat. Në fillim të çdo muaji na jepnin ca para, siç i thoshin ata, “para xhepi”. Pasi i grumbullova disa para në një periudhë kohore, bleva një orë dore nga një kadet. Pas dy- tri ditësh, ora u ndal. Kërkova nga ky kadet që të m'i kthente paratë. Meqë ai e refuzoi kërkesën time, erdhi deri

te konflikti. U grushtuam me të. Pasi që të dy ishim të përkatësive të ndryshme nacionale, ai serb e unë shqiptar, kjo ngatërresë u trajtua si rast i jashtëzakonshëm. Pasi që rasti e tejkaloi nivelin e togut, duhej të paraqiteshim në raport te komandanti i çetës. Ai ishte një kapiten i klasit të parë, i dalë nga lufta, me mbiemrin Kostiq. Ishte shtatgjatë dhe i ashpër. Rrallë fliste me dikë. Atë natë nuk bëra gjumë fare. Brengosesha për epilogun e kësaj ngjarjeje. Të nesërmen, në orën 14:00, së bashku me komandantin e togut, u paraqita te komandanti i çetës. Pasi që u prezantuam para tij, secili nga ne të ftuarit patëm versionin tonë të shpjegimit për orën e prishur. Pas qëndrimit tim të gjatë në këmbë dhe gatitu, u demoralizova shumë dhe desha ta braktisja shkollën e të kthehesha në shtëpi. Mbase, këtë kërkesë ia shtrova edhe komandantit të çetës. Ai ishte i lindur në Vranjë dhe e dinte se fshati ku isha i lindur gravitonte në pjesën e Bujanovcit. Më tha se qenkemi edhe vendës. Sapo i dëgjova këto fjalë, sikur më dukej se edhe mua dikush po më përkrahte. Më tha se nuk mund të shkoja në shtëpi, sepse rridhja nga një familje e varfër dhe si i tillë nuk kisha si të mbijetoja. Ndërsa kadetin tjetër e urdhëroi që të m'i kthente paratë dhe ta merrte orën, kurse komandantit të togut, kapitenit Jotiq, ia bëri me dije se nuk guxonte të lejonte asnjë tentativë të ndonjërit për të më ngacmuar ose ofenduar, sidomos në baza nacionale. Kështu mbeta edhe më tej në shkollë.

Pas gjashtë muajsh qëndrimi në shkollën e nënoficerëve, në gjysmëvjetor, na takonin njëzet ditë pushim dhe mund të ktheheshim në shtëpitë tona. Nuk mund ta përshkruaja gëzimin për kthimin e parë në shtëpi. U ktheva në shtëpi me uniformë të kadetit. Nuk kishin të ndalur vizitat nga të afërmit tanë, nga fqinjët dhe miqtë. Ishin kureshtarë të takoheshin me mua, të dinin se ç'kishte ndodhur me mua, si dukesh, si kaloja. Shëtita nëpër fshat. E vizitova shkollën, ku e kisha përfunduar tetëvjeçaren. Më rrethuan nxënësit, arsimtarët. Më shtruan pyetje të llojllojshme. U kënaqa me ta.

Shumë shpejt kaluan ditët e pushimit. Në ditën kur duhej të braktisja shtëpinë, prindërit, vëllezërit dhe motrat, më dukej se, mërzhitesha më shumë se kur u largova për herë të parë nga shtëpia. Gjatë këtij pushimi, e pashë për herë të parë vëllanë tim, Shabanin, që kishte lindur natën ndërmjet 22 e 23 shtatorit të vitit 1958, kur unë isha në fshatin Përlepnicë, duke udhëtuar për në Sarajevë. Vazhdova shkollimin

në semestrin e dytë. Filluan ushtrimet dhe trajnimet fushore nëpër rrethinën e Sarajevës, siç ishte Trubaceva Kosa, Butmir, Pale etj. Fitova kondicion, sepse ecnim shumë në këmbë. Në çështjet praktike isha ndër më të mirët. Vitin e parë e kreu me sukses shumë të mirë. Mora gradën e dhjetarit. Tanimë isha një ushtarak i përgatitur. Edhe pse i detyruar të shkoja në këtë shkollë pa dëshirën time, sikur e vëreja se për profesionin e ushtarakut kisha edhe prirje. Me demonstrimet që i bënim kohë pas kohe, sidomos me veprimet praktike, dallohesha për komandë të thuktë dhe të kuptueshme. Për këtë më kishte lavdëruar komandanti i togut, i cili gati vazhdimisht ishte më ne. Atij i ndihmonin, sidomos në çështjet praktike, asistentët, tre nënoficerë (kapterë). Për skuadrën time ishte përgjegjës kapteri Gjuroviq. Ai flinte në dhomën tonë, të ndarë me një paravan. Shpeshherë, në të kthyer nga qyteti, vinte në gjendje të dehur. Ka ndodhur që në atë gjendje, p.sh në mesnatë të na komandojë dhe të na mbajë në këmbë, në pizhame. Shkaku i kësaj shpeshherë ishte banal. Nëse ndonjëri nga kadetët, p.sh. nuk i kishte palosur mirë çorapët mbi këpucë, apo ndokush nuk i kishte pastruar mirë këpucët, atëherë dënimi ishte kolektiv. Maltretime, fyerje, sharje e kështu me radhë kishte në vazhdimësi. Vetëm fyerjet në baza nacionale ishin të ndaluara rreptë. Për këtë edhe kapteri im, Gjuroviq, ishte shumë i kujdesshëm. Në fakt, sistemi i komandimit dhe drejtimit i ngjante atij rus. Çdo veprim bëhej sipas një automatizmi, edhe pse kishte mjaft elemente të maltretimit, e të mos flasim për të drejtat e njeriut. Ato shkeleshin në vazhdimësi.

Gjatë shkollimit në vitin e dytë, bëheshin disa ushtrime në nivel të batalionit dhe të regimentit, nëpër njësi të ndryshme. Në ato njësi ne kryesisht kryenim punë të praktikës, në komandim me përbërje të ulëta (skuadër, e ndonjëherë të togut). Kuptohet, në këto ushtrime me kadetët, eprorët na përcillnin e na vlerësonin. Notat ishin përshkruese dhe me numra, nga një deri në pesë. Tanimë, unë nuk i kisha problemet që i kisha në fillim të shkollimit. Isha 17 vjeçar, dhe vëmendjen nuk e kisha koncentruar në arritjen e suksesit në mësim, sepse atë e kisha të garantuar, por isha bërë i tëri sy e veshë, se në cilin garnizon do të më caktonin për të punuar si nënoficer. Dëshiroja të punoja sa më afër shtëpisë sime, t'u ndihmoja prindërve të mi, të cilët ishin në një gjendje të rëndë materiale. Muaji maj i vitit 1960 ishte muaji i përgatitjeve dhe i dhënies së provimeve. Meqë vetë sistemi i shkollimit ishte i tillë, duhej

të përsëriteshin disa mësimet dhe lirisht të dilej në provim. Provimet ishin kryesisht praktike. Ato i përfundova me sukses shumë të mirë. Dy javët e fundit të muajit qershor të vitit 1960 kaluan duke pritur se kush ku do të shkonte në detyrë. Na lejuan që, sipas dëshirës, të dilnim dhe të shëtisim nëpër qytetin e bukur të Sarajevës. Shëtisim këmbë dhe rëndom shkonim deri në vendin e quajtur “Bashçarshia” dhe ktheheshim prapa në shkollë (kazerëm). Ushqimin e kishim të begatshëm dhe me shumë kalori. Kishte edhe mundësi të merreshim edhe me aktivitete të lira, me klubin e kadetëve.

Më 27 qershor 1960 ishte dita kur u rreshtuam me rroba të reja dhe grada të kapterit. Pas një fjalimi të një gjenerali, emri i të cilit nuk më kujtohet, një oficer me gradën major filloi të lexojë urdhëresën për avancim në gradën e kapterit. I njëjti më vonë filloi të lexonte urdhëresën e caktimit tonë nëpër garnizone në territorin e ish-Jugosllavisë. Emocionet sa vinin e shtoheshin. Pasi që, sipas alfabetit cirilik, isha në fillim të listës, shumë shpejt u dëgjua mbiemri dhe emri im, si dhe posta ushtarake në garnizonin e Travnikut, ku duhej të shkoja. E kuptova se ky ishte një qytet në Bosnjën Qendrore. U dëshpërova mjaft, se ky vend ishte shumë larg nga vendlindja ime. Mirëpo ja që ky ishte realiteti më të cilin së shpejti u pajtova. Secili nga ne, tanimë të avancuar, e mori edhe fletudhëtimin në të cilin precizohej posta ushtarake, vendi dhe koha ku dhe kur duhej të lajmëroheshim në detyrë. U gëzova pa masë kur po të njëjtën ditë na dhanë edhe pagën e parë sepse mendoja se do t'i ndihmoja familjes sadopak. Duke u nënshkruar në regjistrin e pagave, kuptova se do t'i merrja 1600 “banka”, qysh thuhej në popull për Dinarin jugosllav, që nuk e kisha imagjinuar se kaq para do t'i kisha ndonjëherë në xhep. U shpërndamë, duke u përqaftuar dhe duke u përshëndetur njëri me tjetrin. Shumica iu drejtuan stacionit hekurudhor. Në mesin e tyre isha edhe unë. E prisja trenin për Beograd, e pastaj do të vazhdoja me tren në relacionin Beograd-Nish-Shkup, me qëllim që të zbritja në stacionin hekurudhor në Bujanovc. Arrita në shtëpi, me një valixhe mjaft të madhe, ku i kisha palosur rrobat ushtarake me të cilat më kishin ngarkuar. Familjarët u gëzuan tej mase, e në veçanti nëna ime. Ishte ditë festive për familjen time, aq më shumë, kur njëri nga anëtarët e familjes tanimë ishte i punësuar si nënoficer në ish-Armatën Popullore të Jugosllavisë (APJ). Tani sikur u krijua një siguri më e madhe në familjen tonë. 25 ditët e pushimit kaluan shumë shpejt.

**PJESA E DYTË**

**FILLIMI I NGRITJES**

**PROFESIONALE-USHTARAKE**



Në mesin e dhjetë nënoficerëve të porsagraduar isha edhe unë, që duhej të lajmërohesha në detyrë në garnizonin e Travnikut. Ishte ky një qytet në të cilin jetonin myslimanët, kroatët dhe serbët. Pas myslimanëve radhitej komuniteti kroat. Sa më kujtohet, qyteti kishte 35 mijë banorë. Shquhej për disa vende të bukura për piknik, si Bashbunar, Pllave Vode, Kështjella Turke, Turbe etj. Në këtë garnizon ekzistonte një regjiment malor. Në përbërje të këtij njësi mjaft të madh, përveç të tjerash, kishte edhe kuaj. Më caktuan në një tog si komandant i një skuadre prej 10 ushtarësh. Në mungesë të komandantit të togut, në fakt, duhej të komandoja me këtë tog që nga dita e parë. Një kapiten, në rolin e komandantit të kompanisë, më prezantoi para rreshtit dhe u tha të pranishmëve se unë do të kujdesesha për ata 30 ushtarë. Të gjithë ushtarët më shikonin të habitur, për shkak të moshës që kisha (diç më tepër se 17 vjet), se si ishte e mundshme të isha komandant i tyre. Në mesin e ushtarëve kishte edhe 28 vjeçar, por jo edhe më të rinj se 20 vjeç. Të njëjtën ditë më vendosën për të banuar në të ashtuquajturën dhoma e nënoficerëve. Aty ishin 8 nënoficerë. Disa ishin vendosur në këtë dhomë para dy vitesh. Përveç një krevati, ma ndanë edhe një dollap, që e quanin "shifonjer", për ruajtjen dhe varjen e rrobave. Diç tjetër të posaçme në atë dhomë nuk kishte. Në atë kohë, nënoficerët e pamartuar nuk mund të banonin në qytet. Kjo ishte një anomali e llojit të vet. Kështu filloi karriera ime ushtarake e cila në fillim ishte dekurajuese. Pas dy-tri ditësh, na dhanë edhe pagën, e cila ishte për disa dinarë më e madhe se ajo e para, ngase e kishte një shtesë për trupë (punë me ushtarë). Mensa e nënoficerëve ishte në qytet. Për tri racione të ushqimit paguaja një të tretën e kësaj page. Fjetjen e kisha të siguar. Gjendja e vështirë materiale e prindërve, vëllezërve e motrave, më përcillte si hija. Për t'u përballur me këtë gjendje, përmes postës, ua dërgoja pjesën tjetër të pagës, në fshatin Rogaçicë, ku ata jetonin. Këto para u mjaftonin për të siguar gjërat elementare për jetesë, siç ishin ushqimi, veshmbathja e kështu me radhë. Kjo zgjati 25 muaj rresht, derisa isha duke punuar.

Brenda dy javësh e kuptova tërësisht se çka duhej të punoja me ushtarët. Në fakt ishte orari i caktuar për tërë kompaninë e në veçanti për togun. Ushtrimet bëheshin kryesisht në terren praktikisht. Bëheshin edhe trajnime për mirëmbajtjen dhe përdorimin e armatimit. Punoja me zell, sepse tjetër rrugëdalje nuk kisha. Disa ushtarë ishin të pashkolluar

dhe vështirë i kuptonin mësimet. Me ata ishim të obliguar të mbanim orë plotësuese. Disa nga ushtarët bënë gabime të ndryshme, qoftë kur dilnin në qytet pa leje, qoftë kur rriheshin me njëri-tjetrin, etj. Kishte edhe të atillë që iknin nga garnizoni dhe shkonin në shtëpi dhe, pas ca ditësh, policia ushtarake i kthente në garnizon. Pra, që në fillim u përballa me këto dhe shumë probleme të tjera. Rreziku më i madh ishte kur organizonim gjuajtje me armë personale, e në veçanti me bomba të dorës. Këto gjuajtje bëheshin 4-5 km jashtë kazermës, në një fushë të gjuajtjes. Edhe sot nuk e kam të qartë se si nuk kishte ndodhur asnjë aksident, përkatësisht asnjë lëndim trupor apo vdekje për ato dy vite sa qëndrova në këtë garnizon. Sigurisht që më ruajti Zoti, po edhe organizimi i punës, si dhe përkushtimi ndaj detyrës, ishin ndër elementet që ndikuan në këtë. Gjatë gjuajtjes me bombë dore, kishte raste kur ushtari nga frika, pas aktivizimit të kapsollës së saj, e lëshonte bombën e aktivizuar dhe unë detyroheshja ta kapja atë dhe ta hedhja, duke u futur së bashku me ushtarin në transhe.

Ditët dhe muajt kalonin. Me punën time të zellshme, rashë në sy si epror i vyeshëm. Për këtë, më 22 dhjetor 1960, në Ditën e Armatës, para rreshtit të regjimentit, papritmas lexohet emri dhe mbiemri im, duke më lavdëruar publikisht si epror shembullor. Në fakt, unë isha plot 24 orë së bashku me ushtarët. Kishte edhe raste kur revoltoheshja, sepse puna jo vetëm që ishte monotone, por ishte edhe e vështirë. Përsëri mendoja ta braktisja këtë profesion. Vështirësitë ishin të mëdha, sidomos kur pranonim ushtarë të rinj - rekrutë. Gjithnjë e më tepër bindesha se profesioni i nënoficerit ishte shumë i rëndë. Nga ana tjetër, me zili dhe admirim, shikoja oficerët me akademi ushtarake, të cilët në krahasim me nënoficerët, mund të quheshin zotërinj. Shpeshherë mendoja se si edhe unë një ditë do të mund të bëhesha oficer.

Në fillim të vitit 1961, u bënë disa ushtrime në kushte dimërore. Ishin ditë të vështira dhe me plot probleme me ushtarë. Disa nuk mund t'i përballonin marshimit, ndërsa disa të tjerë nga të ftohtit sikur fituan temperaturë dhe duhej t'i dërgonim në ambulancë. Erdhi koha kur ky brez ushtarësh e përfundonte shërbimin në APJ. Filluan përgatitjet për pranimin e brezit tjetër të ri të rekrutëve. Pranimi i tyre bëhej çdo gjashtë muaj. Sa i përket kohës së lirë, ajo ishte shumë e pakët. Dilnim në shëtitje apo shkonim në një restorant kryesisht nga dy-tre shokë

së bashku. Për ndonjë dëfrim të posaçëm apo çlodhje as që mund të bëhej fjalë. Njëri nga nënoficerët i kombësisë serbe, pasi që kishte prirje për muzikë, i bleu disa instrumente muzikore me një kredi dyvjeçare. Ndonjëherë ai na argëtonte në dhomë me këto instrumente. Në ndërkohë, ai u largua nga shërbimi aktiv në APJ. Pasi që unë isha garantuesi i parë i asaj kredie, pas tre muajsh, me një vendim të posaçëm, unë duhej ta paguaja kredinë e atij personi i cili e braktisi APJ-në. Çdo pësim është mësim, thotë një fjalë e urtë popullore, prandaj edhe për mua ishte e tillë, sepse në vijim isha i kujdesshëm se për kë do të garantoja. Punën e mëtejme si nënoficer, sikur e shihja pa ndonjë perspektivë, po gjithashtu edhe si detyrë shumë të rëndë, e shpeshherë edhe nënçmuese. Puna në terren sa vinte e shtoej. Ushtronim nëntë orë në relacionin Travnik- Jajce. Përherë isha me ushtarët dhe, mbase ndonjëherë, i urreja edhe ata, jo pse bënin ndonjë të keq, por për arsye se puna si këmbësor me ta ishte skajshmërisht e vështirë.

Fillimi i vitit 1962 më gjeti në të njëjtin garnizon, me të njëjtat detyra. Fitova një përvojë më të madhe në punë. Për çudi, babai im së bashku me babën e një nënoficeri nga fshati Hogosht, i cili punonte në ambulancë si teknik mjekësor, kishin ardhur për të më vizituar. Pas dy ditësh çmalljeje me të, babai u kthye në shtëpi.

Në muajin maj të po atij viti, papritmas, ishte shpallur konkursi për pranimin e kadetëve në akademi ushtarake. Të drejtë konkurrimi, përveç nxënësve të shkollave të mesme dhe gjimnazeve, kishin edhe nënoficerët e rinj. Pasi që i plotësoja kushtet për konkurrim, u paraqita te shefi i personelit të regjimentit, të nënkoloneli Terkula. Ai më pranoi dhe më premtoi se do të angazhohej personalisht për rregullimin e kësaj çështjeje dhe se do ta shkruante një rekomandim për mua si epror shembullor. Pasi që e dorëzova dokumentacionin e nevojshëm me postë zyrtare, për shkak të detyrave të shumta me ushtarë, sikur e kisha harruar këtë kërkesë. Në gjysmën e dytë të muajit qershor të vitit 1962 më erdhi radha që të shkoja në pushim vjetor. U nisa për në shtëpi. Duke pritur trenin që udhëtonte nga Sarajeva për në Beograd, në stacionin e quajtur "Llashva", afër qytetit të Zenicës, si rastësisht m'u kujtua kërkesa që kisha bërë më herët për t'u pranuar në Akademi Ushtarake. Pasi që kisha kohë të mjaftueshme, deri në nisje të trenit tjetër që shkonte në drejtim të Shkupit, vendosa të shkoja në

Sekretariatit Federativ të Mbrojtjes Popullore në Beograd, përkatësisht tek zyrtari i personelit, për t'u informuar për mundësinë e pranimit tim në Akademinë Ushtarake. Me letërnjoftim ushtarak u lajmërova në sportel dhe, pas një pritjeje 10-15 minutash, më lejuan të shkoja tek një nënkolonel, oficer i personelit. Pasi u prezantova kush isha dhe çka kërkoja, ai e shfletoi një regjistër dhe pa hamendje më tha: “Je pranuar në akademi të ushtrisë tokësore në Banjicë të Beogradit”. E zgjati dorën dhe më përgëzoi për pranim. Nuk e di se çfarë ndjenjash kam përjetuar në atë moment, por e di se nga kati i tretë kam ecur shkallëve poshtë në drejtim të sportelit ku e kisha lënë letërnjoftimin dhe, ashtu i hutuar, kam shkuar deri në bodrum gabimisht. Nga kënaqësia që po filloja një karrierë të re, isha mjaft i emocionuar. Nuk më kujtohet se si kisha kaluar rrugëve nga komunikacioni i dëndur në afërsi të stacionit hekurudhor të Beogradit. Më dukej se edhe unë, bashkë me trenin, fluturoja për Bujanovc. Kështu i kalova 20 ditë të pushimit vjetor, shumë i lumtur që po bëhesha kadet (student) i Akademisë Ushtarake. Gëzimin tim për pranim në akademi e përcillte edhe zhgënjimi se nuk do të mund të ndihmoja familjen materialisht. Sido që të jetë, u gëzuan të gjithë anëtarët e familjes për këtë lajm të mirë, e veçmas babai, i cili nuk kursente asgjë për shkollim. “Do t’ia dalim disi, vetëm mëso ti, biri im”, më thoshte ai duke më përqaftuar. Nga pushimi sërish u ktheva në Travnik për të vazhduar punën edhe për dy muaj.

## **Kadet i Akademisë Ushtarake**

Më 1 shtator 1962 u paraqita në Akademinë Ushtarake në Beograd, si 20 vjeçar. Shkova në një rreth të ri, ku konkurrenca për dije ndërmjet kadetëve ishte e madhe. Ata kishin ardhur nga viset e ndryshme të Jugosllavisë, me përgatitje të ndryshme paraprake. Unë kisha një përvojë mjaft të mirë ushtarake si nënoficer. Isha në përparësi në krahasim me ata që kishin ardhur nga gjimnazet dhe nga bankat e shkollave të tjera të mesme. Disa nga ata, meqë nuk mund të përshtateshin në kushtet e rrethanat e reja, e braktisnin shkollën. Kjo ndodhi edhe me dy shqiptarë nga Kosova, të cilët pas një muaji e braktisën akademinë. Ligjëratat fillimisht kishin karakter të njohurive të përgjithshme, siç ishin p.sh: Materializmi Dialektik, Sistemi Shoqëror Politik etj. Unë nuk kisha vështirësi me mësimin dhe përvetësimin e

tyre. Tanimë, e kisha përvetësuar gjuhën serbe dhe e kishte vështirë ndokush të më dallonte se isha shqiptar. Këtë mund ta kuptonte vetëm në rast të prezantimit, me emër dhe mbiemër. Madje gjuhën e zotëroja, në disa raste, më mirë se disa që e kishin gjuhë amtare. Në disa trajnime të mëvonshme, sidomos në përdorimin e minahedhësit 82 dhe 120 mm, isha më i miri në grupin tim. Edhe demonstrimet e tjera të cilat pasonin, nuk paraqisnin vështirësi për mua. Kur isha nënoficer, kisha para, ndërsa në akademi, ato më mungonin, qoftë edhe për duhan, të cilin e konsumoja. Në mungesë të cigareve, ndonjëherë e tymosnim një cigare 4-5 kadetë. Shumica e kadetëve, së paku një herë në muaj, merrnin para nga shtëpitë e tyre. Unë, për katër vite sa isha në akademi, asnjëherë nuk mora para nga askush, duke përjashtuar dy raste, kur kisha marrë ndonjë pako me biskota dhe cigare “Drava”. Si kadetë, kishim të drejtë të dilnim në qytet, dy herë në javë. Dy-tri vite me radhë shkonim kryesisht në Kalimegdan prej nga i shikonim lumenjtë Sava dhe Danub, si dhe lundrimin e anijeve të ndryshme. Duke shëtitur, takoja ndonjë shqiptar nga Kosova, ose nga ndonjë vend tjetër, që kishte shkuar për punë krahu e që m’i kujtonte vargjet e poetit tonë të mirënjohur, Esad Mekulit, që ua kishte kushtuar atyre. Me padurim prisja që të ndërroja ndonjë fjalë në gjuhën shqipe me ta. Kur ata më shihnin në uniformë të kadetit dhe kur e kuptonin se isha shqiptar, u shtoj kureshtja për të ditur diç më tepër për mua. Kur dilja vetë në qytet, shkoja drejt në stacionin hekurudhor të Beogradit për të marrë gazetën “Rilindja”. Edhe pse në uniformë ushtarake, e lexoja me një frymë atë. Njëherë, një kadet shqiptar, të cilin e kisha shok (nuk dua t’ia përmend emrin) m’u drejtua me këto fjalë: “Koleg, nuk shkon uniforma dhe gazeta shqip”. U fjalosa me të, duke ia bërë me dije se, edhe në uniformë, e ndieja veten përherë shqiptar. Prej atëherë, përkatësisht që nga viti 1962, për mua gazeta “Rilindja” ishte dhe mbeti një dritare që më sillte freski në shpirt e në mendje. Me të frymoja e jetoja shqip.

Isha në fund të vitit të parë të studimeve. Çuditërisht, gjatë provimeve dhe kolokuiumeve, notat mund të jepeshin edhe të përgjysmuara, bie fjala 8.5 e kështu me radhë. Pak para se ta mbaroja vitin e parë shkollor (qershor 1963), papritmas erdhi urdhri se notat duhej të rrumbullakoheshin. Kjo kompetencë iu dha shefit të grupit, një kapitenit të klasit të parë me mbiemrin Shqëpanoviq. Pasi që kishte përfunduar sipas tekeve të tij, gjatë kumtimit të suksesit, vërejta se m’u

kishin mbyllur notat për një gjysmë më poshtë, edhe pse të tjerëve, në shumicën e rasteve, iu kishin përmbyllur më lart. Kërkova sqarim dhe shpreha shqetësimin tim për padrejtësinë e bërë, por ai i zënë ngushtë, filloi të çirrej, duke më thënë se është e drejta e tij për të vendosur si do ai vetë. Më urdhëroi të ulesha e të mos më dëgjohej zëri. U ula shumë i zhgënjyer dhe i dëshpëruar për këtë padrejtësi. Mendoja që të ankohesha, por një shok i kombësisë serbe më luti që të mos i hyja kësaj pune, sepse do të më largonin nga akademia. E dëgjova dhe nuk u ankova më tutje, dhe bëra mirë, sepse pasojat do të ishin shumë më të mëdha. Kështu i erdhi fundi edhe vitit të parë të studimeve, të cilin e kreja me sukses shumë të mirë.

Ato ditë ndodhi edhe tërmeti shkatërrues i Shkupit. E hetuam edhe ne gjatë një ligjërate. Kadetët që ishin në katin e parë të ndërtesës dolën jashtë për dritare, ndërsa ne që ishim në katin e tretë nuk lëvizëm fare, përkundër shqetësimit që përjetuam.

Gjatë pushimit njëmuor në vendlindjen time, u furnizova me disa gazeta dhe me literaturë në gjuhën shqipe. I lexoja ato dhe përqendroheshja më shumë në historinë e popullit shqiptar, pasi që kisha pak njohuri për të. Në anën tjetër, kisha për qëllim që të mos e harroja gjuhën amtare, në të folur dhe në të shkruar.

Vitin shkollor 1963-1964 e filluam në të njëjtën ndërtesë, me disa ndryshime në përbërjen e grupeve të kadetëve. Planprogrami i kushtohej anës praktike të trajnimeve, sidomos lëndës së taktikës dhe përdorimit të armatimit. Ushtrimet bëheshin jo vetëm në Banjicë (ku ishte edhe akademia), por edhe gjetiu në rajonin e gjerë të Beogradit, siç ishte Mali i Avallës, Bujanj Potoku, Rakovica e gjetiu. Për mua nuk paraqiste ndonjë problem ana praktike e trajnimeve, sepse i kisha përvetësuar ato gjatë atyre dy viteve sa isha në cilësinë e nënoficerit në Travnik. Gjatë vitit të dytë të studimeve, një semestër mësonim edhe lëndën e motoristikës, në një kabinet të posaçëm për të. Njëkohësisht, përgatiteshim edhe për dhënien e provimit të vozitjes. Ky provim, përveç pjesës teorike, kishte edhe atë praktike, që nuk ishte e lehtë, sepse duhej të drejtohej kamioni i quajtur "Praga" ose "Dajc". Ushtrimet i bënim në relacionin Beograd - Avallë - Bujanj Potok dhe anasjelltas. Pas këtyre përgatitjeve, erdhi edhe koha për të hyrë në provimin teorik

dhe praktik, në relacionin Beograd - Kragujevc, kuptohet me kamion. Paraprakisht shtroheshin pyetjet teorike që ishin organizuan gjatë rrugëtimit. Kështu u pajisëm të gjithë me patentë shoferi.

Gjatë këtij viti shkollor i vizituam edhe disa garnizone në territorin e Serbisë. Vrojtua dhe kuptua mënyrën e udhëheqjes dhe të komandimit, nga niveli i togut deri te ai i batalionit. Kuptua tërë specifikën e punës në “trupë” siç e quanin atëherë punën me ushtarë. Nuk pata probleme në të kuptuar të kësaj lënde. Nuk munguan as lëndët e njohurive të përgjithshme, siç ishin materializmi dialektik, sistemi shoqëror politik, koncepti i mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes shoqërore, strategjia ushtarake, etj. Vizituam edhe disa fakultete të Universitetit të Beogradit, me ç’rast u njoftua me mënyrën e studimit dhe edukimit në këto institucione shkollore. Viti i tretë, përkatësisht viti shkollor 1964-65, më tepër i dedikohej shkrimit të dokumenteve të ndryshme, urdhëresave etj. Supozimet e ndryshme dhe detyrat e njësiteve deri në nivel të batalionit, të parashtruara në harta topografike, ishin metoda pune dhe aktiviteti për ne si kadetë. Nuk mungonin kundërgargumentet për versionet e ndryshme të përdorimit të njësiteve. Tre muaj i kalua në një poligon ushtarak, të quajtur Nabërgje (Nabrđe), afër Osjekut, në Kroaci. Në këtë poligon, përveç çështjeve të këmbësoresë, i mësonim edhe lëmitë e tjera, siç janë: artileria, njësitë tankiste, ato të ndërlihdjes etj. Organizoheshin gjuajtje me topa dhe “haubica” të kalibrit të madh, mandej gjuajtje praktike nga tanket, qoftë me armë automatike, qoftë me topa të instaluar në tanke. Më kujtohet gjithnjë se si çdo kadet ishte i detyruar të mihte transhenë, sa për t’u shtrirë në të dhe mbi ne do të kalonte tanku. Natyrisht se ishte ndjenjë e keqe kur tanku kalonte mbi trupin tonë, sidomos kur e mendonim mundësinë e prishjes (të ndaljes) së tankut mu mbi trupin tonë. Po në këtë vit, çdo kadet u caktua në ndonjërin nga tërë territoret e ish-Jugosllavisë për ta bërë praktikën një mujore, për të komanduar me kompani. Unë isha i caktuar në garnizonin e Sllavonska Pozhegës, në Kroaci. Ishte një regjiment i këmbësoresë, mjaft problematik. Ushtarët ishin kryesisht me përgatitje të ulët shkollore. Këtu nuk përjashtoheshin as shqiptarët, të cilët, sipas përshtypjes sime, ishin kryesisht të pashkolluar. Ata shpeshherë maltretoheshin nga eprorët e tyre. Unë ndihesha keq që nuk mund të ndryshoja asgjë në këtë drejtim.

Përfundova edhe vitin e tretë të Akademisë. Pasi pushimi njëmuor. Më pas, të gjithë u kthyem në Beograd për të vazhduar shkollimin në vitin e katër të studimeve, gjatë vitit shkollor 1965-66. Sipas planprogramit mësimor ishte e paraparë që shkollimi në vitin e fundit të akademisë të bëhej nëpër qendrat e ndryshme në territorin e ish-Jugosllavisë. Kështu, qendra për këmbësori, ku isha edhe unë, ishte në Sarajevë, për tankistë në Banjallukë, për mbrojtje kundërajrore në Zarë, për xhenio në Karlovac, për artileri në Zagreb. Ne të këmbësorisë u lajmëruam në kazermën “Marshali Tito” (ku ishte edhe pjesa e akademisë) dhe atë në postën ushtarake 9010 në Sarajevë. Mësimi ishte praktik në terren. Ishim vazhdimisht në lëvizje, merrnim pjesë në ushtrime të ndryshme dhe komandonim. Gjashtë muaj të tërë i kaluam në një poligon të quajtur Pazariq. Ishte ky një fshat kryesisht me myslimanë, 30 km larg Sarajevës, në drejtim të Mostarit. Rreth tij kishte fusha të mëdha e lëndina. Ishin tri pavijone ushtarake me kushte të mira për akomodim.

Këtu ishte një jetë shumë monotone. Kur vinte dita e diel, në atë fshat kishte më shumë kadetë sesa banorë vendës. Kryesisht pinim kafe e ndonjëri edhe nga një gotë raki. Në mungesë të parave, rrallëkush kishte mundësi të shkonte në Sarajevë. Ushtrimet i bënim praktikisht me ushtarë. Punën tonë e përcillnin oficerë të caktuar, si komandantë të grupeve të kadetëve. Lodheshim shumë, sepse ushtrimet i bënim në drejtime të ndryshme, duke ecur në këmbë, duke komanduar, duke sugjeruar e duke vrojtuar. Derisa ne kadetët punonim dhe angazhoheshim për një notë më të mirë, ushtarët ishin tej mase të ngarkuar fizikisht, sepse bartnin në supet e tyre pushkomitralozin, tromblonin, minahedhësin, municionin, etj. Nëse nuk kryheshin mirë ushtrimet, ato duhej të përsëriteshin. Me këtë rast ishin të pashmangshme reagimet e ndonjërit nga ushtarët, të cilët i akuzonin kadetët për komandim të dobët ose mosprecizitet të duhur të detyrës. Sidoqoftë, kjo ishte ngarkesë edhe për mua si kadet, edhe pse i kryeja të gjitha detyrat me përpikëri. Në vazhdimësi përcilleshim nga eprorët. Edhe këtij viti shkollor i afrohej fundi. Ishim në vllugun e përgatitjes së provimeve përfundimtare. Punonim në grupe, por edhe individualisht.

Muaji qershor i vitit 1966 më mbeti në kujtesë edhe për një ngjarje të jashtëzakonshme. Fjala ishte për një ngjarje politike që pakkush e kishte pritur. Erdhi lajmi se Titoja e kishte shkarkuar nga detyra



e ministrit të brendshëm Aleksandër Rankoviçin. Atë ditë ishim në një fushë ku do të kryhej një ushtrim, përkatësisht demonstrim për gjuajtje me minahedhës. Dikush pati radio dhe e dëgjoi lajmin për shkarkimin e Rankoviçit. Ky lajm u përhap shumë shpejt tek të gjithë kadetët. Askush nuk guxonte ta komentonte këtë. Afër meje ishte një kadet, i lindur në Zhitoragjë të Prokuples. Ai, me këtë rast, sikur m'u drejtua mua se kjo nuk mund të ishte e vërtetë. Unë nuk e komentova këtë, vetëm i rrudha krahët. Ai ishte befasuar dhe ishte zhgënjyer shumë për marrjen e këtij lajmi dhe gati tërë ditën nuk foli me askënd. Pasuan informimet e njëpasnjëshme, sidomos në tubimet partiake, duke na shpjeguar domosdoshmërinë e shkarkimit të ministrit të brendshëm. Pas shkarkimit të tij sikur filloi "të shkrihej akulli" i marrëdhënieve ndërnacionale. Vërehej një qëndrim më i butë ndaj shqiptarëve, por edhe ndaj të tjerëve të përkatësive nacionale joserbe.

Në ndërkohë, pasuan provimet përfundimtare të cilat zgjatën dy javë. Ishin këto provime praktike në terren, përkatësisht në rajonin e fshatit Pazariq, të dominuar nga uniformat ushtarake. Më kujtohet se për provim praktik nga lënda e taktikës është dashur ta përgatisja dhe ta realizoja konkretisht para komisionit temën "Kompania e këmbësorisë në sulm". I tërë procesi kishte zgjatur rreth tri orë. Komandimi im dhe urdhëresat që i dhashë gjatë këtij ushtrimi, ishin të zëshme dhe të qarta, prandaj më ftoi kryetari i komisionit, një nënkolonel i nacionalitetit sloven, që aty për aty të ma tregonte notën. Në mënyrë të prerë më tha: "Të lumtë, kadet! Kështu komandohet dhe unë të vlerësoj me notën nëntë". Duke ma shtrirë dorën dhe duke më përgëzuar për këtë sukses, ndër të tjera shtoi: "Për oficerë të këtillë kemi nevojë ne". Paksa i habitur u gjeta në përqaftimin e kadetëve të tjerë, të cilët më kishin përcjellë gjatë tërë kohës. Mbase, këto ishin edhe notat e fundit.

Në Beograd kishin filluar përgatitjet për takimin e të gjithë kadetëve që kishin qenë të shpërndarë për një vit, thuaja se nëpër të gjitha qendrat dhe viset e Jugosllavisë. Më 1 korrik, të gjithë kadetët u grumbulluan në ndërtesën e Akademisë Ushtarake të Ushtrisë Tokësore në Banjicë të Beogradit. Na ngarkuan me rroba dhe gjësende të oficerit. Pritnim dekretin e komandantit suprem, J.B.Tito, për të na avancuar në gradën fillestare të oficerit, përkatësisht të nëntogerit. Filluam trajnimin për marshin solemn, për parakalimin që do të mbahej në ditën e avancimit,

më 20 korrik 1966. Ne si kadetë nuk kishim qenë të informuar se për pjesëmarrje në këtë ditë solemne, drejtoria e akademisë i kishte ftuar prindërit tanë me një shkresë të posaçme. Atë ditë, papritmas, u shfaq edhe babai im, Bahtiari. Me t'u përshëndetur me të, ai filloi të qante, i mbërthyer nga emocionet, nga kënaqësia që unë kisha diplomuar. Ai nuk mund t'i besonte faktit se djali i tij do të mund të bëhej oficer pikërisht në vendin ku ai kishte kryer shërbimin ushtarak, në kravelevinën (mbretërinë) e atëhershme, në Beograd dhe pikërisht në Banjicë.

U rreshtuam sipas komandave dhe grupeve për parakalim. I kishim veshur rrobat solemne me gradën e oficerit. Para rreshtit tonë kishte shumë civilë, prindër e familjarë të kadetëve, por edhe qytetarë të Beogradit. Pasi që iu dha raporti një gjeneralkolonelit të quajtur Rade Hamoviq, si përfaqësues special i presidentit të atëhershëm, dhe pas intonimit të himnit, filloi leximi i emrave dhe mbiemrave të të gjithë të graduarve.

E dinim se do të avancoheshin në gradën e nëntogerit, po nuk e dinim se ku do ta fillonim karrierën ushtarake. Gati se ishte e pamundshme ta dinim këtë. Sërish filloi leximi i emrave, por tani me numrin e postave ushtarake dhe të garnizonit ku duhej të shkonim në detyrë. Më kapluan emocionet. Sikur e kisha një parandjenjë se do të mbetesh dikur në armatën e Beogradit. I erdhi radha edhe leximit të mbiemrit dhe emrit tim. Nuk mund t'i besoja as veshëve të mi. Më kishin caktuar për të shërbyer në postën ushtarake në garnizonin e Prishtinës. Më në fund, edhe një dëshirë e kamotshme u bë realitet. Lumturia nuk mund të përshkruhej me fjalë. Gjatë rrugëtimit nga Beogradi në drejtim të Kamenicës, më dukej se edhe babai im sikur dyshonte për mundësinë e fillimit të karrierës së oficerit në garnizonin e Prishtinës.

## **Fillimi i karrierës si oficer**

Pas pushimit njëmuor, ne pesë oficerët që ishim caktuar u lajmëruam në komandën e garnizonit, e cila atëbotë ishte e vendosur në ndërtesën e tanishme të muzeut të Kosovës. Mua më caktuan në detyrë të komandantit të togut të parë të një çete të pavarur. Komandant i kësaj kompanie (çete) ishte një kapiten i klasit të parë me emrin Jovan Martinoviq, malazias i dalë nga lufta, por i pashkolluar. Më pranoi mirë, por në fakt gradualisht më ngarkoi edhe me të gjitha punët rreth mbajtjes

së këtij njësiti në gatishmëri, siç thoshin ata, të lartë. Dy ditët e para, derisa u akomodova në kazermë, u detyrova që me një koleg ta gjeja një banesë në qytet. Pronari i banesës që e gjetëm ishte një nënoficer maqedonas. E shfrytëzoni vetëm njërën nga dhomat e asaj banese.

Ato ditë vjeshte të vitit 1966, njësiti ku shërbeja, sipas planit, kishte të parapara shumë ushtrime-trajnime të natës. Fillova të bëja përgatitjet për realizimin e këtyre ushtrimeve. Ato, si me rregull, i organizova në rajonin e Gërmisë. Ishte ky një mal plotësisht i pastër, i ruajtur nga rojet e malit. Unë, me një staf prej 3 - 4 nënoficerësh, si me rregull, qëndroja në një shtëpi, e cila quhej shtëpia e rojës së pyllit, prej nga drejtoja ushtrimin me mjete të lidhjes, të cilat përdoreshin në atë kohë. Nga këto ushtrime, shpeshherë, pas gjysmës së natës, ktheheshim me çizme të përbaltura në banesë. Pronarja e banesës më dilte përpara dhe ma tërhiqte vërejtjen që të mos hyja brenda para se t'i pastroja çizmet. Kjo më shqetësonte pa masë, ngase e respektoja rendin shtëpiak, edhe kur kthehesha nga terreni shumë i lodhur. Pas dy muajsh, u detyrova ta ndërroja banesën. U vendosa në një dhomë të një banese, në njërin nga rrokaqiejt, në afërsi të Qendrës së Rinisë, të quajtur, "Boro e Ramizi". Aty hasa në një familje, e cila më kuptonte, edhe kur vonohesha për shkak detyrave të ndryshme ushtarake. Siç thashë, në fakt, unë i kryeja të gjitha detyrat që i takonin komandantit të kompanisë. E organizova një ushtrim demonstrues për të gjithë oficerët e brigadës në hapësirat e kazermës së quajtur "M.Tito" për t'iu treguar se si duhej të menaxhohej me njësitin e rangut të kompanisë. Erdhën të gjithë eprorët ushtarakë. Kalova shumë mirë. Para të pranishmëve më lavdëroi koloneli, komandanti i brigadës.

Pasuan edhe detyra të tjera mjaft të vështira. Por, si rëndom, edhe pse isha shumë i ngarkuar me punë, ato i kryeja me përpikëri. Të gjithëve u rashë në sy si epror i vyeshëm dhe me dituri të mjaftueshme, sidomos për detyra të taktikës luftarake. Në shkurt të vitit 1967 u organizua një llogorim në lëvizje në kushte dimërore. Kishte rënë një borë e madhe. Natën e parë organizuam fjetjen në shkollën atëherë të vjetër të Arllatit. Gjumin e bëmë në kashtë, të mbuluar me batanije ushtarake. Ushtrimi 10 ditor mbaroi në Xërxë, edhe atë në kushte shumë të vështira meteorologjike. Nuk m'u lëndua asnjë ushtar. Ishte ky sukses i padiskutueshëm. U kthyem në kazermë. Bëmë analizën e ushtrimeve në kushtet dimërore.

# **PJESA E TRETË**

**MARTESA DHE ANGAZHIMI IM  
NË UNIVERSITET**

Derisa në planin zyrtar gjërat më shkonin kryesisht mirë, në atë privat kisha mjaft probleme. Prindërit, vëllezërit dhe motrat, në fshat vazhdonin të jetonin në kushte shumë të vështira ekonomike, kërkonin nga unë ndihmesë financiare, e që sipas mundësive edhe e bëja. Kur i ndaja nga buxheti im paratë për qira dhe ato për prindërit, mua më mbeteshin sa për ekzistencë. As që mund të bëhej fjalë për një jetë më të mirë të një të riu. Ishin këto disa nga problemet me të cilat përballesh në atë kohë.

Ndërkohë, u fejova me një vajzë shqiptare nga Kamenica, me Nazmije Mavriqin. Meqë ishte e pamundshme të merrja banesë, si i pamartuar, vendosa që të martohesha pas 2-3 muajsh fejese. Ishte ky muaji prill i vitit 1967. Martesën e bëra pa dasmë, sepse kushtet financiare e diktonin këtë. Vetëm tre muaj të martesës i kaluam në një banesë private. Pas tre muajsh, më ftuan në komandë dhe më konfirmuan ndarjen e një banese zyrtare. Ky edhe ishte qëllimi im. Kuptohet, kujdesi për prindërit dhe familjen në tërësi ishte dhe mbeti detyrë e përhershme. Mirëpo, tanimë kisha obligime edhe ndaj familjes sime të ngushtë. Pas martesës sime, një oficer i sigurimit më ftoi në bisedë informative, për të parë për së afërmi se me kë isha martuar. Pasi që më dëgjoi, pak sa i habitur, sikur ma zgjati dorën të më uruar martesën. Kjo për arsye se të rinjtë shqiptarë - eprorët ushtarakë, në shumicën e rasteve martoheshin me serbe. Ky ishte edhe synimi i organeve të sigurimit atëherë. Unë, si duket, iu kisha dalë jashtë kontrollit, sepse isha martuar me një vajzë shqiptare. Përafërsisht 3 muaj pas martesës sime, më urdhëruan që të lajmërohem në komandën e Armatës së Shkupit, përkatësisht në drejtorin e personelit. Fjala ishte për mundësinë e transferimit tim në njësitin gardist në Beograd. Me të kuptuar këtë u shqetësova tej mase, njëjtë sikur edhe bashkëshortja ime, e cila ende nuk i kishte mbushur të njëzetat. Ajo më bëri shoqëri dhe me një autobus udhëtuam për Shkup. Sapo hyra në ndërtesë të komandës vërejta shumë oficerë të ftuar në intervistë. Pasi më erdhi radha iu lajmërova komisionit intervistues në krye me një kolonel. Në pyetjen se a jam i martuar dhe pasi dhashë pohimin se një gjë të tillë e kisha bërë para tre muajsh, sikur rashë prej kombinimit që të më transferojnë në gardë. Në fakt as që pretendoja që të shkoja atje duke i ditur tërë specifikat e kësaj detyre. Kështu, shpëtova nga transferimi.

Në planin zyrtar nuk kishte ndryshime. Punët shkonin mirë. Në çdo 6 muaj pranohim ushtarë të rinj. Gjërat filluan të përsëriteshin, sidomos kur ishte fjala për planprogramin mësimor. Përgjegjësia ishte e madhe, aq më parë që punonim me njerëz të rinj dhe të nacionaliteteve të ndryshme. Vitin e ri 1967-68 e prita me bashkëshorten time në Shtëpinë e Armatës, siç quhej atëherë kjo në Prishtinë. Organizimi i pritjes së Vitit të Ri ishte i centralizuar nga lart-poshtë dhe çdo mosprezencë apo shmangie nga festimet e tilla dhe të ngjashme u binte në sy organeve të sigurimit. Parulla e “vëllazërim-bashkimit” vlente gjithnjë, pra edhe për ahengje. Nuk vonoi shumë dhe, papritmas, më ftuan në komandë për të më kumtuar urdhëresën se duhej të shkoja në kurs për udhëheqje dhe komandim, i cili do të zgjaste 5 muaj. Bashkëshortja ime, e cila ishte shtatzënë, do të mbetej në banesë me vëllanë tim, Lutfiun, i cili ishte regjistruar në shkollën e mesme teknike në Prishtinë. Të gjitha shpenzimet lidhur me shkollimin e tij katërvjeçar ishin barrë shtesë mbi supet e mia.

Për të marrë njohuritë e duhura për udhëheqje dhe komandim, qëndrova 5 muaj me radhë në Pançevë dhe nëpër njësitë e ndryshme të garnizonit të Beogradit. Më 27 maj 1968, bashkëshortja ime lindi vajzën e parë, Eminen. Unë isha në terren në rajonin e Uzhicës, përkatësisht në malin Zllatibor dhe nuk munda ta vizitoja atë. Pas një muaji u ktheva në shtëpi dhe për herë të parë e pashë vajzën time njëmuajshe. Pas lindjes së fëmijës së parë, ma dhanë një banesë më komode, në njërin nga rrokaqiejt, afër Qendrës së Rinisë “Boro e Ramizi”.

Pasi që komandanti i deriatëhershëm, i dalë nga lufta, Martinoviqi u pensionua, mua më caktuan në detyrën e komandantit të kompanisë. Arrita që kompaninë time ta mbaja në radhët e njërive më të mira. Pas pushimit vjetor, në vjeshtën e vonë, u ndryshua përbërja e ushtarëve. Stërvitjet mbaheshin në vazhdimësi.

## **Demonstratat e vitit 1968**

Më 28 nëntor 1968 shpërthyen demonstratat e para të shqiptarëve në Prishtinë. Në qarqet ushtarake u krijua një rrëmujë e madhe. Na ftonin në mbledhje urgjente të njëpasnjëshme. Në kazermën “M.Tito”

tërë njësia u vu në gatishmëri luftarake, por vetëm në kuadër të kazermës. Mu para Shtëpisë së Armatës, diku në lokacionin e tanishëm të hotelit “Grand”, u vra një demonstrues shqiptar. U shqetësova tej mase. Vazhdimisht mendoja për mundësinë e marrjes së urdhrit për përdorimin e njësitit tim kundër popullatës. Si të veproja atëherë?! E analizoja në detaje mundësinë e dezertimit tim. Mirëpo, për fat u vendos që ushtria të mos përdoret atëherë. Në veprim ishte policia dhe shërbimi sekret (UDB-ja). Në ndërkohë situata vinte duke u qartësuar dhe duke u qetësuar.

Këto demonstrata patën jehonë të madhe pozitive, sepse siç dihet, tanimë Rankoviçi, ish-ministër i brendshëm, nuk ishte më në “fuqi”. Në qarqet politike të ish-Jugosllavisë filloi të shqyrtohej pozicioni dhe të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi, me theks të veçantë në Kosovë. Informatat për zhvillimin e ngjarjeve i merrnim nëpërmjet organizatës politike të LKJ në kuadër të APJ-së. Një herë në javë kishim për detyrë të merrnim pjesë në debat politik për çështjet e ndryshme. Përveç përgatitjeve që duhej t'i bëja individualisht për të mos shkuar në debat i papërgatitur, duhej të shtohesh kujdesi edhe gjatë diskutimit, sepse organet e sigurimit më pastaj na ftonin dhe na maltretonin në mënyra të ndryshme.

Edhe pse grada e nëntogerit, sipas ligjit të atëhershëm, mbahej për tre vite me radhë, më 22 dhjetor 1968, papritmas më kumtuam urdhëresën për avancim në gradë të togerit, një vit para afatit të caktuar. Ky ishte një lloj shpërblimi për punën që bëja dhe për rezultatet që i kisha arritur. Kështu filloi ngritja ime në hierarkinë ushtarake vetëm në bazë të angazhimit tim personal dhe pa asnjë ndihmesë nga askush. Në këtë periudhë kohore arrita të krijoja një rreth të shokëve intelektualë nga meset e ndryshme. Vazhdoja të lexojë literaturë të ndryshme në gjuhën shqipe. Në ndërkohë lindi vajza ime e dytë, Feimja.

## **Angazhimi në procesin mësimor në UP**

Në shtator të vitit 1969 më ftoi në zyrën e tij një kolonel me mbiemrin Preleviq, që si duket ishte malazias. Paksa u habita, sepse për atë kohë, kur të ftonte koloneli, ishte gjë e rëndësishme. Me të hyrë në zyrën e tij,

pas prezantimit tim, ai më urdhëroi që të ulesha dhe, për çudi, porositi kafe. Nuk dija për çka më kishte ftuar. Bisedën e filloi me atë se si ai e ligjëronte lëndën mbrojtja popullore dhe vetëmbrojtja shoqërore në Shkollën e Lartë Pedagogjike (SHLP) në Prishtinë, por në gjuhën serbe. Më shpjegoi se tani kishte ardhur koha që kjo lëndë të ligjërohej në gjuhën shqipe. Ma dha planprogramin dhe disa shënime që ai i kishte përgatitur dhe më udhëzoi që t'i lajmërohesha te drejtori i atëhershëm i kësaj shkolle, te i ndjeri Bardhyl Zajmi. Paksa i hutuar, pas dy ditësh, në uniformë të oficerit, trokita në derë të kabinetit të tij. Më pranoi shumë mirë dhe më udhëzoi që ligjëratat t'i mbaja në gjuhën shqipe dhe që të përgatitesha në aspektin akademik.

Kështu ia fillova punës plotësuese edhe si ligjërues në SHLP. Orët e ligjërimit m'u caktuan dy herë në javë, pasdite. Në orën e parë që mbajta, i njoftova studentët me planprogramin mësimor të atij viti shkollor. Ata ishin të entuziazmuar dhe më përcillnin me kureshtje, sepse u flisja në gjuhën shqipe. Si duket, unë isha ligjëruesi i parë ushtarak i karrierës që fillova ta ligjëroja këtë lëndë shqip.

Përveç obligimeve në planin zyrtar në kazermë, tani m'u shtuan edhe ato si ligjërues. Më pas zgjerova angazhimin tim akademik ngase fillova të ligjëroja edhe në Fakultetin Juridik. Për punën e kryer merrja një pagesë në bazë të orëve të mbajtura. Pagesa (honorari) ishte mjaft e dobët, por këtë honorar e tërhiqja në çdo 3-6 muaj dhe atëherë kjo pagesë nuk më dukej edhe e vogël.

Angazhimi im në dy fronte më ngarkoi së tepërmi. Disa eprrorë ushtarakë sikur filluan të më shikonin si një eprror tepër i "albanizuar" – kjo për arsye të kontributit profesional që i jepja gjeneratave të reja dhe atë vetëm në gjuhën shqipe. Ligjërimet i vazhdova deri më 1987, me disa ndërprerje të vogla.

Në planin zyrtar, përkatësisht të komandantit të kompanisë, isha në listën e eprrorëve të suksesshëm, falë afinitetit dhe përkushtimit tim për organizimin dhe menaxhimin e punës nëpërmjet zëvendësimit tim, një nëntogeri dhe tre nënoficerëve të nacionalitetit serb. Nga ata kërkoja përgjegjësi. Ushtrimet, trajnimet, gjuajtjet, llogorimet etj, nuk kishin të ndalur.



Në planin privat puna më shkonte kryesisht mirë, edhe pse angazhimi im dhe i bashkëshortes sime për anëtarët e tjerë të familjes sidomos kur ata detyroheshin të udhëtonin në Prishtinë për vizita mjekësore, për rregullim të dokumentacionit etj., ishte një ngarkesë shtesë për ne. Përkundër vështirësive me të cilat ne përballeshim gjatë kryerjes së këtyre punëve, prindërit e mi dhe të bashkëshortes sime përherë kishin përkrahjen tonë. U ndihmonim në çdo sferë të jetës.

Më 1971 u lind vajza e tretë, Hyrija. Si familje pesanëtarëshe nuk e kishim ndonjë standard të lakmueshëm të jetesës, sepse vazhdoja të ndihmoja materialisht edhe më tutje prindërit e mi, vëllezërit dhe motrat.

**PJESA E KATËRT**  
**NGRITJA E MËTEJME**  
**NË PLANIN USHTARAK**

Në fund të këtij viti u shpall konkursi për vazhdimin e studimeve dyvjeçare në Akademinë Komanduese Shtabore të Ushtrisë Tokësore, shkollim që mundësonte ngritje ushtarake pa kufizime të veçanta deri në gradën e kolonelit. Në atë kohë ende nuk e kisha marrë gradën e kapitenit dhe më konsideronin si relativisht të ri. Pasi më informuan zyrtarisht lidhur me këtë, fillova ta grumbulloja literaturën e nevojshme për dhënien e provimit pranues. E dija se numri i kandidatëve për pranim ishte i madh dhe gjasat për pranim ishin të kufizuara. Autoritetet kompetente, përveç lëndëve thjesht ushtarake, për provim pranues kishin futur edhe matematikën, kiminë e fizikën. Gjatë përgatitjes së provimeve ushtrorja edhe me dy studentë që e njihnin mirë matematikën dhe ata më ndihmuan mjaft. Krahas përgatitjes për provim pranues nuk mungonin edhe problemet familjare. Edhe pse për fëmijët kujdesej kryesisht bashkëshortja, i ndihmoja edhe unë, kur më jepej mundësia. Kur mori vesh babai im se duhej t'i nënshtrohesha provimeve pranuese për shkollim të mëtutjeshëm, paksa i hidhëruar, filloi të më qortonte: "Biri im, ti tani ke bashkëshorten, fëmijët, pagën, banesën, je pranë prindërve... ç'kërkon tjetër?". Ai më bënte trysni që të mos largohesha nga Prishtina.

Në muajin mars të vitit 1972 ishte koha e provimeve. Dy ditë para se t'i nënshtrohesha provimeve, shkova në Beograd. U vendosa në një banesë të një nënoficeri që ishte nga Kosova, por që kishte punuar me mua në Prishtinë. Arrita t'i përsërisja disa mësimet nga lënda taktika dhe strategjia ushtarake. Në ditën e fillimit të provimeve u mblodhëm në një amfiteatër, ku prezantonin shumë oficerë. Na kumtuan orarin e provimeve. Atëherë përflitej se, për një vend në Akademinë Komanduese Shtabore, kishin konkuruar 4 kandidatë. Isha mjaft pesimist. Filluan provimet. Në lëndët ushtarake kalova shumë mirë. Problemi qëndronte tek lëndët e përgjithshme. Hyra edhe në ato që ishin me shkrim. Kaluan shtatë ditë të qëndrimit tim në provime. Dita kur do të kumtoheshin rezultatet ishte mjaft e zymtë. Megjithatë m'u kumtua lajmi se kisha kaluar provimin pranues. U ktheva në Prishtinë. Shpejt u përhap lajmi për pranimin tim në atë shkollë.

Më 1 shtator të vitit 1972 duhej të fillonin ligjëratat. Më silleshin në kokë lloj-lloj mendimesh. Nuk dija çfarë të bëja me bashkëshorten dhe fëmijët. Të mbetej ajo në Prishtinë me fëmijë, ndërsa unë të ndiqja ligjëratat dhe kohë pas kohe të udhëtoja në relacionin Beograd-

Prishtinë, ishte shumë vështirë. Babai më kishte propozuar që fëmijët t'i ktheja në fshat dhe ai të kujdesej për ta. Kuptohet, pagën mujore duhej t'ia dërgoja atij. Ky propozim nuk më konvenonte për shumë arsye, por megjithatë, botëkuptimet e tij ishin të atilla. Vendosa të kërkoja një banesë private, sa më afër akademisë, në Beograd dhe atje të vendosesha me familje. E gjeta një banesë relativisht të përshtatshme dhe shumë afër akademisë. Babai im me botëkuptimet e tij nuk mund të pajtohej me këtë fakt. Mendonte se nuk do të kthehesha më në Prishtinë. Mora vendimin më të mirë të mundshëm. U vendosa në banesë dhe, pas 3-4 ditësh të akomodimit, fillova t'i dëgjoja ligjëratat. E fillova atë vit shkollor me një vullnet të madh. I tërë grupi prej 25 vetash ishin të motivuar për mësim dhe çdonjëri nga ne donte të tregohej më i mirë se tjetri. Brenda një muaji u pa qartë se çfarë aftësish kishim për lëndët e caktuara, po edhe ku qëndronin dobësitë tona. Marrë në tërësi, ishim një grup oficerësh mjaft homogjen, edhe pse ishim gati nga të gjitha viset e Jugosllavisë.

Semestri i parë kryesisht kaloi me trajtimin e çështjeve teorike. Literatura ishte e bollshme në bibliotekën e qendrës së lartë shkollore. Kisha aftësi që disa gjëra më të rëndësishme nga ligjëratat e ndryshme t'i shënoja edhe në formë të stenogramit. Në këtë semestër u prezantova me dy kolokuiume dhe me tri punime seminari.

Pas pushimit semestral dyjavor, që e kalova në vendlindje, me bashkëshorten dhe fëmijët, iu përkushtova mësimëve, përkatësisht studimeve që kishin të bënin me lëndët ushtarake, siç ishin: taktika, operativa dhe strategjia. Për disa detyra nga taktika, në bazë të supozimeve të kompozuara në hartat topografike, filluam të dilnim në terren. Kryesisht, pikat e shqyrtimit ishin në rrethinë të Beogradit, objekti i gjerë i Avallës, Bubanj Potoku, Mlladenovci, Llazarevci etj. Më kujtohet se dy detyrat e para kishin të bënin me nivelin e batalionit të motorizuar, ndërsa të tjerat ishin të nivelit të regjimentit, përkatësisht të brigadës. Nuk ishte edhe lehtë të shtjellosh të gjitha kërkesat që ishin të parashtruara e që i përkisnin, përveç këmbësisë, edhe lëmive të tjera, si artileria, xhenio, ndërlihdja, mbrojtja kimiko-biologjike etj.

## **Amendamentet Kushtetuese dhe Kosova**

Gjatë kësaj periudhë kohore përpiloheshin të ashtuquajturat amendamente kushtetuese, që do t'i paraprinin edhe një lloji të

decentralizimit të republikave dhe krahinave autonome. Gjatë hartimit të këtyre amendamenteve bëhej zhurmë e madhe, sipas të cilave Kosova trajtohej si krahinë autonome, po që kompetencat i kishte si të republikave të tjera. Pasi që, së paku një herë në muaj debatonim për çështje të ndryshme politike, i erdhi radha edhe trajtimit të amendamenteve kushtetuese. Diskutimin lidhur me këto ndryshime e udhëhiqte një profesor i cili ligjëronte lëndën “Sistemi shoqëror politik”. Çdonjëri prej nesh ishte i vetëdijshëm se në këto biseda (diskutime), të cilat quheshin të “lira”, duhej pasur kujdes, sepse organet e sigurimit më vonë kishin autorizim që të na ftonin në biseda informative, por edhe që të na largonin nga shkolla. Në një pyetje e cila kishte të bënte me Kosovës, përkatësisht me atë përse ajo nuk mund të ishte Republikë, argumentet ishin se dy shtete shqiptare nuk mund të ekzistonin (duke menduar në shtetin e Shqipërisë dhe atë të Kosovës). Ky ishte në fakt argumenti kryesor që përdorej atëherë. Sikur shumica e oficerëve të tjerë, edhe unë i përgatisja konceptet me shkrim dhe u përmbahesha shprehimisht tematikës dhe direktivave të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë (KQLKJ), e që rregullisht na i shpërndanin për përdorim. Trysnia psikike dhe dilema se a do t’ia dilja ta kryeja shkollimin për shkak të mundësisë që ndokush të më etiketonte apo tërthorazi të ma shpikte ndonjë qëndrim “separatist”, ishte shumë e madhe.

Përveç këtyre detyrave zyrtare, gjeja kohë që me familjen time të dilja në piknik nëpër vende të ndryshme, me “fiqën” time, “Zastava 750”. Nuk mungonin as vizitat e farefisit tim dhe të bashkëshortes sime. Në atë kohë qarkullonte me rregull autobusi në relacionin Kamenicë-Beograd, që e mbante “Kosovatransi” i atëhershëm.

Viti i parë i studimeve mbaroi me disa teste dhe me një detyrë taktike të nivelit të brigadës. Në bazë të parametrave të caktuar, shtjellova detyrat për temën “Brigada e këmbësisë në marsh dhe kalimi në sulm”. Këto nuk ishin detyra të lehta. Në këtë temë punova dy muaj, krahas ligjëratave dhe obligimeve të tjera.

Pas pushimit njëmuajor, sërish me familje u ktheva në Beograd, por më duhej të kërkoja banesë tjetër, sepse pronari i banesës ku isha më parë, qëllimisht e kishte ngritur çmimin e saj dhe unë nuk mund ta përballoja këtë çmim. I shfletova faqet e gazetave, në të cilat publikohej dhënia e banesave me qira dhe rastësisht më shkuan sytë në gazetën

e përditshme “Borba”, në të cilën shkruante se një person, në lagjen “Milakovac”, jo fort larg akademisë, e lëshonte me qira banesën e tij. Kontaktova me të dhe shumë shpejt u morëm vesh për çmimin dhe gjërat e tjera, aq më parë që ky ishte shqiptar nga fshati Brodosanë i Dragashit. I vendosa në të mobilet dhe gjësendet e tjera dhe përfundimisht u akomodova së bashku me 5 anëtarët e familjes për një periudhë njëvjeçare.

Viti i dytë filloi me një vizitë dyjavore të disa garnizoneve dhe njësiteve të caktuara, duke studiuar problemet dhe vështirësitë e menaxhimit të komandave dhe njësiteve të caktuara. Transportimin tonë e bënë me autobus ushtarakë ose helikopter, varësisht nga largësia e garnizoneve dhe nga detyrat që kishim për t’i shtjelluar. Me t’u kthyer në akademi na pritnin detyra të tjera, që kishin karakter të menaxhimit të shtabeve dhe komandave të batalioneve dhe brigadave, të krijimit të dokumentacionit, përpilimit të planeve luftarake, etj. Pas mbarimit të semestrit të tretë dhe vazhdimit të të katërtit, përveç fillimit të përgatitjeve për provime përfundimtare, shumica prej nesh filluam të mendonin se ku do të transferoheshin pas mbarimit të këtij shkollimi, i cili, pa mëdyshje, mundësonte avancim dhe karrierë të mirë ushtarake, deri në gradën e kolonelit.

Një muaj para se të mbaronte shkollimi, në fakt, filluan diskutimet për vendet e mundshme të transferimit, përkatësisht të përcaktimit në garnizonet e armatës jugosllave. Disa eprorë filluan t’i kontaktonin përfaqësuesit e drejtorive të ndryshme të ish-Sekretariatit Federativ të Mbrojtjes Popullore.

## **Përgatitjet për transferim nga Beogradi**

Një ditë më ftuan që të lajmërohesh te një gjeneral, të cilin nuk e njihja, po që, siç mora vesh, ishte shef i sigurimit të brendshëm ushtarak. Derisa arrita në zyrën ku ai qëndronte, më kapluan emocionet, sepse nuk e dija arsyen e asaj ftese. Pasi iu prezantova sipas rregullit ushtarak, më urdhëroi të ulesha. M’u prezantua me mbiemrin Domankushi dhe i prezantoi dy shoqëruesit e tij (një kolonel dhe një major). Pasi që foli për rëndësinë e sigurimit të brendshëm ushtarak, më propozoi që të punoja në këtë shërbim dhe si kundërshtëpërbim do të kthehesha në garnizonin e Prishtinës, prej nga kisha ardhur në

shkollim. U kujtova pak dhe i thash se më shumë do të doja të shkoja në një detyre komanduese, përkatësisht për komandant të batalionit, sepse, siç e theksova posaçërisht, kisha prirje për detyrë menaxhuese. Mirëpo, sigurisht se gjatë bisedës përdora një gjuhë diplomatike. Ekipi që më mori në pyetje sikur nuk e priste përgjigjen time. Më urdhëruan që të dilja jashtë. Ata vazhduan bisedat me eprorët e tjerë.

Në ndërkohë, pasi që i analizova gjërat pak më në detaje, u binda se pas kësaj bisede nuk do të më kthenin në Prishtinë. Siç e theksova edhe më herët, në Beograd isha me bashkëshorten dhe me tre fëmijët e mi. Eminja, vajza ime e madhja, në muajin maj të vitit 1974, sapo i kishte mbushur 7 vjet. Më 1 shtator, ajo duhet t'ia fillonte mësimin në shkollën fillore. Përveç gjuhës amtare shqipe kishte vetëm pak njohuri për gjuhën serbo-kroate. Druaja se transferimi im në ndonjërin nga republikat e ish- Jugosllavisë, ku nuk flitej gjuha shqipe, do të ishte sfiduese për vajzën time. Vlerësimi im doli i saktë. Kishin vendosur që të më transferonin në Republikën e Sllovenisë.

Një ditë pas ditësh, më ra ndërmend për një oficer i cili më parë kishte punuar me mua në Prishtinë, por që para disa vitesh ishte transferuar në Sekretariatit Federativ të Mbrojtjes Popullore (SFMP). E kërkova në sportel të Policisë Ushtarake. Më thanë se ai punonte në drejtorinë e personelit. Pas kërkesës që ua bëra për të ma mundësuar takimin me të, ai doli dhe më ftoi që të hyja në zyrën e tij. Duke pirë kafe me të, e luta që të përpiqej për ta zbuluar vendin se ku do të më transferonin. Në bisedë e sipër me të, e mori në telefon një person nga i cili kërkoi që t'i tregonte mundësisht se ku do të më transferonin pas mbarimit të shkollimit. Mbetëm në pritje të kësaj përgjigjeje për disa minuta. Më kapluan emocionet. Nuk dija çka të flisja më me atë person, edhe pse u tregua mjaft korrekt ndaj meje. Përafërsisht, pas 10 minutash, cingëroi telefoni. Nuk dija se çka i tha, por në bazë të fjalës së tij, “mos more”, e kuptova se lajmi ishte i keq. Fjala ishte për ish -armatën e nëntë të Sllovenisë dhe për garnizonin e quajtur “Pivka”. Në fakt ishte një fshat paksa më i madh në Slloveni dhe se përflitej se është njësit i vështirë dhe sikur atje shkonin oficerët si të dënuar. Ai sikur filloi të më jepte kurajë se unë si oficer që isha duhej të shërbeja aty ku e kërkonte nevoja. U largova nga zyra e tij, duke i falënderuar për pritjen që më bëri dhe për informacionin që më dha. Nuk di se si kam dalë në bulevardin “Knjaz Milosh” dhe si kam shkuar me autobus në banesën time. Për

transferimin që do të pasonte, u shqetësua mjaft edhe bashkëshortja ime. Vajzat na shikonin me kureshtje, por nuk e dinin se çka kishte ndodhur. Bashkëshortja e kishte shtruar drekën, por na ishte fashitur oreksi për ngrënie. Ishte e kuptueshme se refuzimi im për të punuar në organet e sigurimit ushtarak kishte sjellë edhe “dënimin”. Dhe, në këtë rast nuk kisha çka të bëja mirëpo edhe qëndrimi duarkryq ishte varianti më i keq i mundshëm. E shikoja vajzën time, e cila, siç thash, duhej të shkonte në shkollë, por si të shkonte e t’i vijonte mësimet kur nuk e dinte gjuhën sllovene. Mendoja se si ta gjeja një zgjidhje, përkatësisht se si do ta gjeja ndonjë epror i cili do të më ndihmonte në zgjidhjen e këtij problemi. Më ra ndërmend për Kolonel (e më vonë Gjeneral Major) Et’hem Reçicën, tanimë i ndjerë, i cili ishte zëvendëskomandant i komandës së njësiteve të Kosovës (Qarku Ushtarak). Ashtu i lodhur, vendosa të udhëtoja për në Prishtinë, bashkë me bashkëshorten dhe fëmijët. Pasi i morëm me vete disa gjësende, me “fiqën” time të vogël, diku rreth orës 17:00, u nisëm për Prishtinë magjistrales së Ibrit, nëpër Kralëvë – Rashkë – Mitrovicë - Prishtinë. Me të arritur në afërsi të Rashkës, papritmas e ndjeva një lodhje gjatë vozitjes, sepse nuk kisha pushuar aspak. Ishte natë dhe në një moment më doli përpara vetura (atëherë e milicisë) dhe më ndalën. Pas legjitimitimit, kur u bindën se isha epror ushtarak, më preferuan që të akomodohesha në një motel në afërsi të Rashkës, sepse e kishin vërejtur se unë bëja “tetëshe”. Iu falënderova dhe vazhdova rrugën. Bashkëshortja ime, sikur e kishte një frikë për të fjetur në motel në Rashkë. Nuk i pëlqeu propozimi. Për rreth 30 minuta u ndalëm pranë një pompe të benzinës. Sikur i mbylla sytë pak dhe, paksa i këndellur, vazhdova rrugën për në Prishtinë.

Para banesës së tij e prisja kolonel Reçicën. Diku rreth orës 07:00, kur më pa, i habitur më tha: “Ramë, çka ka ndodhur?”. Rrugës për në zyrën e tij (në ndërtesën e tanishme të Muzeut të Kosovës) shkuam së bashku, por pa ia shpjeguar detajet e ardhjes sime. Pasi që porositi kafe i kërkova që të gjene dikë të më ndihmonte që të mos shkoja në detyrë në Sloveni, për shkaqet që unë ia shpjegova. Por, për çudi, ai filloi të më bindte se unë isha oficer i armatës dhe duhej të shërbeja kudo që shtrohej nevoja. U zhgënjeva, sepse nuk bëri as përpjekjen më të vogël për të më ndihmuar. E kuptova se ai hezitonte të më ndihmonte, sepse do të kuptohej më vonë se intervenimi i tij mund të merrej si ndihmë ndaj kolegut të kombësisë së njëjtë dhe do të kishte konotacion negativ për të, pasi që ai më



parë ishte futur në listën për avancim në gradën e gjeneralmajorit. Ashtu i nevrikosur, vendosa ta akomodoja familjen time tek një shok i ngushtë. E lash veturën dhe hipa në autobus që shkonte për Nish. Gjatë tërë rrugës më merrte gjumi. Me të arritur në Nish, kalova në autobusin tjetër që shkonte për Zajeçar. Atje e kërkoja komandantin e garnizonit, një kolonel me kombësi malaziase, i cili një kohë kishte qenë shefi im dhe më kishte respektuar shumë si epror. Të nesërmen kontaktova me të. Ishte i befashuar pse e kërkoja me urgjencë, aq më tepër, pa paralajmërim. Më dëgjoi me vëmendje, sepse që në fillim e kishte kuptuar peshën e problemit, sidomos për shkak të shkollimit të vajzës sime në gjuhën amtare. Pa hezitim kontaktoi me komandantin e armatës së Nishit, gjeneralkolonel Bruno Gulletiq, me kombësi kroate. Sipas terminit të caktuar nga ai, të nesërmen në orën 07:30 duhej të lajmërohesh në kabinetin e tij. Ishte kjo situatë paksa e çuditshme, që drejtpërdrejt të shkoja si kapiten, tek komandanti i armatës. Ishte gati e paimagjinueshme atëbotë. Atë natë, nga meraku, nuk e bëra një sy gjumë. Të nesërmen, në orën shtatë, iu lajmërova shefit të kabinetit të komandantit të armatës. Paksa i habitur, ai më pranoi dhe më lejoi që të ulesha në një paradhomë. Pas pak erdhi në punë komandanti. Duke më parë ashtu në rroba civile, më pyeti se a isha unë ai personi që kishte caktuar takim komandanti i garnizonit të Zajeçarit. Më urdhëroi që të hyja brenda dhe të ulesha. Pasi që ia shpjegova shkurtimisht gjendjen time familjare, ai e ngriti telefonin, përkatësisht nëpërmjet interfonit e ftoi një gjeneral në drejtorinë e personelit të Sekretariatit Federativ të Mbrojtjes Popullore (SFMP). Në formë të lutjes i tha se kishte nevojë për një komandant të batalionit në Garnizonin e Gjakovës, e që ai duhet të jetë kapiten Qehaja. Pasi që biseda zhvillohej përmes interfonit, u dëgjua përgjigja pozitive nga ana tjetër: “Nuk do të ketë problem për të dhe kjo çështje do të zgjidhet ashtu siç kërkuat” m’u drejtua komandanti. Iu falënderova përzemërsisht komandantit të armatës së III-të të Nishit, duke u larguar nga zyra e tij. Gjatë udhëtimit me autobus nga Nishi për në Prishtinë, sikur nuk besoja se isha te komandanti i armatës dhe se do të rregullohej transferimi im në Kosovë, në Gjakovë. Nganjëherë më dukej sikur shihja ëndërr, ngase për të biseduar me komandantin e armatës kërkohej një procedurë e posaçme dhe duhej të pritej së paku 20 ditë.

Pas dy ditësh me familje u ktheva në Beograd. Më kishin mbetur edhe 20 ditë deri në mbarim të shkollimit.

**PJESA E PESTË**

**MBROJTJA E TEMËS SË DIPLOMËS  
DHE TRANSFERIMI**

Kisha filluar përgatitjet përfundimtare për mbrojtjen e temës së diplomës të cilën tanimë e kisha dorëzuar. Ajo ishte: “Brigada e këmbësorisë në marsh dhe kalim në sulm” dhe atë në rajonin e Kninit, në Kroaci. Temën e mbrojta shumë mirë dhe nga komisioni përkatës mora notën 8. Më kishin mbetur edhe pesë ditë deri kur do ta kuptoja përfundimisht se ku do të më transferonin. Edhe pse isha i sigurt se do të kthehesha në Kosovë, një dozë frike më mbante pezull, mos po ndodhë në ndërkohë diçka e papritur.

Më 27 qershor të vitit 1974 ishim mbledhur të gjithë në amfiteatër për të pritur shpërndarjen e diplomatëve dhe për të kuptuar se në cilin vend do të transferoheshim. Më kishin kapluan emocionet. E mora diplomën dhe sërish u ula në vendin e caktuar. Filloi kumtimi i urdhëresave. Shpejt e kuptova se më kishin caktuar për komandant të batalionit të II-të të brigadës së 15-të të këmbësorisë së Prishtinës, me seli në Gjakovë. Gëzimi ishte i pakufishëm, sepse po kthehesha në Kosovë.

Gjatë pushimit njëmuor i barta ca mobile në banesën time në Prishtinë. Më 1 shtator u lajmërova në komandën e brigadës në Prishtinë, me ç’rast më pranoi komandanti i saj, nënkolonel Gjurickovic. Më shpjegoi problemet dhe vështirësitë me të cilat do të përballesha si komandant i batalionit II. Më tha se do të isha njëkohësisht edhe komandant i garnizonit të Gjakovës. Batalioni ishte diku rreth tre muaj pa komandant. Kuptova se komandanti i deriatëhershëm ishte sëmurë rëndë. Batalioni i kishte rreth 500 ushtarë. Disiplina nuk ishte në nivelin e duhur. Kishte edhe probleme të karakterit kadrovik dhe logjistik.

Pasi që e transferova familjen në një banesë zyrtare në Gjakovë, fillova aktivitetin tim komandues dhe drejtues. Vajzën e madhe, Eminen e regjistrova në klasën e parë, kuptohet në gjuhën amtare, që ishte pikësynim kryesor. Banesën e kisha në katin e tretë të një ndërtese me banesa ushtarake. Stabilitetin tonë familjar e prishte sasia e pamjaftueshme e ujit. Për shkak të shtypjes së dobët të ujit, atë duhej ta merrnim nga bodrumi i banesës. Ky ishte problem i madh jo vetëm për mua, por për tërë Gjakovën atëbotë. Problemi i ujit do të zgjidhej më vonë me aktivizimin e sistemit të Radoniqit, e që unë nuk e prita

pasi që kjo ndodhi pas largimit tim nga Gjakova. Filluan aktivitetet e llojlojshme që kishin të bënin me ngritjen e gatishmërisë vepruese të batalionit (gjuajtje, ushtrime taktike, kryerje detyrash të ndryshme konkrete, si brenda njësisë ashtu edhe si komandant i garnizonit).

Vlen të theksohet se 7-8 ditë pas marrjes së detyrës së komandantit u detyrova që me një pjesë të këtij batalioni të marshoja drejt malit Rtanj, në veri të Sokobanjës (Serbi) për të gjuajtur caqet ajrore. Atëherë nuk i njihja njerëzit me të cilët do të punoja. Për më tepër duhet theksuar se përbërja e kuadrit, sidomos e stafit aktiv, nuk ishte e mirë. Një numër i caktuar oficerësh dhe nënoficerësh, nuk ishin mjaft të disiplinuar, nuk ishin sa duhet profesional dhe, mbi të gjitha, nuk kishin kompetencë të mjaftueshme për drejtimin e togjeve dhe çetave. Shih për këtë, më duhej ta shtoja aktivitetin tim lidhur me përmirësimin e disiplinës dhe kryerjen e detyrave të secilit veç e veç. Ky angazhim nxori në dritë edhe rezultatet e para.

## **Organizimi i ushtrimit demonstrues dhe afirmimi**

Pas 6 muajsh mora një urdhëresë që të organizoja një ushtrim me batalionin tim për tërë stafin e lartë komandues të armatës së atëhershme të Nishit. Iu qasa punës me një seriozitet të jashtëzakonshëm, gjë që këtë demonstrim e vlerësonte po ai komandant i armatës që më mundësoi që të shërbeja në Gjakovë në vend se të shkoja në Slloveni. Komandanti i Brigadës në Prishtinë, në fillim të përgatitjeve, qëndroi me mua 2-3 ditët e para dhe, kur u bind se unë me sukses mund t'i vazhdoja vetë përgatitjet, u largua nga Gjakova. Kohë pas kohe i mbanim me të vetëm lidhjet telefonike për raportime.

Pas dy javë përgatitjesh intensive në rajonin e fshatrave Gegjë e Marmullë mbi lumin Drin, pasi që u bind se ishin bërë përgatitjet e nevojshme, e caktoi terminin për demonstrimin konkret, përkatësisht për paraqitjen e një shembulli se si duhej të bëhej forcimi - kalimi i lumit me metoda dhe mjete konkrete që mund të gjendeshin në përdorim në terren. Në ditën dhe orën e caktuar, përkatësisht në mars të vitit 1975, arriti me helikopter stafi komandues i armatës së dytë të Nishit. Pasi që komandanti i brigadës nënkolonel Gjurickovic

i raportoi komandantit të armatës Gjeneralkolonelit Bruno Vuletic, për gatishmërinë për fillimin e ushtrimit, u dha leja për fillimin e demonstrimit. Gati çdo gjë shkoi sipas parashikimeve dhe përgatitjeve. Përveç ndërhyrjeve të mia për ca shpjegime, askush nuk fliste nga eprorët e lartë, të cilët vëzhgonin ushtrimin. Oficerët dhe ushtarët e batalionit, me një përbërje të larmishme nacionale por me shumë pak shqiptarë, aq shumë ishin të motivuar për këtë ushtrim sa që çdo gjë shkoi shkëlqyeshëm. Pas përfundimit të ushtrimit dhe tërheqjes së batalionit tim, filloi analiza. U dëgjuan shumë fjalë miradije, por edhe ndonjë vërejtje jo edhe aq esenciale. Komandanti i armatës, në fjalën përfundimtare, u shpreh pozitivisht dhe më lavdëroi para të gjithëve për suksesin e arritur. E porositi komandantin e brigadës që ta kishte parasysh suksesin tim për avancimin e mëvonshëm, i cili do të pasonte. Nga ky ushtrim, tërë stafi komandues i armatës arriti që të njihet me mua si epror shembullor. Tashmë, edhe pas shkollimit që kisha kryer, sikur m'u hap një perspektivë më e qartë për vitet në vijim.

Aktivitetin tim e vazhdova duke i kryer detyrat e mia të rëndomta. Isha fokusuar më tepër në mbajtjen e disiplinës në nivel të duhur, sepse po të më ndodhte diç e padëshirueshme si rezultat i mosdisiplinës, siç ishte plagosja apo vdekja e ndonjë ushtari, për mua do të kishte pasoja shumë të mëdha. Në trajnim i kishim zakonisht nga dy breza ushtarësh.

Në fillim të vitit 1975 pranuan një brez ushtarësh të rinj. Kërkoreshin angazhime të mëdha për integrimin e tyre në jetën ushtarake. Punët kryesisht ecnin mirë. Në aspektin familjar isha stabilizuar mjaft mirë, aq më parë që familjen e kisha pranë vetes. Vajza e madhe i vijonte mësimet në klasën e parë të shkollës fillore në Gjakovë. Bashkëshortja kujdesej për rritjen dhe edukimin e tri vajzave që kishim. Unë isha rëndom i angazhuar, përveç punëve në kazermë edhe në trajnime fushore, apo siç i quanin atëherë llogorime.

## **Përgatitja dhe zbatimi i një ushtrimi të madh taktik**

Në fillim të muajit shtator 1975 morëm urdhrin për organizimin dhe zbatimin e një ushtrimi shumë të madh të quajtur "Drenica 75". Në këtë ushtrim merrja pjesë me tërë batalionin (me përbërjen aktive dhe atë

rezervë). Në kompozicionin e ushtrimit ishin të parapara katër brigada të moto-mekanizuara nën mbikëqyrjen e armatës së Nishit dhe gjeneral shtabit të Armatës Popullore Jugosllave (APJ). Me batalionin tim kisha për detyrë sulmin dhe kalimin e mëvonshëm në mbrojtje. Derisa nuk erdhi koha e ushtrimit përfundimtar dyditor, nën mbikëqyrjen dhe vlerësimin nga instancat më të larta ushtarake, ne bëmë ushtrime të njëpasnjëshme dhe llogorime në drejtime të caktuara edhe atë nga rajoni i gjerë i Pejës e deri në Skenderaj.

Ditën e ushtrimit përfundimtar me batalionin tim unë gjendesha në rajonin e Gjurakovcit. Diku në mesditë, në afërsi të vendkomandimit tim, u lëshuan 2 helikopterë me oficerë të lartë nga Beogradi dhe Nishi. Komandanti i Brigadës dhe unë i pritëm duke u raportuar për gjendjen momentale në "Vijën e frontit". Gjatë shpjegimit që bëra, vërejta se ekipi vrojtues ishte i kënaqur. Një vlerësim pozitiv më dha edhe komandanti për të arriturat e deritanishme. Të nesërmen, në orët e pasdites, u krye ushtrimi i paraparë dyditor. Batalionin e ktheva në kazermë në Gjakovë. Këtë ushtrim e analizuam së bashku me oficerët dhe nënoficerët e batalionit. Suksesi, siç thashë, nuk mungoi. Ishte kjo një punë e rëndë dhe me përgjegjësi.

Përveç punës zyrtare në kazermë, isha i detyruar të kryeja edhe detyra të komandantit të garnizonit, jashtë saj. Eprorë të tjerë më të vjetër, sipas funksionit, përveç meje, nuk kishte. Së paku 2-3 herë në muaj më ftonin në mbledhje të Kuvendit Komunal apo atëherë të Komitetit për Mbrojtje Popullore dhe Vetëmbrojtje Shoqërore. Më ftonin edhe në manifestime të tjera.

Në tetor të vitit 1975, një shoqëri kulturo-artistike nga Shkodra e vizitoi qytetin e Gjakovës dhe shfaqti një program të shkëlqyer kulturor artistik para një numri të madh qytetarësh. Pas programit, për darkën e shtruar, isha i ftuar edhe unë. Përkundër përpjekjeve të mia për të biseduar me ndonjërin nga anëtarët e kësaj shoqërie, nuk ia dola. Të drejtë komunikimi me ta kishte vetëm shefi i grupit. Ky ishte realiteti i hidhur i Shqipërisë së atëhershme diktatoriale e që në mua la një gjurmë me ndjenja të përziera.

Në fund të çdo viti, përkatësisht më 22 dhjetor, ishte “ditëlindja” e APJ-së. Atë ditë, në të gjitha garnizonet, mbaheshin rivistat, rreshtimet, parakalimet për të arriturat e armatës. Ndaheshin dekoratat dhe lëvdatat. Një dekoratë m’u dha edhe mua. Unë e organizova një solemnitete rasti, me ç’rast u lexuan urdhëresat nga lart, por edhe ato që i kisha dhënë unë si komandant i batalionit dhe garnizonit. Kuptohet, në këtë manifestim merrnin pjesë edhe strukturat politike-komunale. Kështu u përmbyll edhe ky vit kalendarik.

**PJESA E GJASHTË**  
**TRANSFERIMI NË PRISHTINË**  
**DHE AVANCIMET E MËTEJME**



Në muajin shkurt të vitit 1976, gojarisht m'u kumtua se do të transferohesha në garnizonin e Prishtinës. Gëzimi im ishte i pakufishëm, sepse kthimi i sërishëm në Prishtinë, ku e kisha filluar karrierën ushtarake, ishte më shumë se fat. Pas dy muajsh, përkatësisht në fillim të muajit maj 1976, mora urdhrin për emërimin tim komandant i batalionit të parë të brigadës, siç e quanin atëherë të 15-të në garnizonin e Prishtinës. U detyrova ta gjeja një banesë me qira, për ta vendosur familjen time, sepse mbetja e saj e mëtejme në Gjakovë nuk ishte solucion i mençur. Vajza ime e vazhdoi shkollën në klasën e dytë në rajonin e Tauk Bahçes, ku banoja me qira, tani shkolla fillore "Gjergj Fishta".

Batalioni ishte shumë i komplikuar dhe me detyra specifike. Përveç të tjerash, ai shkollonte eprorë, dhjetarë, të cilët do të kryenin detyrat e komandantit të skuadrës, përkatësisht të stërvitjeve themelore të ushtarëve për detyra të shkathtësive luftarake. Pata shumë probleme me këtë batalion. Aq më parë që kërkesat ndaj tij ishin shumë të mëdha. Por, pas avancimit tim në gradën e kapitenit të klasit të parë, pas shtatë muajsh detyre si komandant, më emëruan në detyrën e shefit të operativës të brigadës në Prishtinë. Pasi që kjo brigadë ishte njësit elitare në Kosovë dhe me detyra të llojllojshme, nuk e pata edhe lehtë, sidomos në 2-3 muajt e parë. Mirëpo, detyrat e mia të mëhershme, siç quheshin detyrat komanduese në trupë (me ushtarë) më mundësuan që gjatë kryerjes së kësaj detyre të tregoja afinitet të posaçëm në planifikime taktike. Në fakt, çdo gjë që ndodhte në brigadë, kalonte nëpër "duart e mia". Komandanti i brigadës në vazhdimësi më përkrahte dhe kishte fituar besim në mua. Kuptohet, për mua nuk kishte orar të punës. Punoja mesatarisht 10 orë në ditë. Ishte kjo punë shumë e rëndë dhe me përgjegjësi të madhe. Nuk kisha kohë për ndonjë vëmendje të posaçme për familjen time. Me ngulm kërkova që të më jepej banesa zyrtare (sepse banoja në një shtëpi private). Si shpërblim për punën time të palodhshme dhe të suksesshme, tre muaj pas ardhjes sime në Prishtinë, në mënyrë të jashtëzakonshme, e mora edhe banesën. Banesa ishte në qendër të qytetit, kishte nxeheje qendrore dhe ishte shumë komfore. Në të banuam 11 vjet me radhë. Në këtë kohë, vajza ime e madhe e ndërroi shkollën dhe së bashku me motrën e saj të dytë i vazhdoi mësimet në shkollën fillore "Vlladimir Nazor" (tash "Naim Frashëri").

Në të njëjtën shkollë i vijuan mësimet edhe dy vajzat e tjera të miat. Jeta e qetë familjare dhe shkollimi i fëmijëve në gjuhën amtare më jepnin kurajë për t'i kryer më lehtë edhe punët zyrtare. Poashtu, në vitin 1978 lindi vajza ime e katërt, Fatbardha. Në rrafshin profesional, tanimë puna dhe aktiviteti im ishte bërë rutinë. I dija përmendësh të gjitha aktivitetet që duhej të zhvilloheshin në brigadë. Aq më parë, kur punët dhe detyrat që duhej të kryheshin i planifikoja kryesisht vetë. Në fund të vitit 1978, para kohe (për një vit) u avancova në gradën e majorit. Menjëherë pas këtij avancimi, më emëruan shef të shtabit dhe njëherit zëvendëskomandant të brigadës.

U ndërruan komandantët e brigadës. Komandanti i ri nuk më njihte, por për aktivitetin tim kishte marrë mjaft informacione. Sipas rregullit, 6 muajt e parë, ai nuk ishte në gjendje të ndërmernte asnjë hap apo vendim pa u konsultuar me mua, si njohës i shkëlqyeshëm i rrjedhave në brigadë, që në atë kohë, me pjesën rezervë të saj, kishte rreth 6000 trupa. Pasuan shumë aktivitete të karakterit taktik e taktik-operativ me këtë brigadë e cila që nga viti 1980 do të hyjë në përbërje të korpusit të 52 të moto-mekanizuar, e jo si në vitet e mëparshme kur ishte nën komandën e njëfarë Grupe operative për Kosovë. Kjo ndodhi si rezultat i disa vlerësimeve se në Kosovë duhej një korpus i moto-mekanizuar me prioritet në armatën e dytë, si në pikëpamje të pajisjes, armatimit, trajnimit etj.

Ishte ky viti 1979 kur shqiptarët ishin në vllugun më të madh të shkollimit, kryesisht në gjuhën amtare. Krahas kësaj pune kryeja edhe punë plotësuese si ligjërues MPP dhe VMSH I dhe II në disa fakultete të UP. Isha prezent në media, në Radio Televizionin e Prishtinës dhe "Rilindje". Një herë në javë mbaja emision në Radio Prishtinë për sferën e mbrojtjes, me tema të larmishme që vetë i zgjidhja dhe atë vetëm në gjuhën shqipe. Pasuan edhe disa detyra të tjera të radhës që kishin të bënin me ushtrime taktike të nivelit të batalionit, gjuajtje të caqeve ajrore në poligonin Krivollak në Maqedoni e kështu me radhë.

Viti 1980 filloi, si zakonisht, me fillimin e zbatimit të planifikimeve të reja. Detyra më e vështirë ishte analiza e bilancit financiar për vitin paraprak. Ishte rregull që të arsyetohej çdo para e shpenzuar. Edhe pse kjo ishte përgjegjësi e komandantit të brigadës, ai më autorizoi mua

që me pjesën e ngushtë të shtabit ta bëjë këtë analizë. U kryen edhe shumë detyra të tjera të rëndomta dhe rutinore.

Në planin familjar, gjërat nuk qëndronin edhe keq. Fëmijët kishin sukses të shkëlqyeshëm në shkollën filllore. Më e ngarkuara lidhur me arsimimin dhe edukim e fëmijëve, si dhe me punët e shtëpisë, ishte bashkëshortja ime, Naza. Përveç punëve që i kryeja zyrtarisht me përpikëri, unë dhe bashkëshortja ime merreshim edhe me problemet e vëllezërve, motrave dhe prindërve. Babai im vazhdimisht kërkonte që t'i ndihmoja pothuajse për të gjitha punët familjare, në shkollimin dhe punësimin e vëllezërve e motrave të mia e kështu me radhë. Si duket, ai nuk e kuptonte pozicionin tim të vështirë dhe stërngarkesën time me punë familjare dhe zyrtare. Kur nevrikosej, shpeshherë pa arsye, unë e qetësoja duke ia shpjeguar gjërat pak më gjerësisht dhe kështu e gjenim gjuhën e mirëkuptimit për zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Në planin zyrtar, rezultatet ishin të mira.

## **Shkollimi në Shkollën e Mbrojtjes Nacionale (SHMN)**

Kisha planifikuar që të shkoja në pushim vjetor më 20 korrik 1980. Pak para se të nisesh për rrugë, papritmas më ftuan në komandën e korpusit të Prishtinës dhe më kumtuan se kishin marrë vendim që prej 1 shtatorit 1980, unë duhej t'i ndiqja mësimet në Shkollën e Mbrojtjes Nacionale në Beograd. Për mua kjo ishte befasi e llojit të vet. Kjo më befaso, sepse në këtë shkollë mund të shkonin vetëm kandidatët që ishin të paraparë për avancim të mëvonshëm në gradën e gjeneralit. Ky ishte, përveç të tjerash, kushti kryesor për avancim në këtë gradë. Gjatë bisedës që pata me komandantin e korpusit, m'u kumtua edhe lajmi se pas kryerjes së kësaj shkolle, fillimisht do të më caktonin për komandant të Brigadës së Pirotit, e cila për atë kohë ishte një ndër brigadat më të plotësuara dhe të avancuara, për shkak të pozicionit që, sipas doktrinës së atëhershme, kishte mbylljen e drejtimit të quajtur të "Nishavës" e që shpinte në rrafshnaltën e Kosovës.

Pushimin e kalova pjesërisht në Ulqin dhe në Kamenovë. Mendja gjithnjë më rrinte tek shkollimi që do të pasonte. Mendoja lidhur me atë se a do të mund t'i përballoja nivelit aq të lartë të studimeve, çfarë

do të ishte përbërja kadrovike e atyre që do të vinin aty. Në gusht të atij viti, arriti edhe urdhëresa nga Sekretariati Federativ i Mbrojtjes Popullore për shkollim. Me nguti i fillova përgatitjet për dorëzimin e detyrës së kryeshefit të shtabit të brigadës së 15 të moto-mekanizuar. Jo vetëm kaq. Ishte problem edhe çështja e familjes sime, sepse domosdo duhej të jetoja ndaras nga ajo për shkak të shkollimit të fëmijëve në gjuhën shqipe në Prishtinë. Gjatë muajit gusht arrita t'i kryeja edhe disa aktivitete të tjera të domosdoshme, si në planin familjar, ashtu dhe të përgatitjeve për transferimin tim.

Më 1 shtator 1980 filloi viti i ri shkollor. Tashmë isha në mesin e rangut më të lartë të shkollimit në ish-Forcat e Armatosura të Jugosllavisë. Shkolla ishte në Banjicë, në një paralagje të Beogradit, ku ishin të vendosura dy akademitë, ajo e cila shkollonte oficerë fillestarë dhe akademia komanduese- shtabore, të cilat unë i kisha kryer në vitin 1966, respektivisht më 1974. Ishte një numër i madh kadetësh, oficerësh, ligjëruesish, profesorësh, staf civil etj. Kushtet e shkollimit për atë kohë ishin të shkëlqyeshme. U vendosëm në apartamente enkas të përgatitura për këtë nivel të shkollimit. Përveç në dy apartamente, në të tjerat akomodimi u bë veç e veç. Ishin gjithsej 25 veta. Fillimisht dëgjonim ligjërata nga më të ndryshmet. Pas tre muajsh, filluam të trajtonim tema praktike, duke filluar nga niveli i brigadës e deri te niveli i korpusit e armatës. Edhe pse në fillim kisha paksa emocione, pas një muaji qëndrimi aty u binda se, edhe pse kishte disa oficerë më të vjetër se unë dhe kishin përvojë më të gjatë se unë, megjithatë nuk isha nën nivelin e dijes së tyre. Kjo aq më tepër kur e kisha parasysh faktin se gjatë kohës derisa isha shef i shtabit të brigadës së moto-mekanizuar, kisha kryer detyra të rëndësishme e të mjaftueshme që më ndihmonin që të isha pjesëmarrës i barabartë me ata në trajtimin e shumë çështjeve doktrinare e strategjike.

Shumë shpejt, edhe ligjëruesit e strategjisë dhe operativës e vërejtën se unë isha njohës i mirë, jo vetëm i taktikës së përbërjeve të vogla të formacioneve, por edhe i gjeo-strategjisë. Për shkak të qëndrimit tim larg nga familja, isha i detyruar të udhëtoja shpesh në relacionin Beograd-Prishtinë. Udhëtimi më sillte vështirësi në pozicionin tim, sidomos në kryerjen e detyrave, që i dedikoheshin marrjes së vendimeve të ndryshme. Sidoqoftë, studimet në këtë nivel shkollor më shkollonin mirë.

Vitin e ri 1981 e prita në Prishtinë me familjen time. Paksa brengosës se ku do të më caktonin në detyrë pas përfundimit të shkollimit, aq më parë kur mendoja se isha shqiptar dhe në moshë relativisht të re. Kur pata biseduar me komandantin e atëhershëm të korpusit, sikur ma pati përmendur se pas përfundimit të kësaj shkolle, do të më emëronin komandant të brigadës së moto-mekanizuar në Pirot. Kjo do të më sillte probleme, në radhë të parë për shkak të shkollimit të fëmijëve, që duhej t'i vijonin mësimet në gjuhën amtare, e që në Pirot (Serbi), një gjë e këtille ishte e pamundshme. Kisha vendosur që fëmijët të mos i largoja nga shkolla shqipe.

Pas pushimeve festive iu qasa vijimit të ligjëratave dhe punës intensive në përmbushjen e detyrave që dilnin nga supozimet e ndryshme taktike-operative e që kërkonin punë dhe vendime kryesisht vetjake.

Në muajin shkurt 1981, sikur të gjithë të tjerëve, edhe mua m'u përcaktua tema e diplomës me të cilën do të mund t'i tregoja aftësitë e mia për detyra më të larta ushtarake. Ishte kjo tema: "Korpusi i 52-të i moto-mekanizuar i Prishtinës, në mbrojtje kundër desanteve ajrore të rrafshnaltës së Kosovës". Në shikim të parë, paksa u stresova, deri sa nuk e studiova temën dhe kërkesat që ishin të parashtruara. U binda se për të tjerët kjo do të ishte temë e vështirë, por jo për mua, pasi që isha përpilues i planeve ushtarake që kishin të bënin me Kosovën derisa isha shef i operativës e së voni edhe kryeshef i Brigadës së 15-të të Prishtinës. Iu qasa temës me një siguri shumë të madhe. Krahas kësaj detyre, pasuan edhe angazhimet e tjera, e që i dedikoheshin punimeve të ndryshme seminarike, vëzhgimeve konkrete në terren, etj.

## **Shpërthimi i demonstratave të marsit '81 dhe pozicioni im**

Në orët e pasdites, më 11 mars, për eprorët e lartë në shkollim në Shkollën e Mbrojtjes Nacionale u dha një informatë lidhur me shpërthimin e demonstratave të studentëve në qytetin e Prishtinës. Informata kishte të bëjë më tepër me zhvillimet e ngjarjeve të asaj dite dhe me masat e ndërmarra për ndërprerjen e atyre demonstratave të cilësuara si tejet armiqësore. U shpërndamë pa ndonjë përfundim dhe

secili nga ne u akomodua në apartamentet zyrtare ku banonim. Përveç meje, në apartament ishte i vendosur edhe një nënkolonel i përkatësisë boshnjake, i quajtur Smajloviq Kasim, i martuar më një sllovene, i cili para se të vinte në shkollë kishte ushtruar detyrën e komandantit të Brigadës në Kranj të Sllovenisë. Atë natë nuk e komentua situatën e krijuar në Kosovë, aq më parë kur unë e anashkaloja këtë temë edhe nga fakti se nuk e njihja mirë atë person, përkundër asaj që ai ishte shok i mirë dhe me të i ndanim çastet e pushimit bashkërisht.

Të nesërmen, më 12 mars, e trajtuan një temë seminarike. Në ndërkohë, u mor vesh se demonstratat e studentëve kishin vazhduar. Situata politike dhe e sigurisë në vend u përkeqësua. Me mua askush nuk bisedoi asgjë për këtë. Kuptohet se isha i kujdesshëm dhe kryesisht rrija në shoqëri me të tjerët, duke mos u larguar nga ndërtesa ku i ndiqnim studimet. Komentet nga të pranishmit ishin të ndryshme dhe kryesisht demonstratat cilësoheshin si kundërrevolucionare, aq më parë kur këto këshilli ushtarak jugosllav i kishte karakterizuar si kundërrevolucionare. Edhe pse nuk kisha qasje në informata, nga disa oficerë që i merrnin informatat nga komandat ku kishin punuar më parë, kuptova se një pjesë e konsiderueshme të njësiteve, siç i quanin elite të APJ-së, ishin në gatishmëri vepruese. Ndërsa korpusi i 52 -të i Prishtinës çdo ditë plotësohej me njerëz dhe armatim modern, të lehtë dhe të rëndë. Pasi që për dy javë rresht nuk pata mundësi ta vizitoja familjen dhe se kisha mungesë të theksuar të informacionit, fillova ta analizoja mundësinë e udhëtimit për Prishtinë. Me mua ishte në shkollim edhe nënkolonel Stojanoviq, i quajtur "Bërka", i cili paraprakisht kishte komanduar regjimentin e aviacionit në Prishtinë dhe, si fqinj që e kisha, kisha pasur kontakte me të, por jo të shpeshta. Më kujtohet se ka qenë i martuar me një kroate. Pas një bisede telefonike që kishte zhvilluar ai me bashkëshorten e vet, vendosëm papritmas që, më 3 prill 1981, me veturën e tij të tipit FIAT PZ të udhëtonim për Prishtinë. Në orët e pasdites, me të arritur në fshatin Rudare (Kurshumli), na ra në sy se, përveç veturës sonë, në drejtim të Kosovës dhe nga Kosova, nuk kishte lëvizje të tjera automjetesh. Kjo na shtoi dyshimin se diçka ishte duke ndodhur.

Me të arritur në territorin e Kosovës, përkatësisht para se të kalonim mbi kalimin e parë në Podujevë, papritmas na ndali një person dhe

na pyeti se ku donim të shkonim. Na sugjeroi që të mos hynim në Podujevë, sepse atje ishte një situatë shumë e tendosur, me thyerje e djegie të veturash, me njerëz të plagosur, etj. Kur ai e vërejti se kolegu im (voztësi) ishte serb, ishte edhe më kategorik që të mos hynim në Podujevë, por të ktheheshim në Nish. E dëgjova propozimin e tij dhe u kthyem për Nish. Pasi që kolegu im ishte shqetësuar tej mase, ia mora çelësat e veturës dhe vazhdova ta ngisja veturën e tij. Me të arritur në Prokuplje, hymë në postë për t'i informuar me telefon familjet tona se ishim kthyer prapa. Në ndërtesën e postës kishte shumë njerëz, që pritnin në radhë për të folur me familjarët e tyre në Kosovë, për shkak të situatës së krijuar. Pasi që më erdhi radha që të bisedoja me bashkëshorten time, disa nga qytetarët serbë që e kishin përcjellë bisedën time në gjuhën shqipe, m'u vërsulën dhe më ofenduan rëndë, në baza nacionale, duke më thënë: "Siptaru jedan"... "çka po bëni atje poshtë, ju shqiptarët" dhe fjalë të tjera banale si këto e të ngjashme. Me atë rast ndërhyri kolegu im, Stojanoviqi, i cili u prezantua si oficer (pasi që ishim në rroba civile), duke qetësuar masën. Serbët e mllefosur u tërhoqën dhe më lejuan me vështirësi që së bashku me kolegun të dilja nga holli i postës.

Me të arritur në Nish, sipas propozimit të kolegut tim, Stojanoviqit, hymë në Komandën e Korpusit të Aviacionit. Së pari hymë në sallën operative. Kolegun tim e njihnin të gjithë, ndërsa mua jo. Në atë sallë i pashë lëvizjet e forcave ajrore të ish-APJ-së dhe të njësiteve të ish-Armatës III-të të Nishit. I shikova me habi ato lëvizje të njësiteve të ndryshme. Në fakt, armata e Nishit ishte në gatishmëri të plotë ushtarake. Ndërsa bisedat e ndryshme që i dëgjuaam përmes telefonatave (interfonave) ndërmjet komandantëve kishin të bënin me furnizimin e korpusit të 52-të të Prishtinës.<sup>4</sup> Isha shumë i habitur sepse nuk e dija se çka do të ndodhte. Rashë për të fjetur në shtëpinë e APJ-së në Nish, por tërë natën nuk i mbylla sytë fare nga merakun për gjendjen e krijuar. Në restorantin e kësaj shtëpie kishte shumë njerëz të dehur dhe dëgjoja shumë fjalë fyese për popullin tim.

---

4 Në fakt, edhe pas ngjarjeve të mëvonshme, demonstratat e studentëve në Kosovë e kishin tronditur thellë jo vetëm kreun ushtarak, por edhe udhëheqjen e atëhershme serbe, që ra në konflikt me republikat e tjera.

Të nesërmen, më 4 prill, përsëri u nisëm për në Prishtinë, ku në qytet pamë shumë vetura të djegura në rrugë, shumë shitore të thyera, shumë lëvizje njerëzish, sidomos në këmbë. Ishte tmerr i vërtetë. Edhe sot nuk e kam të qartë se si arritëm te familjet tona pa ndonjë lëndim. Gruaja dhe fëmijët e mi ishin tejet të frikësuar. Atë ditë mbeta në Prishtinë. Të nesërmen, në orët e hershme të mëngjesit, më 5 prill 1981, me veturën time e transferova familjen time nga Prishtina në Kamenicë, tek miqtë e mi. Gjatë rrugës për në Kamenicë, më ndali policia në katër - pesë vende dhe pas legjitimeve të shumta, arrita në Kamenicë. Pas akomodimit të familjes, vazhdova rrugën drejt Bujanovcit për në Beograd.

## Shpëtimi nga burgosja

Diku rreth orës 22:00 të kësaj dite, ashtu i lodhur, arrita në apartamentin tim në ndërtesën e shkollës ku isha në studime të karrierës ushtarake në Banjicë të Beogradit. Kolegu im, me të cilin banonim në të njëjtin apartament, ishte me pizhame. Mjaft i shqetësuar, më tha: “Po të kërkojnë organet e sigurimit”. Ata kishin vlerësuar se unë kisha shkuar në Prishtinë për të organizuar dhe udhëhequr me demonstratat. Më kaploi një shqetësim. Edhe atë natë nuk bëra gjumë. Të nesërmen, më 6 prill, ende pa u pastruar, erdhi një nënoficer, në rolin e korrierit, i cili më tha se duhej të lajmërohesh tek komandanti i shkollës, gjeneralkolonel Stevo Iliqi. Ishte ky një bartës i dekoratës së vitit 1941, të cilin e vlerësoja si njeri mjaft të arsyeshëm.

Me të arritur në kabinetin tij dhe pas prezantimit që bëra (edhe pse ai më njihte mirë) më dha urdhër që të ulesha. Me të ishte shefi i sigurimit, një kolonel-ligjërues dhe shefi i grupit tonë. Pasi u përshëndetëm, ai kërkoi nga unë që të shpjegoja se ku isha këto tri ditë, sa isha jashtë Beogradit. Përgjigjja ime lidhur me këtë pyetje zgjati rreth 20 minuta. Të gjithë më dëgjonin me vëmendje. Qëndrimi im ishte kategorik, nuk kisha shkuar në Prishtinë për të organizuar demonstratat, siç i kishin marrë informatat nga dikush. E kishin ftuar edhe kolegun tim, Stojanoviqin që të dëshmonte lidhur me këtë. Mbase, ai sikur i dha vulën përfundimtare fjalëve të mia të mëparshme. Ai ishte bindës, sepse gjatë tërë kësaj kohe për të cilën bëhej fjalë, ai kishte qenë me



mua, kudo dhe kurdo. E vërteta ishte se kishim shkuar në Prishtinë për t'i vizituar familjet tona. Ai ua hoqi dilemat lidhur me udhëtimin tim për në Prishtinë. Në fund të kësaj bisede, gjenerali Iliq më tha: “Të faleminderit për këto shpjegime. Nëse edhe pas kësaj bisede të fton ndokush për bisedë informative apo diçka të ngjashme, më lajmëro mua”. E falënderova për mirëkuptimin dhe shkova në një sallë mësimi, për të ndjekur ligjëratat. Tanimë nuk isha i koncentruar si në ligjëratat, e mëhershme. Mendime të nduarnduarta më silleshin në kokë, por ishte më se e sigurt: po të mos kisha udhëtuar së bashku me kolegun tim, i cili gjatë dëshmisë e tha të vërtetën, isha i sigurt se do të ma montonin një “vepër” siç i quanin atëherë separatiste dhe do të më dënonin me disa vjet burg, ashtu siç u dënuan qindra shqiptarë.

Ndërkohë situata u relaksua dhe iu kthyem punës së rëndom në Shkollën e Mbrojtjes Nacionale. Pas 7 ditësh, sipas një plani, me tre helikopterë filluam vëzhgimin e drejtimeve më të rëndësishme operative-strategjike nëpër Jugosllavi, duke filluar që nga Sllovenia. Në Kosovë i patëm dy pikë vëzhgimi. Njëra ishte në objektin Golesh dhe tjetra në fshatin Zhur, në afërsi të Prizrenit. Në Golesh unë raportova, përkatësisht fola për rëndësinë e mbrojtjes kundërdesante eventuale ajrore. Pati edhe pyetje të ndryshme të karakterit ushtarak, por me sukses iu përgjigja të gjitha pyetjeve.

Në pikën e vëzhgimit Zhur ishte i caktuar një kolonel për të shpjeguar kapacitetin e drejtimit Kukës-Tiranë, i cili, përveç të tjerash, sikur me cinizëm foli për mbrojtjen që mund ta bënte Shqipëria në rast të një sulmi të forcave të APJ-së. Ai përmendi tanket kineze edhe ashtu të papërdorshme për shkak të prishjeve, avionët joefektivë etj., të Armatës Shqiptare dhe se gatishmërinë e saj të dobët. Kjo për arsye se pas demonstratave të vitit 1981, në kokat e disa eprorëve më të lartë, ekzistonte opsioni për një sulm ndaj Shqipërisë dhe atë me desant ajror. Mirëpo, me këtë rast, pasi që nuk ishte temë për diskutim kjo çështje, iu dha vërejtja nga gjenerali Stevo Ilic se përkundrazi sistemi i zjarrit i organizuar nga Forcat Shqiptare në këtë drejtim është shumë mirë i organizuar. Sidoqoftë, pas mbarimit të këtij vëzhgimi, u kthyem në Beograd. Vazhdoja me aktivitetin tim të përgatitjes së temës së diplomës. Herë-herë tuboheshim për ndonjë ligjëratë apo

informatë të caktuar për situatën skajshmërisht të përshkallëzuar pas demonstratave.

Kuadri shqiptar në ish-APJ iu nënshtrua një mbikëqyrjeje dhe trysnie të paparë. Ndodhën edhe disa burgosje për, siç thoshin, “Punë armiqësore dhe separatiste (irredentiste)” të një numri të eprorëve ose kadetëve, gjë që nuk kishte asnjë fakt juridik. Situatë e pavolitshme u krijua edhe për ushtarët shqiptarë, sepse trysnitë, fyerjet po edhe montimet e ngjarjeve të ndryshme ndaj tyre sa vinin e shtoheshin. Këtë përshkallëzim të situatës e kuptonim nga informacionet sekrete që na jepeshin, por pa të drejtë diskutimi apo vërejtjeje për to, si dhe nga mediet e shkruara që i lexonim ndërkohë.

Në Beograd ekzistonte Gjimnazi Ushtarak. Në të ishin të regjistruar dhe i ndiqnin mësimet rreth 30 të rinj shqiptarë. Pas ngjarjeve të 11 marsit, për shkak të krijimit të një shtate politike jo të volitshme, shumica nga ta kishin paralajmëruar largimin nga ky gjimnaz. Lidhur me këtë, dikush më kishte propozuar që unë t’i vizitoj ata dhe t’ju flas për nevojën e mbetjes së mëtejme të tyre në shkollim. Në shoqëri me drejtorin e Gjimnazit Ushtarak, e mbajta një ligjëratë dhe ata sikur u relaksuan paksa. Ishte ky një kontribut i imi që m’u dha rasti ta bëja me qëllim që të rinjtë tanë edhe më tej të mbeten në shkollim ushtarak.

Në muajin qershor e përfundova temën e diplomës. Preokupimi im kryesor ishte se ku do të më sistemonin pas mbarimit të kësaj shkolle. Frika më e madhe ishte sikur të realizohej paralajmërimi i ish-komandantit të korpusit, para përcjelljes sime në këtë shkollim të lartë, se pas mbarimit të saj, do të sistemohesha në detyrë të komandantit të brigadës në Piroto. Të shkoja në një detyrë të këtitllë, në kohën kur kishte rënë në fund të pusit besimi në eprorët e atëhershëm shqiptarë dhe, nga ana tjetër, duke marrë parasysh se ky vend ishte tërësisht me popullatë serbe, sipas bindjes sime ishte një detyrë shumë e vështirë. Nuk mund t’i qasesha drejtorisë së personelit të ish- Sekretariatit Federativ të Mbrojtjes Popullore, për të “zbuluar” fshehtësinë se ku do të sistemohesha. Në ndërkohë, para një komisioni të caktuar enkas për vlerësimin e punimeve të diplomës, anëtar i të cilit ishte, ndër të tjerët, edhe gjenerali me mbiemrin Uzellac, fillova t’i jepja sqarimet e nevojshme, përkatësisht ta mbroja me gojë atë çka e kisha shkruar.

Vlerësimi im ishte se nuk duhej ta merrja notën më të vogël se 9. Kryetari i komisionit e kishte vlerësuar lart punim tim të diplomës. Pas 2 orë shpjegimesh, arsyetimesh, dokumentimesh etj, më komunikuan notën 8. Në pyetjen e tij se sa isha i kënaqur me notën, unë shpreha pakënaqësinë time, sepse nuk ishte vlerësimi real. Kuptohet, kjo që thashë unë, nuk u mor për bazë. Sidoqoftë, isha i kënaqur që e kreuva një detyrë të rëndësishme.

**PJESA E SHTATË**  
**EMËRIMI NË MBROJTJEN**  
**TERRITORIALE**

Më 27 qershor 1981, në një sallë të rregulluar enkas për promovim, u lexuan urdhëresat e Sekretariatit Federativ të Mbrojtjes Popullore për transferime zyrtare në detyra komanduese. Për çudi, urdhëresa e dedikuar për mua doli të jetë sistemim në mbrojtje territoriale, pra më kishin caktuar në detyrën e komandantit të mbrojtjes territoriale të komunës së Prishtinës. Sa ishte habi e madhe për mua, aq ishte edhe një lloj nënçmimi, por megjithatë kishte edhe përparësi se po kthehesha në Prishtinë, tek familja ime nga e cila kisha jetuar i ndarë për një vit të plotë.

Kuptohet, pas demonstratave të marsit-prillit 1981, besimi në kuadrot shqiptare kishte rënë gati në pikën zero. Mbase edhe kjo ishte njëra nga arsyet që nuk më kishin caktuar për komandant të një brigade elite të APJ-së, siç ishte ajo e Pirotit e që mbyllte një drejtim shumë të rëndësishëm, sipas doktrinës së atëhershme, atë Nishavo-Kosovar, por më kishin caktuar në strukturë rezervë të forcave të armatosura, siç ishte Mbrojtja Territoriale (MT).

Pas një pushimi dyjavor, në një situatë shumë të tendosur politikisht, fillova punën në ndërtesën e komunës së Prishtinës, ku edhe ishte i vendosur shtabi i MT të Prishtinës. Njësitet e MT të komunës së Prishtinës për nga përbërja nacionale nuk ishin në harmoni me strukturën nacionale të popullatës. Gradualisht fillova të bëja ndryshime dhe përmirësime të strukturës nacionale. Një person zyrtar të personelit të nacionalitetit serb që e gjeta aty, e urdhërova që të mos bënte asnjë ndryshim në kartotekë, pa dijen time. Atë e mbikëqyrja vazhdimisht. Në ndërkohë, në këtë sektor të personelit, i caktova edhe dy persona të tjerë të nacionalitetit shqiptar dhe doja të sigurohesha se gjërat do të shkonin më mirë se më parë, jo vetëm në aspektin nacional por edhe në atë profesional shkollor etj.

Më 15 dhjetor 1981, në Shtabin Krahinor të Mbrojtjes Territoriale u organizua një këshillim, siç e quanin atëherë, mësimor në nivel krahinor, përkatësisht me gati tërë stafin e atëhershëm të Shtabeve Komunale të Mbrojtjes Territoriale. Në të merrnin pjesë edhe përfaqësuesit e MT-ve të Republikave të atëhershme të Federatës dhe Krahinës Autonome të Vojvodinës.

Këshillimi u organizua në sallën e kinemasë të Shtëpisë së Kulturës së APJ-së në Prishtinë. Për atë rast unë përgatita një diskutim mjaft kritik për ecurinë e zhvillimeve në MT të Prishtinës, duke i theksuar të arriturat për ata shtatë muaj prej kur unë isha vënë në krye të këtij shtabi. Diskutimin e përgatita në shqip dhe serbisht. Çuditërisht komandanti i atëhershëm i MT të Krahinës Autonome të Kosovës, gjeneralmajor Quranolli, tubimin e hapi në gjuhën serbe duke mos e përdorur asnjë fjalë shqip, edhe pse një gjë të tillë ia mundësonte kushtetuta e atëhershme dhe Ligji për Mbrojtjen Territoriale të Kosovës. Nuk ishte siguruar përkthimi simultant, edhe pse për këtë kishte mundësi. Pasi erdhi radha që unë të filloj me diskutimin tim, me të dalë në foltore, fillova në shqip duke theksuar keqardhjen time që për shkak të mungesës së përkthimit në shqip, isha i detyruar të flisja në gjuhën serbo-kroate, siç quhej atëherë.

Pas kësaj ndërhyrjeje që unë e bëra në sall u krijua në rrëmujë e në radhë të parë duke shtruar pyetje serbo-kroatisht “sta je rekao” - çka tha. Pasi u qetësua paksa situata, e vazhdova diskutimin në serbo-kroatisht. Në fakt ndërhyrjen time të gjithë përfaqësuesit e shtabeve komunale të MT-së të nacionalitetit shqiptar (e ata ishin shumicë) e pranuan dhe më përkrahën.

Pas mbarimit të këshillimit nëpërmjet të një korrieri më ftoi zoti Quranolli në kabinetin e tij duke gjykuar se unë paskam gabuar që kam shtruar çështjen e gjuhës në këtë këshillim dhe se do të kem reperkusione në karrierën time. Pasi që isha vetëm unë në zyrën përkatësisht në kabinetin e tij, me ngulm i rezistova qëndrimit të tij duke ia përkujtuar Kushtetutën dhe Ligjin për Mbrojtjen Territoriale dhe të drejtën e tij për t’u shprehur në gjuhën e shumicës, ai sikur më në fund këtë e kuptoi, por duke u arsyetuar se është tërësisht i “bllokuar” nga shefi i shtabit dhe ndihmësit e tij, që janë të tërë të nacionalitetit serb dhe malazias dhe se ai është i detyruar kështu të veprojë.<sup>5</sup>

5 Pas demonstratave të marsit të vitit 1981 për kryeshf të shtabit dhe njëkohësisht të zëvendës komandantit të SHKMT-së emërohet Kolonel (e më vonë Gjeneralmajor) Dërleviq i nacionalitetit malazias, ndihmëskomandant për çështje moralo-politike emërohet një kolonel me mbiemrin Turqinoviç, i përkatësisë nacionale serb, ndërsa shef i shërbimit të sigurimit ushtarak emërohet kolonel Svetozar Gërkoviç, po ashtu i nacionalitetit serb nga qyteza e Rahovecit etj. Në fakt ishte ky fillimi i serbizimit të Mbrojtjes Territoriale të Kosovës.

Fillova ushtrimet e llojllojshme dyditore të përbërjeve rezervë për të formësuar shtabet dhe njësitet e ndryshme. Njëkohësisht, nëpërmjet këtyre ushtrimeve në formësimin adekuat të MT, m'u dha rasti të kontaktoja me shumë intelektualë dhe drejtues institucionesh, që ishin të sistemuar në MT. Vazhdova ligjërimin e lëndës Mbrojtja e Përgjithshme Popullore dhe Vetëmbrojtja Shoqërore (MPP dhe VMSH) I dhe II në Fakultetin e Mjekësisë dhe në Fakultetin Juridik.

Ndërkohë, me një urdhëresë të posaçme, pas riorganizimit, mua si nënkolonel më emëruan komandant i shtabit regional të MT të Prishtinës. Komandanti i shtabit regional parashihej të ishte pozita e kolonelit. Regjioni i MT të Prishtinës përfshinte përveç kryeqytetit edhe Lipjanin, Gllgovcin dhe Podujevën. Ishte më se e qartë se duhej të bëja një punë shumë të madhe, në riorganizim dhe ristrukturim e kësaj force të armatosur. Tanimë ndikimi im në përbërje të komandave dhe njësiteve ishte i plotë dhe mjaft i suksesshëm. Në ndërkohë, si përfaqësues të MT, më propozuan dhe anëtar të Kryesisë së Lidhjes Socialiste të Kosovës, me mandat 4-vjeçar.

Në aspektin familjar, më 4 shkurt 1984, bashkëshortja, pas katër vajzash, më lindi 2 djem binjakë, Adrianin dhe Florianin. Ishte ky një lajm shumë i gëzueshëm për ne. Shumë njerëz na përgëzonin për lindjen e binjakëve. Disa na përgëzonin edhe nëpërmjet gazetës. Megjithatë, kishte edhe të atillë që nuk ishin gëzuar për lindjen e binjakëve. Pas 4-5 ditësh, papritmas, më ftoi në Shtabin Krahinor të Mbrojtjes Territoriale (SHKMT) shefi i shtabit të atëhershëm, gjeneralmajor D.Dërleviq. Ai, pas një hyrjeje që e bëri, kinse më kishte ftuar për të më konsultuar për diçka, sikur filloi të më qortonte se si ishte e mundshme që unë si nënkolonel, si njeri i arsimuar, të kisha 6 fëmijë. Sipas tij, kjo nuk kishte ndodhur në asnjë armatë. Pasi që u nevríkosa së tepërmi nga fjalët e tij, u ngrita në këmbë dhe i thashë: "Po ta dija për çka më keni ftuar, nuk do t'u përgjigjesha thirrjes suaj. Nëse nuk paska në asnjë armatë oficerë me kaq fëmijë, atëherë në këtë armatë jam unë". E braktisa rrëmbyeshëm kabinetin e tij...

Në gjysmën e dytë të vitit 1984, në planin familjar u ballafaqova me problemin e hapësirës jo të mjaftueshme në banesën aktuale, sidomos pas lindjes së binjakëve. Më takonte banesa 4 apo 5 dhomëshe sipas

numrit të anëtarëve të familjes. Banesa të mëdha për nevojat e mia, gjoja se, nuk kishte. Më orientuan që të gjej ndonjë banesë më të madhe nga fondi civil, në mënyrë që të bëhet zëvendësimi me ndonjë banesë nga fondi ushtarak, përkatësisht të bëhet blerja e saj. Në Elektroekonominë e atëhershme të Kosovës në Obiliq kontaktova me Adem Hashanin, i cili ishte drejtor i TE Kosova A. Më ofroi dy banesa adekuate për mua. Mirëpo, kryetari i komisionit për ndarjen e banesave ushtarake, kolonel Dushko Petroviq, me detyrë në Komandën e Korpusit të Prishtinës i lindur në Gjakovë (Kosovë), i refuzoi ato. I njëjti person refuzoi edhe një banesë në lagjen Ulpiana të Prishtinës, e cila ishte katërdhomëshe, duke deklaruar se sa të jetë ai kryetar i komisionit për ndarje të banesave, unë nuk do të mund të merrja zgjerim, sepse gjoja qenkam i cilësuar si separatist.

Duke parë se në këtë mënyrë nuk do të mund të siguroja banesë adekuate, vendosa t'i drejtohem komandantit të atëhershëm të korpusit të Prishtinës, gjeneralmajorit Sakib Pozderac, mysliman nga Sarajeva. Në një takim rasti të organizuar në Kuvendin e Krahinës së Kosovës e ku merrte pjesë edhe ky gjeneral, shfrytëzova rastin që t'i paraqitem dhe t'ia theksoj problemin me të cilin po ballafaqohem duke kërkuar që ai të më pranoj në zyrën e tij. Kështu të nesërmen më pranoi dhe në prezencën time e ftoi një kapiten të klasit të parë, përgjegjës teknik për ndarjen e banesave. Pasi që edhe ai ia shpjegoi se pengesë për ndarjen e banesës që më takonte ishte kolonel Petroviq, i urdhëroi që të ma japë banesën e një oficeri i cili po transferohej në Beograd. Kështu, pas gjysmë ore nga ky takim m'u dha vendimi me urgjencë për banesën më të madhe, falë mirëkuptimit dhe vendosmërisë së këtij komandanti i cili tregoi respekt të posaçëm për mua. Këtë banesë edhe sot e disponoj në pronësinë time dhe atë nga viti 1985.

Ndërkohë, në sferën profesionale dhe atë politike shumë shpejt përjetova tërë vrazhdësitë dhe specifikat e politikës së atëhershme jugosllave. I tërë aktiviteti politik i dedikohej gjykimit të, siç thuhej, nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar e shumë pak nacionalizmit dhe shovinizmit serb. Në dy raste, në fjalimet e mia, së pari mjaft ashpër e gjykova nacionalizmin serb por tërthorazi kritikojta butësisht veprimet radikale nga ana e popujve të tjerë, pra dhe të atij shqiptar. Për këtë, një ditë më ftoi komandanti i Mbrojtjes Territoriale të ish-Krahinës



Socialiste Autonome të Kosovës, gjeneralmajori Fadil Quranolli, i cili ma tërhoqi vërejtjen, duke më thënë se kishte ankesa nga të tjerët, sepse unë në diskutimet e mia, së tepërmi po e gjykoja nacionalizmin serb e shumë më pak atë shqiptar. U përpoqa t'i kundërvihesha me fakte për këtë që dëgjova, por ai sikur ma bëri me dije se do kisha pasoja për qëndrimet dhe diskutimet e mia.

Në një mbledhje të mbyllur të Kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste (për të cilën më informoi z. Remzi Kolgeci), një nga anëtarët e kryesisë, i nacionalitetit serb, paska dashur që çështja e komandimit tim në gjuhën shqipe në mbrojtjen territoriale të vihej në rend dite, gjë që qenka kundërshtuar nga disa anëtarë të tjerë, me arsyetimin se nuk ishte në të që të shtronte këtë çështje ngase kishte kush të më kontrollonte dhe të më vlerësonte nga strukturat ushtarake.

Në fund të tetorit të vitit 1985, papritmas regjioni im i MT-së u përfshi nga kontrollimi i paparalajmëruar nga inspektorati kryesor i Sekretariatit Federativ të Mbrojtjes Popullore. I mësuar me kontrollimet e tilla dhe të ngjashme, pa hamendje dhashë urdhëresën për mobilizim të njësiteve të caktuara. Ndërkohë, duke mbledhur dhe konsultuar shtabin e MT të regjionit të Prishtinës, e që ishte nga përbërja rezervë, ashtu siç më kishin dhënë urdhëresën, nxora një vendim të duhur, për përdorimin e forcave dhe mjeteve të caktuara. Ky vendim dhe udhëheqja, drejtimi dhe komandimi im për tri ditët vijuese, sa do të zgjaste kontrolli nga një gjeneral dhe disa kolonelë në krye të këtij inspektimi, më dhanë notën shumë të mirë. Angazhimi im dhe puna e palodhshme për ristrukturimin e MT, si të komunës së Prishtinës, ashtu edhe të regjionit, më në fund u shpagua. Rezultatet ishin të dukshme. Për këtë arsye, Shtabi Krahinor i Mbrojtjes Territoriale të Kosovës i dorëzoi SFMP propozimin për gradimin tim të parakohshëm me gradën e kolonelit (dy vite para kohës së caktuar për avancim të rëndomtë). Në fillim të vitit 1986, më kishin informuar se një propozim i tillë ishte përcjellë për në Sekretariatit Federativ të Mbrojtjes Popullore (SFMP), por këtë informatë unë e mora me një rezervë, aq më parë ngase nga disa qarqe të strukturave civile dhe ushtarake isha cilësuar si tepër i "albanizuar". Me një kënaqësi të posaçme vazhdova punën e mëtejme në planin zyrtar, sidomos nga ajo se punoja në vendlindjen time dhe me bashkëqytetarët e mi. Më propozuan për anëtar të Komitetit

Krahinor të LK-së. I fitova votat e nevojshme për këtë. Vazhdova me angazhimin tim në jetën politike të Kosovës, kuptohet si përfaqësues i MT të Kosovës. Pasuan shumë detyra të tjera e që i takonin trajnimeve fushore, të shtabeve dhe një numri të njësiteve. Roli im ishte më tepër drejtues dhe mbikëqyrës i zbatimeve të detyrave.

Në fund të shtatorit të vitit 1986, papritmas më ftoi komandanti i atëhershëm i MT të Kosovës, gjeneralmajor Muhaxhiri. Me të arritur në kabinetin e tij, ai më njoftoi me një gjeneralkolonel nga shtabi i përgjithshëm i ushtrisë jugosllave, emri i të cilit nuk më kujtohet. Në bisedë e sipër, ky funksionar i lartë ushtarak, shprehu një lloj admirimi për punën që unë po e bëja, por njëkohësisht sikur kalimthi m'i dha disa vërejtje që kishin të bënin me atë se unë si tepër isha "albanizuar". Më tha se unë isha prezent në opinion nëpërmjet mjeteve të informimit dhe se paraprkishtë nuk po i njoftoja organet e sigurimit lidhur me këtë. Ndër të tjera shtoi se edhe demonstratat e vitit 1981 nuk i kisha gjykuar sa duhet, etj.<sup>6</sup> Këto vërejtje dhe sugjerime nuk më bënin aq shumë përshtypje, sepse nuk kisha pritur diçka tjetër. Sidoqoftë, shpreha gatishmërinë time për punën e mëtejme. Atij ia bëra me dije se unë i takoja këtij populli me të gjitha virtytet dhe veset që i kisha. Gjatë bisedës së zhvilluar me të, ai u bind se unë isha punëtor i zellshëm dhe se e meritoja gradimin në gradën e kolonelit në mënyrë të jashtëzakonshme. Kështu, pas dy muajsh, ma kumtuan urdhëresën për avancim në këtë gradë. Tani isha një ndër kolonelët në moshë relativisht më të re.

## **Puna e mëtejme në Mbrojtjen Territoriale dhe ballafaqimi me nacionalizmin serb**

Fillimi i vitit 1987 më gjeti edhe më tej në detyrën e komandantit të shtabit regional të Prishtinës. Në planin politik gjërat shkonin keq. Në horizont shihej rivaliteti ose "dyluftimi" ndërmjet Ivan Stamboliqit, kryetarit të Serbisë, dhe Slobodan Millosheviqit, që gjendej në krye të Komitetit të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë. Në ndërkohë, në Mbrojtjen Territoriale (MT) të Republikës së Serbisë, në fillim të marsit,

<sup>6</sup> Kinse për këtë arsye, komisioni vlerësues ushtarak, më kishte refuzuar në raundin e parë të shqyrtimit për avancimin tim të jashtëzakonshëm

u organizua një konferencë vjetore e ashtuquajtur mësimore për t'i adresuar pikësynimet kryesore të MT të Serbisë për vitin 1987. Për këtë rast ishin të ftuar përfaqësuesit e MT të të gjitha republikave dhe krahinave autonome. Nga shtabi krahinor i MT i Kosovës, më zgjedhën si përfaqësues të Kosovës për të marrë pjesë në këtë konferencë. MT e Kosovës për nga kompetencat ishte e barabartë me MT të Serbisë (kështu ishte e paraparë në Kushtetutën e vitit 1974). Në këtë konferencë foli kryetari i atëhershëm i Serbisë, Ivan Stambolliqi. Më kujtohet kur ai, përveç të tjerash, kur ishte fjala për Kosovën, theksoi se “me shqiptarët duhet pasur kujdes se si veprohet”. “Ne duhet të bëjmë punën”, thoshte ai, “që ata vetë t'i qërojnë hesapet me kundërshtarët dhe kjo krahinë të mbetet serbe.... s'do mend se nuk duhet të përdoret dhuna, siç po mendojnë disa”. Sipas vlerësimeve të mia, fjalimi i tij konsistonte në faktin se autonomia duhet t'iu merret shqiptarëve, por që ata vet ta bëjnë këtë. Ishte kjo një metodë perfide dhe e rrezikshme.

Për shkak të demonstratave të viti 1981 të, siç thoshin, separatizmit shqiptar dhe vlerësimeve të kreut ushtarak jugosllav, në vitin 1987, sipas urdhëresës nga Kryesia e Jugosllavisë, tërë armatimi i Mbrojtjes Territoriale të Kosovës, që deri atëherë në shumicën e rasteve ishte mbajtur në hapësirat e Mbrojtjes Territoriale, duhej të vendosej në depot e ish-APJ-së, pavarësisht nga ajo se ky armatim ishte blerë me paratë e popullit të Kosovës. Kjo nënkuptonte në fakt çarmatosjen e kësaj strukture veçanërisht në Kosovë. Kjo ishte një simptomë ogurzezë. Përveç Mbrojtjes Territoriale të Sllovenisë që e refuzuan në tërësi këtë urdhëresë, për Kosovën kjo u pranua shumë lehtë dhe pa ndonjë rezistencë nga komandanti i atëhershëm, gjeneralmajor Ali Muhaxheri.

Tensionimet e situatës politike vazhdojnë edhe më tepër. Serbët filluan të protestonin nëpër rrugë. Në Fushë Kosovë, siç është e ditur, kishte mbajtur një fjalim të zjarrtë Millosheviqi, i cili në fakt paralajmëroi luftën që do të pasonte. Duke mos dashur të lëshohem në çështje politike, duhet të theksoj se kreu i MT së i Krahinës së Kosovës, duke parë se në tubime të serbëve po merrnin pjesë edhe pjesëtarët e MT-së nga radhët e komunitetit serb, mori vendim që të organizohej një tubim me të gjithë pjesëtarët e MT-së që i përkisnin rajonit të gjerë të Fushë Kosovës. Gjenerali Ali Muhaxheri më urdhëroi që të shkoja dhe të flisja në atë tubim. Me mjaft vështirësi pranova që të dilja dhe të flisja në atë

tubim. Më shoqëronte njëfarë Zhika Patriq (i nacionaliteti serb), major në rezervë, atëherë funksionar i Lidhjes Socialiste të Prishtinës. Tubimi mbahej në një sallë të Shtëpisë së Kulturës në Fushë Kosovë. Në fillim, sikur më pranuan mirë të pranishmit, por kur fillova të gjykoja daljen e tyre në rrugë, duke u thënë se nuk u përkiste pjesëtarëve të Forcave të Armatosura (FA) të Jugosllavisë të kërkonin zgjidhjen e problemeve në rrugë, nga salla u dëgjuan ulërime e fishkëllima, duke kërkuar që ta ndërprisja fjalimin tim.

Megjithatë, arrita t'i qetësoja disi, duke ia dhënë fjalën Patriqit, i cili, për çudinë time, i përkrahu plotësisht tubimet e serbëve dhe daljen e tyre në rrugë. Arrita të dilja nga salla pa lëndime dhe së bashku me Patriqin u nisëm në drejtim të Prishtinës. Gjatë rrugës e qortova ashpër Patriqin për qëndrimin e shprehur në tubim. Ai sikur nuk më kundërshtoi, por theksoi se nuk mund të kishte qëndrim tjetër si serb, as që guxonte të shprehej ndryshe para tyre.

I raportova komandantit të MT të Kosovës për këtë temë dhe ai sikur ishte befasuar me reagimet e këtyre oficerëve e në veçanti të Patriqit. Pas këtij tubimi dhe fjalimit që unë e mbajta në Fushë Kosovë, si duket organet e sigurimit më cilësuan si element jo fort i sigurt për arritjen e qëllimeve serbomëdha që do të pasonin.

Në shtabin regjional të MT të Prishtinës, që unë e drejtoja, përbërja nacionale e ushtarëve dhe oficerëve tashmë ishte përmirësuar dukshëm. Përqindja e shqiptarëve sillej diku rreth 80 për qind. Në fakt, të gjitha gjërat i vura nën kontroll. Organet e sigurimit e vërejtën një gjë të tillë, por nuk pata ndonjë ballafaqim me ta. Punën profesionale e kryeja me sukses. Sa i përket përbërjes nacionale të kuadrit, kjo ishte në pajtim me ligjin e MT-së dhe kushtetutën e atëhershme të Jugosllavisë.

Sipas rezervimit që kisha bërë më herët dhe në bazë të gradës që kisha (kolonel), më takonte një apartament komod në pushimorën ushtarake, në "Ujdhesën e luleve" në Tivat (Mali i Zi), siç e quanin atë vend. Sapo përfundoi pushimi 15-ditor, u ktheva në shtëpi. Flitej se pas këtij pushimi do të më transferonin diku. Isha i vetëdijshëm se pas situatës së krijuar në planin politik dhe të sigurisë, diçka po përgatitej edhe për mua.



**PJESA E TETË**  
**TRANSFERIMI NË GARNIZONIN**  
**E ZAJEÇARIT**

Më ftuan në shtab, edhe pse isha në pushim. Komandanti i Mbrojtjes Territoriale të Krahinës së Kosovës, A. Muhaxheri, ma dorëzoi urdhëresën e Veljko Kadijeviqit, sekretar federativ i Mbrojtjes Popullore të Jugosllavisë. Sipas kësaj urdhërese, më 1 shtator 1987 duhej të lajmëroheshja në garnizonin e Zajeçarit, në detyrën e komandantit të brigadës, siç e quanin brigadën e nëntë serbe të këmbësorisë (më vonë e moto-mekanizuar), që ishte bartëse traditash e një farë brigade nacional çlirimtare sulmuese. Zajeçari ishte një qytet në Serbinë Lindore e që si komunë kufizohej me Bullgarinë në lindje, si dhe me komunat tjera të Negotinint dhe Knjazhevcit. Këto tri qytete dhe ai i Borit, përbënin qarkun e Timokut (sipas lumit Timok). Në përbërje nacionale pas komunitet serb vinte ai rumun (vllahët), qendra e qarkut ishte në Zajeçar, atëbotë në krye me Nikola Shainoviçin, tani i dënuari i Hagës për krime lufte.

Zhënjimi im ishte shumë i madh. Isha përgatitur psiqikisht që ta refuzoja këtë urdhër, të shkoja për një kohë në burg dhe të largohesha nga APJ, përkatësisht nga FA të Jugosllavisë. Me të dëgjuar këto fjalë, gjeneral Muhaxhiri, një ditë më ftoi për një bisedë në kabinetin e tij. Mbase jorastësisht, atë ditë në kabinetin e tij ishte edhe anëtari i Kryesisë së Kosovës, z. Nebih Gashi. Duke e ditur se unë kisha vendosur që ta refuzoja urdhëresën e sekretarit federativ të MP, i vetëdijshëm edhe për pasojat që do të pasonin, Nebih Gashi më bindi se ky transferim nuk do të zgjaste më shumë se një vit dhe se do të kthehesha pastaj në Prishtinë. Edhe pse e dija se një gjë e tillë nuk ishte e sigurt, por duke pasur respekt për të, qëndrimet e Gashit sikur më bindën të shkoja në Zajeçar.

Isha i bindur se ky transferim kërkohet nga organet e sigurimit, me qëllim të largimit tim nga Kosova, sepse në ngjarjet që do të ndodhnin në Kosovë, prisnin një rezistencë potenciale nga unë, po edhe nga një pjesë e njësiteve që i komandoja në shtabin regional të MT të Prishtinës.

Pra, urdhëresa ishte e prerë, që do të thoshte: “Kryeje urdhrin e pastaj ankohu”. Kjo ishte goditje e madhe për mua, aq më parë, që tanimë kisha 6 fëmijë, katër prej tyre duke u shkolluar në Prishtinë, në gjuhën amtare, po edhe probleme të tjera, që më përcillnin si hije.

## Shkuarja në Zajeçar dhe përgatitja për pranimin e detyrës së re

Më 1 shtator 1987, sipas urdhëresës, u lajmërova në komandën e garnizonit të Zajeçarit për të pranuar detyrën e komandantit të brigadës, e cila ende ishte nën juridiksionin e komandës së njëfarë divizioni të Timokut, që kishte filluar të shuhej. Në përbërjen e vet, ky divizion, përveç brigadës që unë do ta drejtoja, e që ishte edhe njësit i më i madh, kishte një regjiment të Knjazhevcit dhe një regjiment të klasifikimit “B” të Paraçinit dhe disa njësi të tjera më të vogla. Komandanti i deriatëhershëm i kësaj brigade, një kolonel me mbiemrin Kostiq, ndodhej në pushim vjetor. Pa prezencën e tij, në fakt nuk kishte mundësi që unë të filloja të pranoja detyrën për shkak të procedurave të parapara posaçërisht për raste të këtilla. Pritja ime do të zgjasë deri më 25 shtator, kur do të duhej të kthehej komandanti i deriatëhershëm. Më vendosën përkohësisht në një apartament, siç e quanim atëherë të shtëpisë së armatës (kulturës). E përcillja punën dhe aktivitetin e brigadës, e cila shtrihej me një batalion, edhe në qytetin Negotinit dhe me tërë rezervën e armatimit, të municionit, të raketave, të tankeve etj. në një qytezë që quhej Bolevac. Më ra në sy një mosdisiplinë, mospunë, oficerë noshalantë, të cilët kishin filluar të merreshin më tepër me politikën serbomadhe të Millosheviqit sesa që punonin për ngritjen e gatishmërisë luftarake të kësaj brigade. Për çudi, përbërja e kësaj brigade me ushtarë aktivë, në momentin e analizave që unë i bëja, ishte deri në 30 për qind me shqiptarë. Kjo edhe nga shkakut se kjo brigadë mbyllte drejtimin e quajtur “Timoçko-Moravski” (Timoko-Moravian) dhe në momentin aktual politik nuk pritej që ajo të përfshihej fillimisht në veprimet luftarake. Për atë, si duket edhe rekrutoheshin shumë shqiptarë në të.

## Rasti i Paraçinit

Më 4 shtator të vitit 1987, në orët e hershme të mëngjesit, ndodhi ngjarja tragjike e Paraçinit, në regjimentin e klasifikimit “B” e që ishte në kuadër të komandës së divizionit të Timokut. Brigada e Zajeçarit nuk kishte të bënte me këtë njësit të stacionuar në Paraçin. Lajmet ishin mjaft konfuzë. Më kujtohet se si, të nesërmen, oficerët e brigadës



dhe të tjerët morën urdhrin që me dy autobusë të lajmëroheshin në kazermën e Paraçinit, për të parë më për së afërmi se si kishte ndodhur masakra, ku ishin vrarë katër ushtarë dhe ishin plagosur katër të tjerë. Synimi i kësaj vizite ishte të shpjegohej dobësia e organeve të brendshme (e kujdestarëve) të cilët nuk e paskëshin kryer detyrën si duhej. Me ngulm jepej shpjegimi se masakrën e kishte shkaktuar një ushtar i përkatësisë nacionale shqiptare, i quajtur Aziz Kelmendi, i cili, siç thoshin, më pas e kishte vrarë veten në një mal në afërsi të kazermës së Paraçinit. Ajo që më ra në sy ishte fakti se, derisa oficerët qëndronin në rresht dhe informoheshin për ngjarjen, komandanti i kësaj njësie, një nënkolonel, qëndronte në rresht me të tjerët, ndërsa shefi i sektorit të sigurimit të brendshëm në armatën e Nishit, një kolonel, i cili më vonë do të avancohej në gradën e gjeneralit, shëtiste lirshëm nëpër kazermë. Në këto situata, përveç komandantit të regjimentit, do të duhej që edhe shefi i sigurimit të brendshëm të ishte ndalur në polici ushtarake për hetime të mëtejme. Një gjë e tillë nuk kishte ndodhur. Pasi që pata rastin të hyja në dhomën e masakrës, vëreja se muret, dyshemeja dhe krevatet ishin të gjakosura. Ishte situatë vërtet tmerruese. Papritmas, m'u ofrua një ushtar dhe m'u drejtua më këto fjalë: *"Shok kolonel, merreni me mend, po të mos më urdhëronte kapteri që ta ndërroja krevatin e fjetjes (duke më treguar krevatin ku ishte i vrarë një ushtar e që më parë kishte qenë krevati i tij), sot do të isha i vrarë"*. Në pyetjen time se pse e kishte urdhëruar eprori që ta ndërronte krevatin, ai nuk pati përgjigje. Kjo dhe çështje të tjera ma shtuan dyshimin se kjo ngjarje nuk kishte ndodhur rastësisht, por si duket ishte përgatitur mirë e me plan vetëm e vetëm që në vrasje të përfshihen, përveç serbëve, edhe nacionalitetet e tjera.

Ngjarja e Paraçinit vetëm sa e shpejtoi rënien e Jugosllavisë, por në anën tjetër ajo provokoi fuqishëm albanofobinë, e cila sa vinte e rritej.

Për ne, kuadrot shqiptare në APJ, filluan ditët e vështira.

Në ndërkohë u kthyem në garnizonin e Zajëçarit për të filluar pranim-dorëzimin e detyrës së komandantit të brigadës. Problemet ishin të mëdha. Për shkak të karakterit të detyrave, lëvizjet e njësiteve të ndryshme, të teknikës, të armatimit e kështu me rradhë ishin të shumta. Përveç kësaj e kryeja edhe detyrën e komandantit të garnizonit. Detyra

shtesë ishte ajo e sigurimit të kufirit me Bullgarinë. Problemi i veçantë ishte logjistika e kësaj brigade. Në kryerjen e detyrave të parashtruara më ndihmonte shefi i shtabit të brigadës, që ishte njëkohësisht edhe zëvendësi im. Ky ishte një oficer tankist i shkolluar, i cili një kohë të gjatë kishte shërbyer në këtë njësi. Ishte nga Vranja. Ndërsa ndihmësit e mi, tre nënkolonelë, njëri për sigurim të brendshëm, tjetri për punë moralo-politike dhe ai për logjistikë, përveç punës që e kryenin sipas sistematizimit, kishin për detyrë (sekrete) të më përcillnin e të më kontrollonin në çdo hap. Unë e dija këtë. Isha shumë i rezervuar, sidomos në ndeja private, ndërsa në detyra zyrtare i largoja duke u dhënë detyra të ndryshme, me afat të caktuar. Me një fjalë, mundësitë për shantazhe dhe ndërskamca ekzistonin qartazi.

Më 22 dhjetor të vitit 1987 u bë rreshtimi i njësisë ku ftoheshin mysafirë nga qytetet i Zajëçarit dhe i rrethinës. Me rastin e kësaj dite e përgatita një fjalim që do ta mbaja nga një skenë statike me zërim brenda kazermës. Me të arritur në skenë, pas raportit që më dha zëvendësi im, dhe intonimit të himnit, vëreja më tepër qytetarë sesa që kishte ushtarë brenda kazermës. Në pyetjen time se pse kishin ardhur kaq shumë qytetarë dhe a ndodh kjo rëndom, zëvendësi im më tha se kjo nuk kishte ndodhur më herët, por kësaj radhe, siç më tha ai, “kishin ardhur për t’ju parë juve, si kolonel shqiptar”, e që për ta ishte risi. Paksa më kapluan emocionet, por së shpejti e mora veten dhe fjalimin tim e lexova me një zë kumbues dhe serbishte të pastër e që për të pranishmit ishte gati e pabesueshme. Problemet ishin të njëpasnjëshme, por tani çdo gjë e dija përmendesh, e dija se çka duhej të bëja dhe në çfarë kohe ta bëja.

Milloseviqi, me soldateskën e vet, ishte në ngritje e sipër. Në zgjedhjet lokale dhe parlamentare serbe, që u mbajtën më 1988, isha me disa njësi në një ushtrim fushor në malin e quajtur Rtanj, në verilindje të Sokobanjës. Më kujtohet se si oficerëve që banonin në garnizonin e Zajëçarit, iu shpërndanë fletëvotimet në terren dhe votimi ishte thuaja se i hapur dhe për Milloseviqin. Doli se në votim kishin dalë 100% e votuesve! Po zinte fill kështu dhe po etablohej një regjim totalitar. Për një pakujdesi sado të vogël, mund të burgosej njeriu. Isha gjithnjë në stres. Jetoja ndaras nga familja. Një herë në dy javë, me vështirësi, gjeja

kohë për të shkuar në Prishtinë, por edhe atëherë, më shqetësonin me pyetje telefonike për marrje të vendimeve të ndryshme.

Sikur të tjerët, edhe unë, e dorëzova lutjen për të më kthyer në detyrë në garnizonin e Prishtinës, duke i theksuar në veçanti problemet familjare që i kisha me rastin e qëndrimit tim në garnizonin e Zajeçarit. Më vonë e kuptova se kërkesën time për transferim nuk e kishte shqyrtuar askush.

Për shkak të specifikave të kësaj brigade, që ishte vazhdimisht në llogorime të ndryshme, isha gjithnjë në lëvizje, nga një vend në tjetrin, për inspektim dhe kontroll. Në ndërkohë (më 20 shkurt 1988), në minierën e Trepçës u ngujuan minatorët duke u krijuar një situatë shumë e ndërlikuar politike. Ndodhi edhe burgosja e Azem Vllasit e gjëra të tjera që kishin të bënin me burgosje, dënime e represion ndaj bashkëqytetarëve të mi. Organet e sigurimit ushtarak më përcillnin në çdo hap. Këtë e kisha më se të qartë, prandaj syçelësia nuk duhej të mungonte për asnjë çast. Në disa raste, nga komanda e korpusit të Nishit, merrja urdhër me telegram që, si komandant i brigadës, t'i informoja personalisht për përbërjen e brigadës për situatën e krijuar politike në Kosovë. Sikur të ishte gjendja normale, informimin do të duhej ta bënte ndihmësi im për çështje moralo-politike. Por, urdhëresa ishte krejt ndryshe nga normalja dhe këtë e diktonin organet e sigurimit ushtarak, me qëllim që të më "kapnin" për ndonjë fjale dhe të më burgosnin. Përvoja më kishte mësuar se si të mbrohesh. Në fakt, çështjet që duhej shtjelluar me informim të mëngjesit dhe atë në binë statike me zërim, i përgatitja gjatë kohës së pushimit në orët e vona të natës. Tekstin e mësoja që më parë dhe fjalimin e mbaja, si me rregull, pa koncept të shkruar, duke i theksuar kalimthi çështjet politike e duke u fokusuar në ato thjeshtë ushtarake që i përkisnin "nevojës" së gatishmërisë vepruese të brigadës...

Gati erdhi edhe fundi i vitit 1988. Për kthimin tim në garnizonin e Prishtinës, as që bëhej fjalë, së paku ashtu siç më kishte premtuar ish-komandanti i MT të Kosovës, gjeneral Muhaxheri dhe anëtari i Kryesisë së Kosovës, z. Gashi.

**PJESA E NËNTË**  
**VEPRIMTARIA IME NË NJË**  
**SITUATË, THUAJA SE, TË LUFTËS**

Viti 1989 ishte edhe më i rëndë për mua, sepse iu hoq autonomia Kosovës dhe situata politike dhe ajo e sigurisë përkeqësohej gjithnjë e më tepër. Fyerjet, rrahjet, dënimet, por edhe vrasjet e popullit tim, nuk ndaleshin. Luftoja në dy fronte: si ta mbaja komandën në një njësit shumë specifik, përkatësisht në një armatë, të cilën tanimë nuk e doja dhe si ta përmbaja veten nga ankthi që përjetoja. Në ndërkohë, në një aksident trafiku, në afërsi të Knjazhevcit, si rezultat i moskujdesit të eprorit dhe vozitësit të një kamioni ushtarak, në të cilin gjendeshin 22 ushtarë, nga përplasja me një veturë civile, gjatë tentimit të daljes në rrugën kryesore, vdesin dy nga tre civilët që ndodheshin në veturë. Në të njëjtën fatkeqësi, pasi që kishte rënë terri, duke i ndihmuar të plagosurve, në trupat e ushtarëve përplasjet edhe një veturë të cilin e kishte drejtuar një person i dehur. Për fat, përveç thyerjeve të gjymtyrëve të tre ushtarëve, asnjëri nga ata nuk e kishte jetën në rrezik.

Ngjarja vërtet ishte tmerrësisht e rëndë. Lidhur me këtë fatkeqësi trafiku, nga Sekretariati Federativ i MP, në krye me një kolonel, u formua komisioni i përbërë prej ekspertëve të komunikacionit, për të hulumtuar rastin. Gjatë tri ditësh të plota të inspektimit dhe hulumtimit, anëtarët e këtij komisioni u përpoqën maksimalisht që të siguronin prova për fajin tim, kinse unë si komandant nuk i kisha ndërmarrë të gjitha masat e duhura në aspektin e drejtimit dhe komandimit, por, më në fund u vërtetua se fajtor për këtë fatkeqësi trafiku ishte vetë vozitësi dhe nënoficeri, si epror i kamionit. Kështu, për pak i shpëtova shkarkimit, por edhe mundësisë së burgosjes, aq më parë kur disa qarqe të caktuara ishin angazhuar që të më shpallnin fajtor.

Falë korrektësisë dhe aftësisë së mirëfilltë profesionale të kolonelit të shërbimit të komunikacionit e që edhe ishte shef i drejtorisë së komunikacionit, shpëtova nga burgosja.

Në anën tjetër, në Kosovë, doktor Ibrahim Rugova e kishte formuar LDK-në, partinë e parë kosovare në sistemin shumëpartiak, të sapo instaluar në ish-Jugosllavi. Përafërsisht, dy muaj pas formimit të LDK-së, në kabinetin tim në Zajëçar, papritmas vjen një kolonel i nacionalitetit maqedonas, shefi i sigurimit të armatës së Shkupit. Atë e shoqëronte ndihmësi im për sigurim ushtarak, nënkoloneli Miliq, i cili ishte një nacionalist dhe shovinist i përбетuar nga rrethina e

Pirotit. Pyetja e parë e tij drejtuar mua ishte: Si është e mundur që unë, me një gradë kaq të lartë, të mos i ofroja organeve të sigurimit asnjë informatë, siç thoshte ai, për “Ushtrinë e Rugovës” e cila sipas tyre ishte duke u formuar në dy formacione apo divizione ushtarake. Ishte më se e qartë se ky më tepër ishte një trillim apo shpikje nga frika sesa që kishte të vërtetë në tërë këtë informatë. Këtë unë e dija fare mirë, edhe pse nuk isha prezent në Kosovë. Përgjigja ime kategorike lidhur me këtë ishte se nuk kisha kurrfarë njohurie, aq më parë që nuk jetoja në Kosovë. Ashtu i dëshpëruar, ndër të tjera, atij i thashë se nuk isha informatori i tij dhe nuk isha i obliguar t’i jepja informata atij. Polemika midis nesh zgjati rreth 45 minuta. Koloneli u nis drejt korridorit, ndërsa unë nuk e përcolla fare, vetëm pak u ngrita nga karriga ime. Kuptohet pas kësaj bisede të ashpër pritja implikime sepse nuk e dija se çka më përgatitej tjetër prapa shpine. Hëpërhë, nuk pati ndonjë organizim tjetër kundër meje. Një brez tjetër i ushtarëve, erdhi në shërbim ushtarak. Detyrat e mia tanimë ishin rutinore. Me qëndrimin tim konsekuent ndaj detyrave dhe me menaxhimin e duhur të njësitit si ekspert, sikur kishin filluar të frikësoheshin, sidomos disa nga oficerët, që nuk i kryenin detyrat ashtu si duhet. Vetëm me punë arrija ta mbaja një disiplinë normale. Nuk ishin të rralla edhe rastet kur ndonjëri nga oficerët apo ushtarët i shmangej përballjes me mua. Përveç zëvendësit tim, një nënkoloneli tankist, siç thash, nga Vranja, e i cili më përkrahte me një numër ushtarësh e oficerësh, pjesa tjetër dërrmuese e ushtarëve dhe e oficerëve, kush më pak e kush më shumë, bënë obstrukcione. Siç u informova më vonë, edhe ky nënkolonel i lartpërmendur (ish-zëvendësi im), në vitet ‘90-ta, u avancua në gradën e gjeneralit dhe shërbeu edhe në regjimin e Millosheviqit.

Pasi që e kisha shkruar lutjen për transferim, diku në muajin mars të po atij viti, më ftuan në komandën e korpusit në Nish për t’u takuar me komandantin e armatës së Shkupit, me gjeneralkolonelin Avramoviq. Në bisedë e sipër me të lidhur me arsyen pse unë insistoja të kthehesha në Kosovë, ai sikur ma bëri me dije se kjo nuk do të realizohej edhe gjatë atij viti, sepse, përveç të tjerash, unë “isha indiferent ndaj ngjarjeve dhe rreziqeve që kanoseshin në Kosovë nga separatistët shqiptarë” dhe çështje të ndërlydhura.

Zhgënjimi im me gjendjen e krijuar ishte shumë i madh. Siguria ime personale vihej në pyetje gjithnjë e më tepër.

## **Ballafaqimi i sërishëm me organet e Sigurimit Ushtarak**

Diku në fillim të qershorit më erdhi një ftesë zyrtare (telegram), sipas së cilës, pas dy ditësh (nuk më kujtohet data), më urdhërohej që në orën dhjetë t'i lajmërohesha po këtij gjenerali në komandën e Armatës në Shkup, përkatësisht komandantit të armatës. Atë natë, duke supozuar se për çfarë arsye më kishte kërkuar ai, nuk fjeta fare. Të nesërmen, pasi e përgatita zëvendësin tim për t'i kryer disa detyra vijuese, me një veturë zyrtare të tipit "Puch", me vozitësin tim të nacionalitetit serb, u nisa për në Prishtinë për ta vizituar familjen dhe të nesërmen, në kohën e caktuar, për t'u lajmëruar në sportelin e komandës së armatës në Shkup. Pasi që më bindën se armën duhej ta lija në sportel, hyra në kabinetin e gjeneralit. Kur u prezantova, e vërejta se aty ishte koloneli (emri i të cilit nuk më kujtohet) dhe shefi i shërbimit ushtarak, i cili para tre muajsh ishte tek unë në Zajëçar. Derisa u ula, e kuptova se do të kisha punë me organet e sigurimit ushtarak. Në zyrat e komandantit të armatës vinte erë uiski. Ata, që të dy, më parë kishin pirë. Më ofruan edhe mua që ta "çoja" një gotë, por unë këtë e refuzova, duke u arsyetuar se nuk e konsumoja alkoolin. Më pas, më ofruan një lëng frutash. Biseda ishte shumë e shkurtër. Më tha se krerët ushtarakë ishin të kënaqur me punën time si profesionist, por si kolonel që isha, duhej t'i jepja edhe disa vlerësime për detyrën shumë të rëndësishme që e kisha dhe të merresha vesh me organet e sigurimit ushtarak që t'u ndihmoja edhe atyre. Ishte ky një lloj presioni nga "lartë" që unë patjetër të bashkëpunoja me organet e sigurimit ushtarak. Me kolonelin e sigurimit, shkuam në zyrën e tij, edhe një kat më lart. Drejtoria e sigurimit ushtarak ishte plotësisht e ndarë nga drejtoritë e tjera. Biseda ishte e njëjtë, sikur në Zajëçar. Ai kërkonte që ta informoja se çka po ndodh në Kosovë, a kishte "përgatitje ushtarake separatiste", e kështu me radhë. Për dallim nga hera e parë, në këtë bisedë, ai sikur e përmendi mundësinë e transferimit tim në Prishtinë, kuptohet nëse do të pranoja të bashkëpunoja me ta. Pasi që pa hamendje, kategorikisht, e kundërshtova një gjë të tillë, duke i thënë se unë nuk jetoja në Kosovë, se nuk i përkisja kategorive të tilla të njerëzve, se isha komandant i një brigade dhe kisha gradën e kolonelit, ai çuditërisht m'u drejtua me këto fjalë: "Qehaja, dil në atë sallë atje, ulu dhe mendo mirë për këtë". Unë reagoja ashpër, duke i thënë: "Kush je ti të më urdhërosh që unë të pres në atë sallë, kur ne jemi të barabartë, si me gradë ashtu edhe me pozitë". Sidoqoftë, dola në një sallë të vogël

ku ishte një kolonel tjetër. Ai sikur u bë “mikpritës,” por nuk doja të flisja me të. U ula dhe për një kohë mendova ç’do të bëja. Të largohesha njëanshmërisht nga kjo sallë, supozoja se do të më ndalnin me polici ushtarake. Fillova të shëtisja nëpër korridor me duar në xhepa. Më shikonin disa oficerë me grada më të ulëta, më përshëndesnin, sepse më njihnin. Isha shumë nervoz. Aty qëndrova për katër orë rresht. Vendosa të hyja në zyrën e kolonelit (drejtor i drejtorisë së sigurimit ushtarak). I thashë se unë duhej të ecja pasi që kisha për të udhëtuar larg, dhe se ushtarin (voztësin) e kisha të uritur. Më tha se nuk dinte se si t’ia bënte. Më pas erdhi një kolonel tjetër dhe më tha se mund të udhëtoja. U largova pa u përshëndetur me shefin e drejtorisë së sigurimit ushtarak. Në fakt, kishin pasur për qëllim që të më frikësonin dhe në këtë mënyrë ta pranoja bashkëpunim me ta. E mora pistoletën nga sporteli i komandës së armatës dhe me xhip ushtarak u largova në drejtim të Kumanovës, për të vazhduar rrugën për në garnizonin e Zajëçarit. Sikur kisha drojën se do të më përgatitej ndonjë kurth gjatë rrugëtimit tim, por edhe gatishmëria për vetëmbrojtje, për aq sa ishte e mundshme, gjithnjë ekzistonte. Deshi Zoti dhe, rreth gjysmës së natës, arrita në garnizon, i lodhur dhe i nënçmuar. Rashë për të fjetur. M’u kujtuan ushtarët, por edhe oficerët e tjerë shqiptarë me grada më të ulëta, se çfarë presionesh përjetonin. Nuk kisha çka të bëja. Situata ishte e tillë dhe doemos duhej të punonim edhe në kushte të tilla. Të pashmangshme ishin ndryshimet që unë i prisja.

Pas dy javësh u zhvendosa sërish në Krivollak të Maqedonisë. Atje drejtoja një ushtrim fushor me një pjesë të brigadës sime. Aty qëndrova për 10 ditë rresht. Ishte sfidë, lodhje, por edhe zhgënjim me rrethanat e krijuara në APJ. Me të madhe filloi të lëshonte rrënjë e të mbretëronte shovenizmi serbomadhi. Si rezultat i kërkesave të mia të vazhdueshme për t’u kthyer në gjirin familjar, si pasojë e “albanizmit” tim të tepruar, siç më thoshin, i mungesës së bashkëpunimit me organet e sigurimit, bisedat e mia telefonike vazhdimisht përgjoheshin. Më përgjonin edhe kur flisja me bashkëshorten time, e cila ishte e frustruar nga dhuna e ushtruar ndaj rinisë shqiptare në Prishtinë nga establishmenti policor serb. Si dëshmitare okulare e kësaj dhune, ajo fliste hapur kundër saj. Në qershor të vitit 1989 më erdhi urdhëresa për transferim në garnizonin e Beogradit. Më kishin emëruar ligjërues të lëndës “Strategjia” në Qendrën e Lartë Shkollore në Banjicë. Këtë, ndër të tjera, e konsideroja edhe si hakmarrje të shefit të atëhershëm të shtatmadhorisë së APJ-së, të gjeneralit Bllagoje Axhiq, i cili më parë kishte qenë në korpusin e



Prishtinës dhe e kishte përcjellë aktivitetin tim në mbrojtjen territoriale, por edhe në jetën politike dhe ligjërimit në Universitetin e Prishtinës. Në një bisedë joformale, qysh në vitin 1988, ai pati deklaruar se “sa të jetë ai shef i shtatmadhorisë në ushtrisë jugosllave, Qehaja nuk do të kthehet në Kosovë”.

Pas një ceremonie të zymtë, e dorëzova detyrën e komandantit të brigadës së nëntë, ashtu të quajtur sulmuese serbe të Ushtrisë Nacional Çlirimtare në garnizonin e Zajeçarit. Detyrën ia dorëzova zëvendësit tim të deriatëhershëm, Momqilloviqit.

## **Transferimi në Beograd në detyrë të mësimdhënies**

Pas pushimit 25 ditësh, më 25 korrik u lajmërova në qendrën shkollore në Banjicë të Beogradit. Më pranoi shefi i katedrës së strategjisë, gjeneralmajori dr. Radinoviç. Gjatë bisedës me të shpreha habinë time se si ishte e mundur që të transferohesha dhe të emërohesha për ligjërues pa pëlqimin tim. Kjo aq më parë që vendet e zbrazëta për profesorë, ligjërues, asistentë etj., duhej të plotësoheshin me konkurs. Për fillim, shefi i katedrës m'i caktoi disa detyra të planifikimit në katedër. Njëkohësisht, kisha njohuri se ky person ishte shumë i afërt me shefin e shtatmadhorisë së APJ-së, me gjeneralin Axhiq, i cili më kishte mbajtur larg familjes dhe Kosovës, katër vjet rresht.

Në fakt, angazhimet e mia në Qendrën e Lartë Shkollore ishin mjaft të vogla. Nuk kisha më as gatishmëri dhe as fuqi për punë. Udhëtoja gati për çdo fundjavë për në Prishtinë me një autobus me të cilin udhëtonin edhe deputetët shqiptarë të Kuvendit të Jugosllavisë. Intensiteti i punës, siç thashë, tanimë më kishte rënë në nivelin më të ulët të mundshëm.

Haptazi, në çdo hap, vëreheshin elementet luftarake, sidomos në katedrën ku gjendesha unë, po dhe në Qendrën e Lartë Shkollore, e cila përfshinte Akademinë Ushtarake të Ushtrisë Tokësore të cilën e kisha kryer më 1966, Akademinë Komanduese Shtabore, të cilën e kisha kryer më 1974, Shkollën e Mbrojtjes Nacionale, të cilën e kisha kryer më 1981 e disa drejtime të tjera.

Një muaj pas shkuarjes sime në atë detyrë, me shkrim iu drejtova sekretarit federativ për mbrojtje popullore, gjeneralkolonelit Kadrijeviq, që të më pranonte në bisedë, gjatë së cilës do t'ia paraqisja brengat dhe problemet me të cilat përballesha, duke jetuar ndaras nga familja. Prita 30 ditë rresht dhe nuk mora përgjigje, qoftë edhe negative.

**PJESA E DHJETË**  
**TRANSFERIMI NË PRISHTINË**  
**DHE KTHIMI I SËRISHËM**  
**NË MBROJTJEN TERRITORIALE**

Pasi që shefi i kabinetit të sekretarit federativ të mbrojtjes popullore ishte një gjeneralmajor i quajtur Vuk Obradoviq, me të cilin e kisha kryer Akademinë Ushtarake, vendosa të shkoja tek ai, por pa paralajmërim. Çuditërisht, në hyrje të ndërtesës, në sportel të policisë ushtarake, më vërejt një ish nënoficer i nacionalitetit serb, nga shërbimi im i viteve '70 në Prishtinë, i cili për shkak të konsideratës që kishte ndaj meje, as që ma ndali letërnjoftimin ushtarak, siç ishte rregull. Më përcolli deri tek gjenerali Obradoviq, i cili po sa më vërejt, ashtu i habitur, më priti me fjalët: "Po ku je more gjeneratë" dhe më akomodoi, duke më ofruar kafe. Në bisedë e sipër me të, u pa se ai ishte informuar me problemin tim, përkatësisht me lutjen që i kishte dërguar, por që kishte mbetur pa përgjigje. Me atë rast, ia shpjegova edhe qëllimet tendencioze të disa eprorëve që kishin ndaj meje, duke përfshirë këtu edhe gjeneralin Axhiq dhe të tjerët. Pasi që u bind se kërkesat e mia për kthim në Prishtinë ishin të arsyeshme, më premtoi se do të angazhohej personalisht për kthimin tim në Prishtinë dhe atë, brenda 30 ditësh. U largova nga zyra e tij, me bindje të fortë se do të më ndihmonte.<sup>7</sup> Ndërkohë, sa më kujtohet, pas tre-katër ditësh, në zyrën time (në katedrën e strategjisë) erdhi një nënoficer i cili më tha se duhej t'i lajmërohesha një gjenerali me mbiemrin Denda, i cili ishte shef i drejtorisë së personelit në Sekretariatit Federativ të Mbrojtjes Popullore. Sipas njohurive që kisha, ai ishte i lindur në Lipjan të Kosovës. Me të arritur në kabinetin e tij, pasi që më la të prisja rreth 30 minuta tek asistenti i tij, më pranoi. Posa hyra brenda, në vend që të më ftonte të ulesha, derisa isha në këmbë, m'u drejtua me fjalë mjaft të ashpra, duke më thënë: "Çka po doni ju? APJ-ja është armatë e gjithë Jugosllavisë dhe, për këtë arsye, ju nuk mund të shërbeni vetëm në Prishtinë, vazhdimisht kërkoni kthim atje... dhe jeni bërë mjaft monotonë". Ashtu i mllëfosur me mua, më njoftoi me qëndrimin e SFMP, sipas të cilit brenda dy javësh duhej të lajmërohesha në detyrë të shefit të shtabit të MT të Krahinës Socialiste të Kosovës dhe Metohisë<sup>8</sup> dhe se dekreti i kryesisë së Jugosllavisë për emërimin do të pasonte shumë shpejt. Kjo ishte pozitive e gjeneralmajorit. Duke mos besuar në atë që dëgjova, nga gëzimi, e kisha harruar se kishte ashensor dhe nga kati i pestë i ndërtesës fillova të zbrisja këmbë. U ktheva në katedër dhe e

7 Ishte ky një gjeneral i lindur diku afër Prokuples, i cili më vonë, gjatë fillimit të luftës në Slloveni e Kroaci, do t'i kundërvihej regjimit të Millosheviqit:

8 Kështu quhej Kosova pas suprimimit të autonomisë

informova shefin, gjeneralin Radinović. Sa kuptova unë, ai tanimë ishte i informuar. Më dha shtatë ditë afat për ta dorëzuar detyrën dhe për t'u përgatitur për kthim në Prishtinë, për ta marrë detyrën e re.

Ishte ky muaji shkurt i vitit 1990. Ditën kur u lajmërova në shtabin krahinor të MT-së, çuditërisht pashë të ulur kolonelin Bojović, i lindur në fshatin Peran, komuna e Podujevës, i cili më herët kishte shërbyer në garnizonin e Manastirit dhe atë në kohën derisa unë i vijoja studimet në Shkollën e Mbrojtjes Nacionale. Në disa raste, duke më quajtur "zemljak" (vendës) merrte materiale të ndryshme nga unë, kërkonte konsultime, aq më parë që ky ishte student me korrespondencë për afat dyvjeçar. Ai, për çudi, ishte emëruar komandant, ndërsa unë kryeshef dhe njëkohësisht zëvendës i tij, edhe pse me ligjin për mbrojtjen territoriale të Kosovës, komandanti do të duhej të ishte shqiptar. Bashkërisht filluam punën dhe kryesisht kishim marrëdhënie të mira shoqërore, por edhe zyrtare.

Ndërkohë filluan lëvizjet luftarake, së pari në Slloveni e kështu me radhë, aktivitetet luftarake vazhdonin. Në Shtabin e Mbrojtjes Territoriale të Kosovës mbretëronte një atmosferë shumë e keqe, sikurse edhe në Korpusin e 52-të të moto-mekanizuar, sepse ishim të vendosur në të njëjtën ndërtesë<sup>9</sup>. Përafërsisht, pas 7 ditësh të lajmërimit tim në detyrë të re, në një korridor e takova rastësisht kolonel Ratko Mlladiqin,<sup>10</sup> i cili tanimë ishte i informuar se isha emëruar kryeshef i shtabit të MT të Kosovës. Pas përshëndetjes me të, m'u drejtua me këto fjalë: "Si është e mundur, shok Qehaja, që ti të avancohesh vazhdimisht, ndërsa unë të mbetem në pozitën e kolonelit".<sup>11</sup> I thashë se unë nuk mbaja përgjegjësi për avancimin ose mosavancimin e tij. U ndamë pa u përshëndetur, sepse e njihja atë më herët për ngarkesën shumë të theksuar nacionaliste që kishte.

9 Në këtë ndërtesë, pas luftës, do të akomodohej UNMIK-u.

10 Kolonel Mlladiqi, pas katër-pesë muajsh të qëndrimit në Prishtinë, transferohet në detyrë të komandantit të korpusit të Kninit në Kroaci, në pozitën e gjeneralmajorit. Me një shpejtësi marramendëse, më vonë, avancohet në gradën e gjeneralkolonelit dhe merr detyrën e komandantit të Armatës së Sarajevës. Mlladiqi është i akuzuar për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit (përfshirë gjenocidin në Srebrenicë) nga Gjykata Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në Ish-Jugosllavi. Në momentin e shkrimit, gjykimi ndaj tij është ende duke vazhduar.

11 Ishte në detyrë të ndihmëskomandantit të korpusit të 52 të moto-mekanizuar për logjistikë.

## Obstruksionet dhe mënjanimi im nga detyrat zyrtare

Në detyrën tonë të re, mua dhe ish shokun tim Bojoviqin, në zyra të ndara, na shërbente një asistent - nënoficer. Në fillim sikur ishim pajtuar që të punonim në harmoni. Mirëpo, më vonë, gjërat filluan të ndryshonin. Disa nga gjeneralët e shtatmadhorisë së APJ-së, në fillim të muajit qershor 1990, filluan ta vizitonin më shpesh vetëm Bojoviqin, i cili rrallë më ftonte edhe mua. Gjërat ndryshuan në kuptim të urdhëresës sekrete se duhej hequr shumë shqiptarë nga formacionet e ndryshme ushtarake, duke i zëvendësuar ata me serbë. Këtë e hetova nëpërmjet disa oficereve të caktuar që i kryenin këto punë. Si shef i shtabit, kisha të drejtë kontrolli dhe ndërhyja befasisht. Në fakt, e zbuloja çdo tentativë të Bojoviqit për kryerjen e detyrave të marra nga "lart", larg syve të mi. Isha shumë i shqetësuar për këtë, aq më parë që MT e Kosovës kaloi gati krejtësisht në duart e serbëve. Një ditë më ftoi papritmas Bojoviqi dhe më tha në mënyrë "shoqërore": "Që nga dita e sotme nuk duhet të përzihesh në punët e shtabit, sepse për këtë kam urdhëresë të posaçme nga lart". Po ashtu, më "këshilloi" që tani e tutje mund ta lexoja vetëm gazetën "Borba" (gazetë ditore jugosllave)! Reagova ashpër, duke i thënë se ai fare mirë e dinte se unë isha shef i shtabit dhe se pa dijen time nuk duhej të zhvillohej kurrfarë aktiviteti. Ai, sikur u ndal dhe, duke m'u afruar, më tha: "Ramë, kuptoje situatën, kështu po më urdhërojnë".

Vazhdoja të dilja në punë dhe t'i caktoja detyrat sipas dëshirës sime. Në dispozicion e kisha veturën dhe vozitësin. Në fakt, përgatitjet intensive për luftë tanimë kishin filluar. Një ditë, një aradhe e MT ishte ftuar për gjuajtje me armë të këmbësorisë në poligonin (fushën e gjuajtjes) në verilindje të fshatit Kçiq, komuna e Mitrovicës. Pas raportit që më dha një epror rezervë, në këto gjuajtje me pushkë vërejtja shumë parregullsi e mosdisiplinë, që mundësonin plagosjen apo edhe vrasjen e rezervistëve. Urdhërova ndërprerjen e gjuajtjes. U dhashë vërejtjet e nevojshme për mbarëvajtjen e gjuajtjes, por disa eprorë rezervistë që ishin në pozicione të ndryshme në strukturat civile (disa prej të cilëve ishin të dehur) filluan të bërtisnin, madje edhe të më fyenin në baza nacionale. Ata kishin mundësi të më gjuanin, sepse pozita në të cilën gjendeshin ua mundësonte një gjë të tillë. Vozitësi im, i nacionalitetit

shqiptar, ishte mjaft i shqetësuar. Duke parë gjendjen e tensionuar, më luti që të largoheshim. Dëshpërimi im ishte i pakufishëm. Të nesërmen qëllimisht bisedova me Bojoviqin, duke i theksuar të gjeturat, dobësitë dhe rreziqet që i kisha vërejtur gjatë gjuajtjes. Atij nuk i erdhi mirë, sidomos kur i thashë se shumica e rezervistëve e kishin huqur cakun e gjuajtjes.

Pas dy javësh, në rajonin e Suharekës, ishte organizuar një ushtrim fushor me një aradhe të Mbrojtjes Territoriale (MT). Shkova me qëllim që të zbuloja se çka po “zihej” atje. Me të arritur (i paparalajmëruar), një kapiten i nacionalitetit serb, duke mos ditur se isha shqiptar, më raportoi për gjendjen dhe gatishmërinë vepruese të asaj aradhe. Më tha se shqiptarët ishin mënjanuar nga njësitet, se armatimi i një çete ishte deponuar në ndërtesën e fabrikës “Ballkan” e gjëra të tjera. Edhe këtu zbulova gjëra shumë të rëndësishme, që kishin të bënin me organizimin e MT-së në baza nacionale. Armatimi ishte shpërndarë në duart e pjesëtarëve (serbë) të MT nëpër shtëpi, përkatësisht nëpër depo të improvizuara. Në këtë mënyrë, për popullin shqiptar, rreziku sa vinte e shtohet. Për këtë vizitë nuk i raportova Bojoviqit. Ditët kalonin me shpejtësi. Përforcimet e korpusit të Prishtinës, si në armatim ashtu edhe në njerëz shtoheshin në mënyrë rapide.

## **Pensionimi im nga Forcat e Armatosura të Jugosllavisë**

Fillova të mendoja për mënyrën e largimit nga FA të ish-Jugosllavisë. Ishte më se e qartë se duhej të përdorja një strategji dalëse. Largimi i njëanshëm (dezertimi) nga armata ishte tepër i rrezikshëm. Vendosa të kërkoja pensionim të parakohshëm, në nëntor të vitit 1990, edhe pse me moshë relativisht i ri (pa i mbushur të 50-tat) i plotësoja kushtet për një gjë të tillë, pasi që kisha mjaft stazh të beneficuar, sepse kisha punuar gjatë në “trupë” në detyra komanduese. Kur dëgjoji për këtë ish- komandanti i MT-së, gjenerali Muhaxheri (atëherë pensionist), sikur filloi të më qortonte, duke më thënë se nuk duhej të tërhiqesha, se isha i nevojshëm. Kuptohet, ai ishte i shkëputur nga realiteti dhe ende mendonte për ekzistencën e njëfarë Jugosllavie! Nuk e dëgjova këshillën e tij dhe, më 20 dhjetor 1990, e konceptova lutjen për pensionim të parakohshëm. Pas 20 ditësh, më erdhi vendimi për pensionim, me

arsyetimin se pensionimi im do të fillonte më 31 dhjetor 1991. Deri atëherë do të duhej të isha në dispozicion të korpusit të 52-të të moto-mekanizuar të Prishtinës, për “caktim luftarak”, sipas nevojës zyrtare. U largova nga detyra, gati pa u përshëndetur me askënd. Frika ime qëndronte në faktin se mund të më angazhonin në cilësinë rezervistit diku në korpus. Kjo do të ishte gjëja më e keqe që mund të më ndodhte në situatën e krijuar, që quhej luftë.

Viti 1991 ishte viti më i rëndë për mua, jo vetëm për shkak të pensionimit të parakohshëm, pa i mbushur 50 vjet, por edhe nga shkakut se si ushtarak i karrierës e shihja mirë se çka i përgatitej popullit tim.

Sido që të jetë, me tërë qenien time iu përkushtova familjes sime, fëmijëve që shkollin në shkollë nëpër shtëpitë private, sikurse të gjithë fëmijët e tjerë shqiptarë. Në veçanti i mbikëqyrja binjakët, të cilët tani ishin në klasën e parë të shkollës fillore. I kushtoja rëndësi sigurisë së tyre, sidomos deri në hyrje të ndërtesës ku mësonin. Ishte një jetë monotone me plot pasiguri për mua. Duke i ditur mirë metodat e veprimit të organeve të sigurimit ushtarak, isha i vetëdijshëm se më përcillnin gati në çdo hap që bëja. Ndonjëherë mendoja që ta braktisja atdheun, por kur mendoja se jashtë atdheut do të asimiloheshin fëmijët e mi, hiqja dorë nga një mundësi e këtillë. Në anën tjetër, gjithnjë mendoja se si ushtarak që isha do të vinte koha që t’i shërbeja popullit tim. Vitin e Ri 1992 e prita në gjirin familjar, i zhgënjyer dhe i mllëfosur shumë për shkak të situatës së krijuar. Atë natë, banorët e ndërtesës ku banoja (më tepër se 95 për qind e tyre ishin oficerë), po edhe fqinjët e mi të afërt serbë, tërë natën nuk pushuan me të shtëna të ndryshme armësh. Lagjja Ulpiana, ku banoja, u shndërrua në poligon stërvitjeje për të shtëna me armë të të gjitha llojeve. Jeta e njerëzve ishte e rrezikuar nga çdo anë. Nuk dihej se nga cila anë do të qëllonte plumbi më parë.

**PJESA E NJËMBËDHJETË**  
**PERIUDHA PAS PENSIONIMIT**



Më 17 mars 1992, në fshatin Sofali (në shtëpinë e baxhanakut të tij), më pranoi doktor Rugova. E vizitova, pasi që kishte rënë terri, në një fshehtësi të madhe. Ai më priti në mënyrë shumë dinjitoze, ashtu si i kishte hije një burri - një intelektual i shquar. Në atë shtëpi kishte pasur shumë njerëz. U shqetësova për mundësinë e zbulimit të kontaktit tim me kryetarin e LDK-së dhe të Kosovës. Mua, si ushtarak i rangut të lartë, kjo vizitë do të më çonte në burg, ku do të më maltretonin rëndë. Biseda, në katër sy, zgjati jo më shumë se 20 minuta. Me atë rast, derisa i raportoja kryetarit, ai arriti t'i pinte dy kafe dhe të tymoste duhan pandërprerë. E informova për situatën e krijuar në Shtabin e Mbrotjtjes Territoriale të Kosovës, për ndryshimet e bëra në të, për rrezikun që sillte armatosja e serbëve vendës, etj. I fola edhe për strukturën, si dhe për forcat e korpusit të 52-të të Prishtinës. Ai më dëgjoi me vëmendje, por nga kontakti me mua, si dukej, ishte i matur.

Në fund të bisedës, presidentit Rugova ia shpreha gatishmërinë time për ndonjë ndihmë eventuale, në aspektin e angazhimit të një ushtaraku të mirëfilltë. I thashë se, sipas nevojës, isha i gatshëm të angazhohesha në çdo kohë, nëse do të më ftonte ai. Sikur e pranoi në njëfarë mënyre ofertën time, por asgjë konkrete nuk më tha. Më preferoi që, kohë pas kohe, të shkoja në kryesinë e LDK-së dhe aty mund të shiheshim. Kështu mbaroi takimi i parë me doktor Rugovën. Duke u kthyer rrugës për në banesë, sikur më kaploi frika se do të më arrestonin, por një gjë e tillë nuk ndodhi. Duke pushuar në banesë, fillova ta analizoja efektin që pati vizita ime tek Presidenti. Prisja që, me një grup prej tre-katër ekspertësh shumë të besueshëm, të më urdhëronte të filloja përgatitjet për rezistencë të mëvonshme të armatosur. Kjo nuk ndodhi. E kuptova se edhe ai ishte shumë i kujdesshëm kur bëhej fjalë për luftë të armatosur, për shkak të raportit ekzistues të forcave. Edhe unë isha i vetëdijshëm për atë raport forcash, po megjithatë mendoja se ishte i nevojshëm dhe i domosdoshëm së paku ndonjë plan sekret taktik-operativ. Ai plan duhej të përgatitej mirë dhe të hynte në funksion në kohën e përshtatshme.

Ndërkohë, lëvizjet luftarake serbe filluan në Kroaci. Situata e sigurisë dita-ditës vështirësohej. Isha i vetëdijshëm se lufta në Kosovë ishte e pashmangshme. Si ushtarak që isha, nuk më dukej e arsyeshme që të rrija pasiv, por, megjithatë, përgatitjeve për një rezistencë aktive (për

luftë) duhej t'i paraprinin qëndrimet politike të krerëve shtetërorë dhe se ato në fakt mungonin. E kontaktova, në banesën e tij në Prishtinë, Hydajet Hysenin. Aty ishte prezent edhe Mehmet Hajrizi. Përveç një rezymeje të situatës së krijuar në këtë takim nuk pati asgjë konkrete. Diç më vonë do të takohem edhe me zotin Pajazit Nushi, i cili nuk pati mundësi të më udhëzojë se si t'ia bëja unë si ushtarak i karrierës.

## Takimi me Hajzer Hajzerajn

Nuk kaluan as 10 ditë pas takimit tim me dr. Rugovën, në banesën time u shfaq Hajzer Hajzeri.<sup>12</sup> Pasi që bashkëshortja ime na ofroi kafe, ajo u largua në një dhomë tjetër, ndërsa Hajzeri filloi të më prezantohej si Ministër i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës. E luta që ta ndërpriste bisedën derisa t'ia lëshoja zërin më të lartë televizorit (që të mos kishte mundësi të incizohej biseda jonë). Ai sikur u habit nga kujdesi që unë tregova. Më njoftoi me “përgatitjet” që kishte bërë me një grup jo të vogël njerëzish. Më shpjegoi se ku dhe sa mbledhje i kishin mbajtur, sa togje dhe sa çeta kinse i kishin formuar, por të gjitha këto vetëm në letra. Regjistrat i kishin formuar duke i marrë opinionet e qytetarëve, qoftë edhe nëpër banesa ku kishin banuar ish-pjesëtarët e APJ-së të nacionalitetit shqiptar. Më foli për njësitet e formuara dhe për strukturën e tyre.

E dëgjova me vëmendje derisa foli për aktivitetin e zhvilluar. Si ushtarak profesional, që në fillim e hetova se ky grup (i Hajzerit) kishte bërë gabime trashanike në aspektin e sigurimit të konfidencialitetit të këtyre përgatitjeve. I fola hapur për të gjitha gabimet e bëra dhe ia tërhoqa vërejtjen për mundësinë e zbulimit të tyre nga UDB-ja. Ai sikur nuk donte ta kuptonte këtë fakt. Me atë rast më ofroi detyrën e shefit të përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Kosovës. Një ofertë të atillë e refuzova kategorikisht, aq më parë kur e kisha parasysh se para 10 ditësh kisha qenë tek presidenti Rugova dhe ai nuk më kishte thënë asgjë lidhur me këtë, ndërsa Hajzeri paraqitej në cilësinë e Ministrit të Mbrojtjes! Atë natë bëra fare pak gjumë.

12 Kishte studiuar në Fakultetin e Mbrojtjes në Beograd dhe ligjëronte lëndën MPP dhe VMSH në disa fakultete të UP-së. Ishte edhe oficer në rezervë dhe, një herë në vit, ftohej si komandant i një batalioni rezervë.

Pas 7-8 ditësh, para Fakultetit Filozofik, u organizua një protestë e madhe kundër mbylljes së shkollave dhe fakulteteve në gjuhën shqipe. Dola edhe unë. Takova shumë njerëz të njohur e të panjohur, profesorë, akademikë, mësues, arsimtarë etj. Papritmas, sikur m'u vizatua para sysh Hajzer Hajzeri, i cili më përshëndeti me nguti dhe më njoftoi se sërish, pas mbarimit të protestës, do të vinte tek unë në banesë. Ia bëra me dije se ne e kishim përfunduar bisedën dhe nuk kishte çka të kërkonte tek unë. Ai edhe më tej insistonte të vinte. U ndamë. Pas një ore erdhi në derë. Pasi që u vërtetova se ishte ai, nuk i hapa derën. Me kaq mbaroi tentimi i përafrimit tonë për një detyrë shumë të rëndësishme. Isha i vetëdijshëm se, po të takohesha edhe njëherë të vetme me z. Hajzer, unë do të viheshja në shënjestër për arrestim, pa dhënë kurrfarë kontributi konkretisht. Pas refuzimit tim, si shef i shtabit të përgjithshëm të FARK-ut ishte angazhuar zoti Zaim Berisha. Më vonë pasuan burgosjet, gjykimet, nxjerrja e fakteve nga incizimet e bëra në sallat e mbajtjes së mbledhjeve etj., dhe gjykimet me dënime, përkatësisht burgosje të një grupi mjaft të madh njerëzish. Këtë fakt televizioni i Beogradit e dha për opinion për disa ditë rresht. Pasi që kisha kontaktuar me Hajzerin, prisja që edhe mua të më arrestonin. Kaluan disa ditë në pritje të arrestimit tim, por një gjë e tillë nuk ndodhi. Në fakt, z. Hajzeri, gjatë marrjes në pyetje nga organet e hetuesisë, si duket nuk e kishte paraqitur takimin me mua.

Ditët kalonin. Situata e sigurisë bëhej edhe më e padurueshme. Nuk dija çka të bëja. Nuk dija me çka të merresha. Shkrimet dhe analizat për çështje të sigurisë, më shkonin për dore, por organet e sigurimit më përcillnin në çdo hap. Fillova të bëja një lloj ndërmjetësimi për shitblerjen e mallrave të ndryshme, por kjo nuk më shkonte për dore. Posa dilja në qytet, shumë qytetarë e në veçanti intelektualët, më ndalnin dhe më pyesnin se çka duhej të bënin në këtë situatë. Njëri ndër ta, një ditë filloi të më "shpjegonte" se si ne shqiptarët ishim në gjendje të mobilizonim me qindra e mijëra ushtarë e gjëra të tjera! I thashë se ai nuk i dinte këto gjëra. Disa qindra-mijëra njerëz nuk do të mund t'i mobilizonte edhe ndonjë shtet shumë më i fuqishëm se yni, por, edhe sikur t'i mobilizonim, p.sh 10 mijë njerëz, çka do të mund të bënim me ata pa armatim. Duke ia shpjeguar atij fuqinë ushtarake të Serbisë, ai për një çast më quajti edhe defetist. Kështu flisnin disa intelektualë të rrejshëm që ishin sikur ky që e apostrofova. Pas këtij rasti, fillova që t'i shmangesha takimeve me njerëz, jashtë atyre të familjes sime.

## Rreziqet për burgosje të mundshme

Në fillim të muajit qershor të vitit 1992, derisa isha duke pastruar garazhin tim, më kishte thirrur në telefon gjenerali Bojoviq. Pasi që bashkëshortja ime i kishte thënë se gjendesha në garazh, ai kishte thënë se do të më thërriste pas gjysmë ore. Ashtu e shqetësuar, bashkëshortja më informoi për këtë thirrje të papritur. Më shkoi mendja se do të më caktonin diku në ndonjë detyrë të rezervistit. Pas pak kohe, u dëgjua cingërima e telefonit. U lajmërova. Ishte Bojoviqi. Më pyeti për shëndetin tim dhe familjes sime dhe sikur më tha se pse nuk iu kisha lajmëruar atij si “shoku-shokut”. Në vazhdim më tha se, sipas urdhrat të komandantit të armatës, një numër i caktuar pensionistësh, eprorësh të lartë shqiptarë, duhej të lajmëroheshin në komandën e korpusit të 52-të, në sallën e vogël, pasnesër, në orën 10:00. I thashë se nuk isha i obliguar që të lajmërohesha, sepse isha i pensionuar dhe se, pikërisht atë ditë, kisha disa obligime familjare. Në mënyrë të prerë, ai më tha: “Ramë, ti e din çka është urdhëresa e komandantit të Armatës...” dhe shumë shpejt ma mbylli telefonin. Fillova të mendoja dhe ta analizoja ftesën e bërë. E thirra me telefon një epror të lartë ushtarak që ishte pensionuar më herët. Ai më shpjegoi se e kishin ftuar Fadil Quranollin, Ali Muhaxherin, mua, dhe dy eprorë të tjerë. Kur e pyeta se a do të shkonte ai, përgjigjja ishte pozitive. Duke i analizuar gjërat, mendja më shkoi te salla ku do të mbahej takimi. E dija se kjo sallë përgjohej nga organet e sigurimit. Këtë informatë e kisha marrë derisa ish-kryeshefi i SHMTK. Vendosa të mos shkoja në atë takim. Në orët e vona të asaj dite, personi që më kishte informuar se kush ishte i ftuar, më pyeti se a do të shkoja në atë takim. Shkurt e qartë i thashë se nuk do të shkoja. Ai më tha se do të shkonte më tepër nga kureshtja.

Në kohën e caktuar për takim, unë nuk shkova, por gjithnjë mendoja se do të vinin të më merrnin me dhunë. Mendoja se si do ta arsyetoja mungesën time. Sipas fjalëve të njërit nga eprorët, pjesëmarrës në këtë takim, para fillimit të takimit, ishin caktuar ulëset se kush ku do të ulej. Ulësja e caktuar për mua, gjatë tërë kohës së takimit, kishte mbetur e zbrazët. Gjenerali Bojoviq, që në fillim të takimit, e kishte informuar zëvendëskomandantin e armatës se unë, edhe gjatë bisedës telefonike me të, kisha deklaruar se nuk do të shkoja në atë takim. Zëvendëskomandanti i armatës kishte deklaruar se nuk mund të

besonte se si një pensionist ushtarak mund të mos i përgjigjet ftesës së tij. Kishte thënë se do të bisedonte më vonë me mua.

Në këtë takim ishte biseduar për nevojën e angazhimit të ish eprorëve të lartë ushtarakë shqiptarë në armatë, lidhur me përgjigjen e thirrjeve të të rinjve shqiptarë për mobilizim në Forcat e Armatosura të Jugosllavisë, si dhe lidhur me vijimin e mësimit të fëmijëve shqiptarë në shtëpitë-shkolla, apo në shkollat paralele, siç i quanin ata. Përveç këtij personi, nga i cili i mora këto informata, që i paska kundërshtuar këto që u thanë më lart, të tjerët që ishin prezentë nuk kishin kundërshtuar fare.

Si e kuptova pak më vonë, qëllimi kryesor i këtij takimi kishte qenë incizimi i zërit tim dhe filmimi për pjesëmarrjen time në këtë takim, duke i montuar gjërat për interesat e tyre, kinse unë i ftoja shqiptarët në luftë kundër serbëve, etj. Të gjitha këto do të montoheshin në stilin e montimit që ia bënë gjeneralit kroat, Janko Bobetko, kur thoshte: "Armikun serb duhet qëlluar me plumb vetëm në stomak etj."<sup>13</sup>

Pas kësaj situatë kaotike, ndaj meje në fakt, nuk u ndërmor asgjë, ngase ngjarjet vijuese i përkisnin çështjeve luftarake, me të cilat duhej të merreshin prokuroritë e atëhershme të qarqeve ushtarake. Angazhimi i këtyre personave në luftërat që zhvilloheshin në Kroaci dhe në Bosnjë e Hercegovinë, sikur e nxori në plan të dytë edhe ndjekjen time.

Në ndërkohë, për shkak të disa problemeve shëndetësore, bashkëshortja ime dëshironte të bënte një vizitë në spitalin ushtarak të Shkupit. Për të rënë në kontakt me mjekun që e kishte vizituar edhe më parë bashkëshorten time dhe për ta caktuar terminin e vizitës mjekësore, e kisha angazhuar me telefon ish-kolegun tim nga Akademia Ushtarake, Zehedin Tushin, gjeneralmajor në armatën maqedonase. Mirëpo, në orët e vona të po kësaj dite, papritmas në derë trokiti njëri prej baxhanakëve të mi. U pa se ishte shumë i shqetësuar. Sapo hyri në banesë, na pyeti se kur do të udhëtonim për Shkup. Me habi e pyeta

---

13 Se qëllim i këtij takimi isha unë, ma vërtetoi edhe dëshmia e një ish oficeri shqiptar të sigurimit ushtarak, me detyrë në Korpusin e 52-të të Prishtinës. Ky më vonë iu bashkëngjiti UÇK-së, u rekrutua në TMK. Ai deshi të rrëfëhet vetë dhe gjatë bisedës që pata me të, ai disa herë më tha: "Të lumtë për vlerësimin që i bëre situatës... Bëre mirë që nuk more pjesë në këtë takim".

se nga e kishte marrë ai këtë informatë. Në fakt, një kapiten shqiptar, që atëherë punonte në organin e sigurimit ushtarak dhe përkthente përgjimet e telefonave nga gjuha shqipe në atë serbe dhe anasjelltas, kishte kuptuar se të nesërmen, kur do ta kaloja kufirin në pikën kufitare të Hanit të Elezit, mua do të më arrestonin, prandaj kishte përcjellë porosinë nëpërmjet baxhanakut tim që të mos udhëtoja atë ditë. E kuptova se çështja ishte shumë serioze, prandaj e thirra nga një telefon tjetër z.Tushi dhe e njoftova se nuk do të mund të udhëtoja të nesërmen për Shkup për disa shkaqe objektive. Organet e sigurimit ushtarak të korpusit të Prishtinës kishin planifikuar që në momentin e arritjes sime në kufi, të më bastisin dhe gjatë kësaj bastisje të fusnin në bagazh të veturës material komprometues dhe kështu të më burgosin.<sup>14</sup> Falë këtij kapiteni, i shpëtova burgosjes së sigurt nga organet e shërbimit të sigurimit ushtarak. Nga kjo që u tha më lart, kuptova se unë si njëri ndër eprorët më të lartë ushtarak shqiptarë, nga organet e sigurimit ushtarak isha i cilësuar si i rrezikshëm dhe për këtë arsye me çdo kusht duhej të më neutralizonin.

---

14 Këtë fakt, ky epror shqiptar ma shpjegoi derisa ishte pjesëtar i UÇK-së, përkatësisht i TMK-së. Këtë e kishte bërë ngase, siç theksonte ai, kishte simpati për **mua** si një epror i lartë ushtarak shqiptar.



**PJESA E DYMËDHJETË**  
**ANGAZHIMI NË BIZNES PRIVAT**



Në fund të vitit 1993 i bëra të gjitha përgatitjet për fillimin e punës së një organizate punuese tregtare si NTP “Binjakët”, së bashku me dhëndrin tim Ylberin. Këtë pagëzim e bëra sipas djemve të mi binjakë. Më mbeti të kërkoja dhe të gjeja vetëm hapësirën për punë. Vendosa që këtë hapësirë të kërkoja në ndërmarrjen shoqërore Qendra e Rinisë dhe Sporteve “Boro e Ramizi”. Arrita të gjejë një ish student timin i punësuar në këtë organizatë - ish drejtori i atëhershëm Vujovic. Më pranoi mirë, aq më parë që ai dikur kishte qenë në rolin e një rezervisti në një njësi që unë e komandoja. Kur ia parashtrova kërkesën që në bodrum të qendrës të më ndajë një hapësirë prej afro 100 m<sup>2</sup> për të formësuar një magazinë për shitje të artikujve ushqimorë me shumicë, ai sikur tregoi habi duke më thënë se: “A është e mundur shok komandant që ti të merresh me biznes”. Përgjigja ime ishte se kjo është e vetmja mundësi që të tentoj të punoj dhe të mbaj familjen. Ai sikur i kërkoj Bujar Komonit (ish-student i imi) që të ma gjejë një hapësirë të përshtatshme, e mandej të bëjmë kontratën për qiradhënie.

Kështu, në fillim të marsit 1994 fillova të merrem me një punë të cilën as që e kisha ëndërruar, aq më parë që me tregti askush nga familja ime nuk ishte marrë më herët. Qëllimin e kisha në fakt që të siguroja mjete financiare për mbajtjen e familjes, por edhe organet e sigurimit ushtarak, që me vazhdimësi më përcillnin, të binden se unë vërtet jam duke u marrë me biznes. Mirëpo, kjo punë nuk doli të jetë aq edhe e lehtë për mua. Në fillim me një e më vonë me dy punëtorë ia fillova punës, duke më ndihmuar miku im Ramiz Mavriqi (vëllai i gruas), i cili më siguroi një sasi të mallit që për një afat kohor deri në dy muaj ta bëja pagesën. Kuptohet se këtë pagesë do ta bëja nëse do të ketë shitje përkatësisht nëse krijohet ndonjë fitim. Pra, me vetëdije hyra në obligime financiare. Në ditët e para të punës, nuk pati ndonjë lëvizje shumë të madhe, por kur më shihnin njerëzit në bodrum dhe para hyrjes në pjesën “time” të depos sikur hutoheshin, sepse ishin mësuar të më shihnin në uniformë apo në universitet duke ligjëruar. Nga kureshtja por edhe ndonjëherë nga dëshira që të më ndihmojnë, një numër i tregtarëve blenë mall nga ndërmarrja ime dhe në të shumtën e rasteve sillëshin me korrektësi ndaj pagesave edhe pse pati të tillë që mjetet financiare i vononin dhe më detyronin t’i thërras duke ua përkujtuar që të kryejnë obligimet. Pasi nuk kisha kapital të mjaftueshëm, u detyrova të kërkoja mall edhe nga ndërmarrjet e tjera që vepronin në afërsi me

depon të cilën e kisha formuar. Ata më mundësonin marrjen e mallit me pritje dhe me një fitim minimal për mua, duke e ditur se unë do t'i përmbahem obligimeve. Një lëvizje e lehtë pozitive u vërejt dhe iu nënshtrua ligjeve të tregtisë duke u detyruar që t'i mësoj shumë gjëra nga kjo lëmi, që nuk i kisha ditur më parë.

Ndërkohë, edhe pse shenjat e sëmundjes së rëndë të babait tim u vërejtën më herët, në fund të prillit 1994, atij filloi t'i përkeqësohej gjendja shëndetësore. Një ditë vëllai im Lutfiu e solli babanë me veturë para depos ku punoja për të vazhduar së bashku për një kontroll rutinor tek mjeku i sëmundjeve të mushkërive. Kur ai e pa se ku jam duke punuar, më pyeti paksa edhe i habitur duke më thënë: "Biri im, po ti a këtu po punoje, në këtë bodrum a"? Me këtë rast i shkuan lotët duke komentuar: "Ku ke qenë e ku paske ardhur"! Përgjigja ime ishte se po punoja për ekzistencë sikur shumica e popullit tim. Nuk shkoi shumë kohe dhe më 16 maj 1994, nga kanceri në mushkëri në moshën 80 vjeçare këtu në Prishtinë, vdiq babai im Bahtiar Shaban Qehaja, i lindur më 1914 në fshatin Kranidell, komuna e Kamenicës. Atë ditë në varrimin e babait u mblodhën shumë njerëz të fafesisit, por edhe disa shokë e miq të mi. Në ceremoninë e varrimit mori pjesë edhe kryeimami i Kosovës, efendi Sabri Bajgora (i cili kishte qenë ushtar i imi në garnizonin e Zajëçarit dhe për një kohë ka qenë edhe vozitësi im ushtarak) me tre-katër hoxhallarë të tjerë. Kështu babai im vdiq, përkundër dhimbjeve të mëdha nga sëmundja që e kaploi, por edhe me dhimbje të madhe se çka ishte duke i ndodhur popullit shqiptar por edhe familjes së tij.

Pas të pamës 7 ditore vazhdova punën në tregti me shumicë. Përkundër problemeve puna disi ecte. Nuk kishte ndonjë fitim të madh, por për një jetë normale familjare. Kuptohet se pati edhe probleme të tjera e që i përkisnin dënimeve nga inspeksioni i regjimit të dhunshëm serb dhe atë për gjëra shumë banale. Kjo ishte një formë sistematike e presionit edhe për ato pak biznese që ekzistonin atëbotë në Kosovë.<sup>15</sup> Puna ime

---

<sup>15</sup> Për shembull, pasi që unë nuk figuroja që jam pronar i firmës, një ditë gjatë inspektimit dy inspektore serbe kur kishin vërejtur karrigen dhe një tavolinë të zbrazët dhe pasi e marrin përgjigjen (e paqëllimshme) se unë në atë tavolinë punoj, edhe pse nuk figuroja si zyrtar, pasoi një dënim jo edhe i vogël nga gjykata serbe për kundërvajtje.

e mëtejme konsistonte me faktin se gati për çdo ditë me një makinë të tipit “Llada” isha i detyruar të furnizoja me gjëra ushqimore një shitore që i përkiste organizatës sonë tregtare.

Nga gjysma e dytë e vitit 1996 situata e politike dhe e sigurisë në Kosovë sa vinte e përkeqësohej. Lëvizjet e forcave ushtarake dhe policore serbe ishin në vazhdimësi prezente, qoftë për krijimin e frikës tek popullata, qoftë edhe për pozicionimet e ndryshme. Pas daljes publike të ekzistimit të forcave të UÇK-së dhe vrasjes së mësuesit Halit Geci tani më ishte krejtësisht e qarte se lufta e armatosur në mes të UÇK-së dhe ushtrisë serbe ishte e pashmangshme. Filluan luftimet e njësiteve të ndryshme të ushtrisë serbe sidomos në rajonin e Drenicës e gjetiu. Në fakt njësitet e Korpusit të Prishtinës, tanimë të përforcuar të 52-të të moto-mekanizuar filluan të përdorin një taktikë në kundërshtim të thellë me konventën ndërkombëtare e cila parashih që lufta të zhvillohej vetëm kundër forcave të armatosura të kundërshtarit e jo kundër popullatës civile. Ishte kjo taktika “e tokës së djegur” duke vrarë gra, fëmijë e pleq të paarmatosur. Përveç të tjerash nuk munguan as masakrat e tmerrshme me të cilat u ballafaqua populli shqiptar, vetëm e vetëm që në këtë mënyrë UÇK-ja të dobësohej dhe mos të ketë bazë prej nga duhet të rekrutohen pjesëtarët e saj por edhe të bëjnë furnizim me gjëra ushqimore, veshmbathje dhe armatim.

Njëkohësisht, në gjysmën e parë të vitit 1998 lëvizjet e popullatës shqiptare sidomos nga Drenica, për në rajonet e tjera të Kosovës sikur u bënë dukuri e rëndomtë. Në fakt, diç më vonë filloi spastrimi etnik masiv i Kosovës. Njerëzit tentonin që në mënyra të ndryshme të braktisin Kosovën. Në këtë situatë të merresh me tregti nuk është edhe gjë e lehtë. Unë paksa u tërhoqa nga disa detyra që i kisha si të rëndomta. Dita-ditës filloi rënia e shitjes së mallit ushqimor.

Vazhdimisht isha në mendime se si të kyçem në luftë, aq më parë që një ushtarak si unë të mos kontribuojë ishte jo edhe një veprim i qëlluar. Bëja vlerësime të ndryshme në bazë të lajmeve që vinin nga terreni e që konsistonin në faktin se disa oficerë aktivë nga ish APJ nuk ishin pritur mirë në UÇK për shkaqe të ndryshme. Disa nga ta, p.sh, iu kishin ekspozuar maltretimeve në formë të kërkesave për mihjen e transheve dhe pozicioneve statike deri edhe te ofendimet. Me fjalë të tjera, kishte

indikacione se ish-eprorët e rregullt nuk u pritën mirë në një pjesë të njësiteve të UÇK-së e që për mua ishte shqetësuese. Në një formë, kjo reflektonte një mungesë të vullnetit për përgatitjen e luftës në mënyrë sa më profesionale.

Në ndërkohë, flitej se në bisedat që do të zhvilloheshin në Rambouillet të Francës, unë nga zyra e doktor Rugovës do të angazhohesha si këshilltar ushtarak. Mirëpo, siç do të shihet më vonë, kjo nuk do të ndodhë. Para nisjes për në Rambouillet, në një takim të rastësishëm me prof. Fehmi Aganin, i ndjeri do të më shprehte keqardhjen pse unë nuk jam përfshirë në ato bisedime, por, siç theksoi ai, dikush ndikoi në doktor Rugovën që unë të mos udhëtojë atje.

Gjatë bisedave në Rambouillet mua do të më ftojë në selinë e LDK-së z. Ilaz Kurteshi që së bashku me të dhe Agim Krasniqin të shqyrtojmë dokumentacionin që ka të bëjë me sigurinë e që do të na dërgohet me faks nga selia e bisedimeve. I mbajtëm 3-4 takime me ç'rast i shqyrtuam disa çështje por ato shqyrtime sikur askush nuk i mori për bazë.

Në fillim të shtatorit 1998, tek unë në depo erdhi një person i cili u prezantua si ushtar i UÇK-së në një zonë të UÇK-së. U ulëm në një zyrë me ç'rast filloi të më njoftojë se do të isha i mirëseardhur tek ata, duke theksuar se propozimi i tyre ishte që unë të transportohesha gati çdo ditë, siç theksonte ai, me një veturë të tipit "Mercedes". Të udhëtoja çdo ditë në gjithë atë rrezikshmëri evidente nuk ishte propozim i mençur. Në anën tjetër, personat që ai përmendi si udhëheqës të UÇK-së unë nuk i njihja. Kuptohet se kisha hezitime. Vazhdimisht mendoja për këtë situatë. Dilemat ishin të mëdha, aq më parë se vlerësova se ndonjë kontribut edhe po të shkoja nuk mund të jepja ashtu siç mendoja unë. Në fakt ata, duke ditur respektin që e gëzoja në popull, më ofruan rolin e një oficeri për informim në këtë zonë të UÇK-së dhe në vazhdimësi të prononcohem për media. Por nuk e kuptova mënyrën se si do të angazhohesha në ato rrethana. Paraqitja në media dhe transportimi im prej Prishtinës në këtë zonë përbënte një rrezik ta pashmangshëm për mua dhe familjen time si dhe në aspektin operativ ishte jo i logjikshëm.

Në ndërkohë i bëra disa shkrime në të përditshmen "Bujku" sepse gazeta Rilindja u ndalua nga udhëheqja e dhunshme serbe. Në një

shkrim që e bëra ashtu i mllëfosur për shkak të një masakre që e bënë forcat serbe në një fshat të Drenicës ndaj familjes Deliaj, gazetarët të cilët ishin në redaksi sikur m'u lutën që mos të shkruaj emrin tim por shkrimi të jetë si shkrim i redaksisë. E kuptova se vërejtja ishte shumë miqësore vetëm e vetëm që të shpëtoj nga burgosja. Në fakt nuk kishte as një shkrim të vetëm dhe kontribut publicistik e profesional në sferën e sigurisë përveç shkrimeve që unë i bëja. Ndërsa nevoja për informimin e qytetarëve lidhur me taktikat dhe veprimet e makinerisë serbe ishte shumë e madhe. Pata edhe disa shkrime në gazetën javore "Zëri". Në një shkrim që e botova në të përditshmen "Bujku" vendosa nënshkrimin tim. Në ndërkohë një qytetar malazet i punësuar në UDB, të nesërmen i drejtohet një dhëndrit tim me këto fjalë: "Po shkruan baballaku i yt. Ne mendonim se ai po merret vetëm me tregti"! Ky ishte sinjali që unë duhet të jem shumë i kujdesshëm, ngase tashmë ishin rikthyer survejimet ndaj meje dhe veprimtarisë sime.

Fillimi i bombardimeve të NATO-s më gjeti në banesë të një vëllait tim këtu në Prishtinë i cili disa muaj më parë e kishte blerë atë banesë dhe pakkush dinte për të. E vlerësova se qëndrimi im në banesën time ishte i rrezikshëm. Hedhjen e bombës së parë nga avionët e NATO-s në kazermën ushtarake të Prishtinës më 24 mars 1999 e pashë me sytë e mi dhe e kuptova se tanimë situata ushtarake-politike dhe raporti i forcave, (pasi NATO-ja na përkrahte) do të ndryshojë në favorin tonë.

Në Prishtinë mbeta deri më 2 prill, kur disa i kamufluar u futa në një kolonë refugjatësh dhe pas dy orë udhëtimi u gjenda 4 km larg pikës kufitare me Maqedoninë, tek fshati Jazhicë. Kolona u ndal dhe u kuptua se qeveria maqedonase nuk dha leje që shqiptarët të depërtonin në territorin e tyre. Pasi që konstatova nëpërmjet disa njerëzve se në dy punkte të kontrollit ushtarak deri në kufi, nuk ka oficerë të moshuar që do të më identifikonin dhe se aty qëndronin disa oficerë të rinj me grada të ulëta, vendosa që me një djalë të ri shqiptar, i cili e fliste rrjedhshëm gjuhën serbe, ta braktisi kolonën dhe të eci këmbë duke u mbështetur kohë pas kohe në një shkop dhe të simuloja se jam duke shqepuar. Kështu, pas dy orë ecjeje, arrita në zonën neutrale të kufirit. Aty vërejtja shumë njerëz duke lëvizur poshtë-lart dhe duke tentuar që ta kalojnë kufirin. Pashë edhe njerëz të dyshimtë që ishin në gjendje të spiunojnë tek organet e sigurimit serb vetëm e vetëm që të depërtojnë

për vete. Rreziku për mua që të qëndroj edhe me tej aty ishte shumë e madhe. Po ashtu, vërejtja shumë intelektualë që kishin mbetur aty me ditë të tëra.

Arrita që nëpërmjet një mjeku shqiptar nga Tetova që ai ta organizojë transportin tim si të “sëmure” dhe të kaloja në anën maqedonase në një tendë të madhe me shenjën e Kryqit të Kuq. Aty më vërejtjti edhe një mjek i cili kishte qenë ushtari im në garnizonin e Zajçarit. Disi sikur erdha në vete dhe pas një pushimi prej gjysmë ore disa aktivistë organizuan transportin tim deri në fshatin Bogovinë të Tetovës ku po qëndronte familja ime.

Pas qëndrimit tim 4-5 ditë në fshatin Bogovinë vendosa që të udhëtoja për Tiranë. Iu ofrova për ndihmë kryetarit të atëhershëm të PDSH-së z. Arbër Xhaferri, i cili pa hezitim më siguroi makinën dhe një përcjellës deri në Tiranë. Pas shumë peripecive që përjetova rrugës për Tiranë, vetëm falë gjindshmërisë së vozitësit dhe përcjellësit, u bë e mundur arritja ime në qendër të Tiranës. U vendosa në një banesë, e më vonë në një shtëpi.

Vërejtja një tollovi të paparë rrugëve të Tiranës. Kishte shumë qytetarë nga Kosova. Pasi ishte shpallur mobilizimi e në pamundësi që të organizohej ashtu siç duhej pranimi i të rinjve nga Perëndimi dhe sistemimi i tyre sipas rregulloreve në njësi luftarake, kishte shumë lëvizje, huti, frikë, pyetje se ku të shkohet etj.

Atje u takova me Jakup Krasniqin, Bilall Sherifin, Xhavit Halitin, Shaip Mujën, Lulzim Bakallin etj. Diç më vonë do të takohem edhe me Bajram Kosumin, Hydajet Hysenin, Mehmet Hajrizin, Azem Sylën, Bardhyl Mahmutin, Bislim Zyrapin. Ajo që më ra në sy ishte fakti që nuk pati ndonjë kërkesë nga askush që unë si ekspert ushtarak të kontribuoj në çështjet luftarake. Vlerësova se në atë situatë çdo insistim i imi për kycje më të thuktë për organizimin e luftës, qoftë nëpër Shqipëri, qoftë në territor të Kosovës, do të ishte i pavend dhe me keqkuptime të mundshme. Kuptohet se respekti ndaj meje gati nga të gjithë të pranishmit nuk mungoi, por ndonjë angazhim konkret, siç thashë, nuk m'u ofrua.

Në Tiranë qëndrova dy muaj. Pas ndërhyrjes se forcave të NATO-s në krye me gjeneralin anglez Jackson (Xhekson) situata në Kosovë filloi të ndryshojë rrënjësisht. Qytetarët filluan të kthehen masivisht. Qeveria e Përkohshme e Kosovës nga Tirana u transferua në Prishtinë. Ministria e Mbrojtjes nën udhëheqjen e Azem Sylës dhe Fatmir Limajt fillimisht ishte e vendosur në hapësirat e servisit të automjeteve atëherë të quajtur “Bosko Cakic” (tani hotel Victory) në Prishtinë.

Më ftuan që të jap kontributin tim. Së bashku me Bislim Zyrapi dhe kolonel Spiro Butkën nga Shqipëria dhe disa persona të tjerë filluam të bëjmë strukturën e Ministrisë së Mbrojtjes, por edhe, siç theksonin, të bëjmë strukturën e Ushtrisë së Ardhshme të Kosovës. Iu gëzova mundësisë për dhënien e kontributit tashmë pas një kohë jo të shkurtër. Pas disa ditësh filluan presionet ndërkombëtare për demobilizimin e UÇK-së, dorëzimin e armatimit etj. Kishte rezistencë në këtë drejtim dhe, sipas mendimit tim, me të drejtë, sepse pas tërë asaj çfarë ndodhi, të shpërbësh UÇK-në pa një trashëgimtare të saj ishte hap jo i qëlluar dhe i rrezikshëm. Filluan bisedimet për formimin e një trupe të re, e cila nuk kishte elemente ushtarake, por do të figuronte si një forcë civile.

Dikush propozoi që unë të shoqëroja Agim Çekun në takimet fillestare me gjeneralin Xhekson, komandantin e parë të KFOR-it. Më kujtohet se në takimin e parë me të dhe stafin e tij na i ofruan disa fotografi se si do të dukeshin pjesëtarët e njëfarë force që edhe ata vetë nuk e dinin formatin dhe misionin e saj. Në ato foto u vërejtën njerëz në kombinezone të punëtorëve e diç të ngjashme. Ishte paksa e çuditshme kjo situatë. Shprehëm habinë me këtë qëndrim të komandantit të KFOR-it dhe ndihmësit të tij ndaj forcës së ardhshme.

Në takimet vijuese kërkesat tona do të jenë më të qëndrueshme përkatësisht kërkesa shumë e prerë ishte që uniforma të jetë më e përafërt me atë ushtarake. Në takimet e mëvonshme, unë nuk do të ftohëm. Sidoqoftë pas pak u arrit marrëveshja e quajtur Thaçi-Xhekson për formimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës me detyrat dhe misionin tanimë të njohur.

## Inkuadrimi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës

Pas demilitarizimit të UÇK-së, në fillim të nëntorit 1999 nisi procesi i formësimit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Krahas kësaj ishte filloi aksioni i dorëzimit të armatimit dhe veprime të tjera të cilat do të pasonin në vazhdimësi. Një ditë papritmas do të më ftonte Z. Agim Çeku që unë të themeloja Akademinë e Mbrojtjes së TMK-së. Në bisedën e parë isha pak i habitur me propozimin, aq më parë që Çeku, shumë më i ri se unë, nuk kishte njohuri për mua, por si duket dikush e kishte lakuar emrin tim. Në takimin e dytë dhashë pëlqimin që unë të emërohem komandant i Akademisë. Kështu në fakt filloi epoka e kontributit tim konkret në çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë të Kosovës. U mbajtën disa takime me komandantët e zonave luftarake të UÇK-së të cilët kryesisht do të udhëheqnin edhe në TMK. Kishte mjaft paqartësi, probleme, por edhe vështirësi në formësim të TMK-së. Detyra ime ishte që të kujdesem për gjetjen e hapësirës për akomodimin e pjesëtarëve të Akademisë. Këtë detyrë duhej ta kryeja më së largu për dy muaj, pra ky ishte afati dhe do të duhej të raportoja për të arriturat. Veturë zyrtare nuk posedoja. Shfrytëzoja një veturë private të tipit “Zastava 750”. U orientova në ndërtesën e Fakultetit Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP). Rektori i atëhershëm Zenel Kelmendi, i cili me stafin e rektoratit ishte i vendosur në një shtëpi në lagjen Velania, më pranoi në mënyrë korrekte dhe dëgjoi propozimin tim. Pas disa konsultimeve që ai duhej t’i bënte me dekanët e në veçanti me dekanin e Fakultetit Teknik, vendosën që të më ofrojnë hapësirën në objektin e Fakultetit Teknik. Pas dy-tre ditësh në fakt Rektori më dha lejen (në formë të shkruar) që mund të disponoj me pjesën më të madhe të ndërtesës së ndarë ku ishin të vendosura disa kabinete. Nuk mungoi edhe ndihmesa me inventar shkollor e që ishte shumë e nevojshme për fillimin e punës së Akademisë së Mbrojtjes së TMK-së. Për këtë çështje duhet theksuar posaçërisht ndihmën që më dha profesor Ahmet Gecaj, i cili, me sa më kujtohet, ishte Prorektor i Universitetit të Prishtinës për çështje financiare.

Deri në fund të vitit 1999 unë me një staf numerikisht shumë të vogël i bëra përgatitjet e duhura për fillimin e punës së Akademisë. Disa eporë, me propozimin tim, nga Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së u emëruan në detyra të mësimdhënësve duke formuar departamentin



e mësimdhënies dhe atë të planifikimeve. Kryesisht këta ishin eprorë të shkolluar në ish-APJ dhe me një përgatitje solide ushtarake. Mirëpo, jo të gjithë nga Shtabi i Përgjithshëm dhe nga stafi i akademisë më përkrahën për emërimin e tyre. Disa i quanin eprorë të FARK-ut, e disa “jo të përshtatshëm” për shkaqe të ndryshme. Nuk munguan as fyerjet për disa eprorë. Disa njerëz të dalë nga lufta nuk mund ta kuptonin se në Akademi të TMK-së mund të ligjërojnë dhe trajnojnë vetëm ata që kanë përgatitje akademike e jo ata, përkundër që kishin luftuar me sukses, që nuk kishin përgatitje të duhur shkollore. Ky edhe ishte shkaku pse unë angazhoja njerëz me përvojë dhe shkollim ushtarak në akademitë ushtarake të ish-APJ-së. Angazhimi i këtyre eprorëve ishte i pashmangshëm në konsolidimin e mirëfilltë të këtij institucioni.

Disa njerëz e sidomos të biznesit filluan të ofronin ndihmë materiale por edhe financiare. Duhet veçuar sidomos ndihmesën e organizatës ndërtimore “Izolimi” me seli në Prishtinë dhe kompanisë private për mobilieri me seli në Podujevë, “Galanteria”. Urdhërova të sigurohet një kasafortë duke formësuar njëkohësisht komisionin financiar, i cili evidentonte të hyrat dhe daljet për të mënjeluar çdo lloj keqpërdorimi eventual të mjeteve financiare. Edhe pse ende nuk ishte zyrtarizuar fillimi i punës së TMK-së nga administratori i UNMIK-ut, filllora t’u japë detyra eprorëve të akademisë, duke e caktuar afatin e raportimit për kryerjen e tyre. Për shkak të “ashpërsisë sime”, siç thoshin disa eprorë, e madje disa persona sikur filluan të më quanin komunist, i tejkaluar, e ndonjëherë edhe të më fyenin. Në fakt, kaq ishte niveli intelektual e njerëzor tek këta persona e që sigurisht nxitej edhe nga euforia e pas-luftës si dhe tendenca për dominim. U ballafaqova me vështirësi menaxhuese duke kuptuar se kam filluar një punë sistematike që disave nuk iu përgjigjej. Arrita t’i formësoja dy versione të planprogramit për trajnimin e eprorëve të TMK-së. Derisa njëri version i përgjigjej kërkesave të UNMIK-ut që ky plan mund të përfshijë vetëm tematikë për gatishmëri emergjente, tjetri kishte edhe elemente ushtarake. Shumë shpejtë ky i dyti sikur u zbulua dhe domosdoshmërisht është dashur të asgjësohet.

Në ndërkohë u zyrtarizua fillimi i aktiviteteve të TMK-së. Me këtë rast në sallën e Kuvendit të Kosovës u organizua një solemnitete, me ç’rast na u lexuan dhe dorëzuan aktvendimet e komandantëve të zonave dhe të

komandantit të akademisë e që i kishte nënshkruar kryeadministratori i parë i UNMIK-ut, francezi Bernard Kouchner. Pasi që paraprakisht u krijuan kushtet për punë në Shtabin e Përgjithshëm, u vendos që trajnimin e parë të komandantëve të porsaemëruar ta bëjmë në Akademi të TMK-së, të cilën tanimë edhe zyrtarisht e udhëheqja unë. Pas disa ditësh u kuptua se ky trajnim do të fillojë së realizuari më 30 janar të vitit 2000. Ligjëratat e para do t'i mbanin kryeadministratori Kouchner dhe gjenerali Rainhard, komandanti i dytë i KFOR-it në Kosovë. Në ndërkohë, pa dijen time përkatësisht pa konsultimin me mua, gjeneral Çeku, komandant i TMK-së, kishte vendosur që në po të njëjtën ditë të bëhej edhe hapja solemne e punës së Akademisë së Mbrojtjes. Ishin ftuar të gjitha mediat. Çuditërisht shefi i departamentit të trajnimeve të Shtabit të Përgjithshëm të TMK-së, Ramë Arifaj, filloi të flasë dhe më pas ia dha fjalën Çekut, i cili pas një hyrje të shkurtër e bëri hapjen solemne të punës së Akademisë.

I gjendur në një situatë shumë të pakëndshme, për pak që nuk bëra incident (edhe pse në një moment sikur e vendosa që të dalë në foltore e t'ia shtroja pyetjen z. Çeku se kush është këtu komandant i Akademisë?). Mirëpo, duke u bazuar në interesat e përgjithshme shoqërore dhe në implikimet që do të dilnin nga një ndërhyrje e befasishme e imja, në sekondën e fundit u përmbajta duke mos e marrë atë vendim. Jo vetëm kaq. Në asnjë fjalë z. Çeku nuk përmendi faktin se unë isha komandant i Akademisë dhe assesi nuk e përmendi kontributin tim për formimin e Akademisë dhe të arriturat shumë të mëdha që u bënë nën udhëheqjen time në këtë institucion. Por, në vend të tij këtë do ta bëjnë në prezantimet e tyre gjenerali gjerman Klaus Rainhard dhe kryeadministratori i Kosovës z. Bernard Kouchner, duke më falënderuar thellësisht për angazhimin tim. Bile gjenerali Rainhard në një moment më quajti edhe koleg para të gjithë të pranishmëve, sepse, siç tha, edhe ai paska qenë komandant i Akademisë ushtarake në Hamburg të Gjermanisë dhe rrjedhimisht ka respekt për rolin e komandantit të këtij institucioni. Ishte kjo situatë e pashpjegueshme. Derisa përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare më lavdëronin, z. Çeku këtë nuk e pa të udhës ta bëjë. Pse? Përgjigja në këtë pyetje, sipas mendimit tim, është shumë e thjeshtë. Ai në fillim të angazhimit tim nuk ka pasur njohuri të mjaftueshme për peshën e emrit dhe bagazhit tim që unë e kisha bërë në shoqërinë kosovare. Si duket ai e bëri një

vlerësim të mirë, sepse e dinte se po të më jepte fjalën e hapjes në këtë ceremoni, e që ka qenë domosdoshmëri, ka menduar se ai do të mbetet nën hijen time. Ja që kështu e kemi ne shqiptarët! Në pauzën e parë në prezencën e zëvendëskomandantit të SHP të TMK-së, z. Ramush Haradinaj, në mënyrë të ashpër reagoi ndaj gjestit të pahijshëm që e bëri z. Çeku e që në fakt ishte pa precedent. Ai sikur filloi të kërkojë falje dhe të më bind se tash pas pauzës do të ma japë fjalën që unë të udhëhoqi seancën e mëtejme, gjë që unë kategorikisht e refuzova. Në këtë situatë z. Haradinaj ishte shumë i matur dhe sikur e pranoi “gafin” që e bëri Çeku duke më lutur që të vazhdoja punën time, sepse, siç tha ai, paska nevojë për mua.

Pavarësisht nga kjo situatë, vazhdova aktivitetin tim, sepse isha i bindur se po e bëj një punë të mirë për popullin tim dhe iu përmbaja thënies popullore: “Kur të hysh në lojë duhet luajtur”. Në këtë aktivitet më ndihmonte zëvendësi im, zotëri Imri Ilazi, i cili kishte marrë pjesë në luftë në zonën e Nerodimës. Edhe pse në moshë shumë më i ri se unë, ai më përkrahte dhe më respektonte.

Trajnimet e njëpasnjëshme në këtë institucion vazhduan me një ritëm të përshpejtuar. Tek pjesa dërrmuese e pjesëtarëve të TMK-së dhe popullatës, Akademia shihej si institucion shumë i rëndësishëm, aq më parë që ajo identifikohet shpeshherë me emrin dhe profesionalizmin tim. Pata me dhjetëra raste kur disa ushtarë, por edhe oficerë vinin tek unë për t’u konsultuar kryesisht lidhur me punën zyrtare që ata e bënin në njësi të ndryshme, padrejtësitë dhe nepotizmin që ata po e vërejnë e kështu me radhë. Kuptohet se kjo nuk ishte puna ime që të jepja “leksione të ndryshme”, por gjithsesi se njerëzit i pranoja në bisedë edhe për faktin se ata kishin besim në mua si epror që e respektoja ligjin, disiplinën dhe njeriun si të tillë.

Deri në qershor të vitit 2000 në Akademinë e Mbrojtjes të TMK-së u vërejt një stabilitet, qoftë në menaxhim, qoftë në cilësi të mësimave dhe trajnimeve. Një numër i vogël i eprorëve të punësuar në akademi nuk më përkrahnin dhe ishin si një lloj opozite për shkak të kërkesave që unë i kisha në kryerjen e detyrave dhe të mos lejimit të keqpërdorimeve të ndryshme. Në një numër të raportimeve, takimeve, solemniteteve të ndryshme, të organizuar nga Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së,

më ftonin edhe mua. Ka ndodhur që në disa takime dhe trajtime të çështjeve të ndryshme të mos ftohëm, përkatësisht të anashkalohejmë dhe atë qëllimisht. Kështu p.sh. në një takim të organizuar në Shtabin e Përgjigjëm të KFOR-it, siç thoshin "Film City" në Dragodan, ku do të ligjëronte gjenerali amerikan Wesley Clark, ish-komandant suprem i forcave të NATO-s, një epror i larë i SHPTMK nuk kishte dhënë emrin tim. Për këtë unë do të mbetem pa ulëse dhe doli se isha tepricë. Disi u gjenda dhe u ula në një skaj të sallës!

Me atë rast gjenerali Clark foli për nevojën e përmbajtjes sonë nga implikimi në Luginë të Preshevës, përkatësisht në konfliktin e armatosur që zhvillonte Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit (UÇPMB) si dhe shpjegoi gjëra të tjera të karakterit gjeostrategjik.

Sidoqoftë, unë e kryeja punën time aq sa më lejonin rrethanat dhe mënyra e menaxhimit, përkatësisht udhëheqjes dhe komandimit nga ShP i TMK-së. Në gusht të po këtij viti, papritmas më ftoi z. Çeku për një bisedë. Edhe pse nuk e dija të saktë qëllimin e këtij takimi, supozimi im që do të më zëvendësojnë me dikë tjetër ishte i saktë. Me të arritur në zyrën e z. Çeku tek ai vërejtja një lloj shqetësimi para se të më kumtonte vendimin për zëvendësimin tim. Me atë rast ai sikur filloi të më "bindë" se nuk do të ishte mirë që unë të bëja rezistencë, sepse, siç parashikonte ai, unë do të jepja kontributin tim me të madh në Shtabin e Përgjithshëm të TMK-së. Posa ma dha fjalën, përgjigjja ime ishte shumë e qartë, duke ia rikujtuar atij se unë me këtë detyre nuk kisha ardhur pa kërkesën që më kishte bërë ai, dhe atë në dy raste. Me këtë rast ia bëra me dije se unë nuk do të bëj rezistencë sikur disa eprorë të tjerë. Në bisedë e sipër Çeku më "zbuloi" se kush do të ishte pasardhësi im. Kur më tha se ky person është Rexhep Selimi paksa u befasova, sepse kisha një ndjenjë se në këtë detyrë do të vinte ndonjë epror i karrierës. E kisha të qartë se z. Selimi ishte ndër themeluesit e UÇK-së dhe se kishte dhënë kontribut në luftë dhe se në Qeverinë e Përkohshme ishte ministër i rendit. Mirëpo, bagazhi i tij akademik e ushtarak nuk konsistonte me karakteristikat që duhet t'i ketë komandanti i një akademie ushtarake apo të mbrojtjes në çdo vend të botës. Kështu, në ditën e caktuar, në prani të medieve, në mënyrë shumë dinjitoze organizova pranidorëzimin e detyrës dhe atë duke e nënshkruar, për herë të parë, një

procesverbal të cilin unë e formësova dhe i cili më vonë si dokument do të përdoret në TMK. Pasi që paralajmërova se do largohem nga TMK-ja, Çeku (duke i ditur implikimet negative që mund të dalin nga largimi im) sikur më luti që edhe më tej të qëndroj në Shtabin e Përgjithshëm të TMK-së. Në shqyrtim e sipër të largimit tim rastisa në, tani të ndjerin Mahmut Bakallin dhe atë para hyrjes në banesën e tij. Pasi që i paralajmërova se do të largohem nga TMK-ja, më ftoi që të hyjmë dhe diskutojmë në banesën e tij. Në bisedë e sipër, pasi që e pa vendosmërinë time për largim nga TMK-ja, për shkaqe që ai shumë shpejtë i mësoi, sikur m'u lut që edhe për një kohë të mbetem në këtë strukturë, sepse, siç theksoi, "vetëm hyrja dhe dalja jote me çantë në dorë në Shtabin e Përgjithshëm të TMK-së për Beogradin zyrtar ka domethënie të posaçme". Ishte ky një politikan vizionar, i cili në fakt shikonte "përtej bregut". Fjalët e tij në fakt më bindën që unë në TMK-të mbetem edhe për 6 muaj të tjerë, duke dhënë një kontribut modest por të rëndësishëm në një atmosferë rezistuese nga disa persona dhe duke më trajtuar si element të padëshirueshëm.

Gjatë qëndrimit tim në Shtabin e Përgjithshëm të TMK-së, u formua një fond i quajtur "Miqte e TMK-së". Komandanti i TMK-së kishte vendosur që të formojë një grup të eprorëve që do të udhëtonin në Amerikë për të shpjeguar nevojën e sensibilizimit të këtij fondi. Më pas mora vesh se në këtë grup isha paraparë edhe unë që së bashku me Ramiz Lladrovcin dhe Lulzim Jasharin (djalin e Adem Jasharit) të udhëtoja për në SHBA. Dhashë pëlqimin për këtë dhe në ndërkohë arritëm që t'i marrim vizat dhe dokumentet e tjera të nevojshme. Edhe pse pas largimit tim nga akademia, për shkak të rëndësisë të kësaj çështjeje, isha i lutur që të udhëtoja për në SHBA. Përkundër stresit dhe hezitimit që përjetova, vendosa që të udhëtoja për në SHBA e pas kthimit prej vizitës, e cila ishte paraparë që të zgjaste dy javë, të largohem nga TMK-ja. Organizimi i vizitës ishte planifikuar deri në detaje. Mirëpo, ndonjë sukses në përkrahjen më të fuqishme të fondit nga shqiptaro-amerikanët nuk patëm, për shkak të disa dobësive që ishin vërejtur me fondin "Vendlindja Thërret" e që në tubimet e organizuara atje nganjëherë disa persona këtë çështje e theksuan në mënyrë të zëshme.

Kuptohet se para nisjes për në SHBA z. Çeku më premtoi se do të më emëronte ndihmës të tij për çështje operative strategjike. Mirëpo, pas

kthimit nga SHBA-të, u informova nga disa qarqe se emërimi im në atë pozitë ishte refuzuar nga disa persona përgjegjës në Qeverinë e Përkohshme dhe sidomos nga Rrustem Mustafa - Remi. Për këtë arsye u vendos të emërohem në detyrën e drejtorit për çështje mbështetëse në Shtabin e Përgjithshëm të TMK-së. Lidhur me këtë kontaktova me z. Rrustem Mustafa, i cili më vërtetoi se kishte rezistuar për emërimin tim për shkaqe që ai i dinte, ndërsa me disa nga qeveria e përkohshme as që tentova të bisedoja, aq më parë që tanimë e kisha marrë vendimin për largim nga TMK-ja.



**PJESA E TREMBËDHJETË**  
**ANGAZHIMI NË ZYRËN E**  
**KOORDINATORIT TË TMK-së**



Pas formimit të disa departamenteve në nivel të Kosovës nga Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në mesin e tyre u forma edhe ai i Mbrojtjes Civile. Kryesues i këtij departamenti u emërua z. Bislim Zyrapi, i cili që në fillim të marrjes së detyrës më kishte paraparë që unë nga TMK-ja të kaloj në këtë departament për çështje të planifikimeve, siç e quante ai, operacionale. Pas bisedës që e bëmë, vendosa ta shfrytëzoj këtë moment që ta braktisi TMK-në dhe kështu u gjenda në një detyrë të re në Departamentin e Mbrojtjes Civile. Pas 3-4 muajve formohet Zyra e Koordinatorit të TMK-së pranë UNMIK-ut në të cilën fillimisht do të emërohem në cilësinë e këshilltarit për trajnime. Këtë zyrë e udhëhiqte vazhdimisht një gjeneral anglez por në rroba civile (ata ndërroreshin çdo vit).

Krahas kësaj pune nuk i ndërpreva shkrimet dhe analizat e ndryshme të sferës së sigurisë. Në numrin festiv të vitit 2002 në të përditshmen "Zëri" do të botohet një analizë e imja për çështje të sigurisë, në të cilën unë do të shkruaja edhe për nevojën e formimit të Ushtrisë së Kosovës. Kryeadministratori i atëhershëm, gjermani Mihael Steiner (Shtajner), i informuar për këtë shkrim, urdhëron që të shqyrtohet mundësia e largimit tim nga detyra. Këto qëndrime ishin në kontekst të një qëndrimi shumë të ngurtë të pranisë ndërkombëtare në Kosovë ndaj ngritjes së rolit të akterëve vendor e sidomos kërkesave për themelimin e institucioneve të rëndësishëm. Në bisedë e sipër për këtë rast me gjeneralin anglez me mbiemrin Kaming, i cili udhëhiqte zyrën e koordinatorit të TMK-së, vërejta shqetësimin e tij për shkak se posa e kishte pranuar detyrën i doli problemi lidhur me rastin tim. Fillimisht më informoi se kryeadministratori ka reaguar ashpër në shkrimin tim dhe se për këtë mund të largohem nga puna. I vetëdijshëm se kisha të drejtë të shpreh mendimin tim, sikur filloi të më bind që në shkrimet e mëvonshme të kem diç më tepër kujdes se çka do të shkruaja. Në fakt ai hoqi dorë nga mundësia e largimit tim.

Gjatë tërë viteve të angazhimit tim në Zyrën e Koordinatorit të TMK-së nuk ndala kontributin shkencor duke bërë analiza lidhur me situatën e sigurisë në Kosovë dhe duke dhënë propozime për reformimin e sektorit të sigurisë, i cili gjatë asaj kohe jo vetëm se ishte i mangët mirëpo ishte edhe nën mbikëqyrjen ekskluzive të pranisë ndërkombëtare. Kërkoja vazhdimisht që vendorët të kenë një rol shumë më të madh në procesin

e ndërtimit të sektorit të sigurisë duke mbetur një ndër të paktët që bënë kërkesa të tilla në atë kohë.

Në shtator të vitit 2004 publikova librin tim me titull “Çështjet e Sigurisë Nacionale të Kosovës” me recensentë: Prof. Dr. Fatmir Sejdiu, Prof. Dr. Vesel Latifi dhe kolonel Gëzim Hazrolli. Libri zgjoi interesim aq më parë kur ishte një ndër publikimet e rralla nga sfera e sigurisë. Me prezencën e tyre mediat, qoftë ato elektronike qoftë edhe ato të shkruara, i dhanë publicitet.

Deri në korrik të vitit 2005 do të veproj në këtë zyrë në TMK por nga këndi tjetër dhe nga pozicioni i një institucioni i cili e mbikëqyrte TMK-në. Si rrjedhojë, disa eprorë të TMK-së sikur ndërruan qëndrimin ndaj meje.

## **Angazhimi im i rastësishëm në Qeveri**

Në fillim të muajit korrik të vitit 2005, nëpërmjet shefit të kabinetit të tij, papritmas më ftoi në një bisedë kryeministri i atëhershëm Bajram Kosumi. Edhe pse isha i preokupuar dhe i tronditur me sëmundjen e rëndë të nënës time, e cila po qëndronte e shtrirë në spitalin e Prishtinës<sup>16</sup>, iu përgjigja thirrjes së tij. Me atë rast me kumtoi se ka vendosur që të më emërojë për këshilltar politik për çështje të sigurisë. Pas shpjegimeve që më bëri për nevojën e fuqizimit të sektorit të sigurisë, pranova ofertën. Kuptohet se, paksa isha i hutuar me këtë vendim të z. Kosumi sepse njerëzit e nivelit të profesionalizmit tim dhe të asaj moshe nuk ishin në “modë” për detyra të këtilla. Përgjegjësia ishte shumë e madhe aq më parë që kryeministri Kosumi më bëri me dije se unë vet duhet të vendosja (pasi ta informoja) për shumë çështje të sferës së sigurisë. Atëbotë në kryeministri ishte një përbërje mjaft interesante e këshilltarëve si: Dr. Driton Qehaja, Avni Arifi, Naser Rugova, Venera Hajrullahu, Besnik Tahiri e kështu me radhë. E përcillja sidomos TMK-në, Policinë e Kosovës (atëbotë Shërbimi Policor i Kosovës) dhe çështjet e analizave të sigurisë së përgjithshme

16 Ndërkohë, më 9 gusht 2005, nga një sëmundje e rëndë, në moshën 83 vjeçare, me vdiq nëna ime, Hazbije (Morina) Qehaja, e lindur më 1923 në fshatin Topanicë të Kamenicës. Vdekjen e saj e përjetova rëndë e aq më parë që na kishte lindur dhe ngritur dhjetë fëmijët në një varfëri të skajshme.

në nivel të vendit. Nisi të praktikohej që një herë në muaj kryeministri të ketë takim me komandantin e KFOR-it. Në këto takime kishte nevojë të iniciohen edhe disa çështje të rëndësishme. I propozoja temat që duhet shtruar në ato biseda. Kryeministri ishte mjaft i ashpër sidomos në kërkesat për KFOR-in që kishin të bënin në luftimin e strukturave ilegale serbe në veri por edhe në enklavat serbe në brendi të territorit.

Një herë në muaj bënim takim me kreun e UNMIK-ut për TMK-në, me ç'rast i përgatisja kryeministrit fjalimet hyrëse. Në këto takime trajtoheshin edhe çështjet e policisë. Isha i autorizuar që për sferën e sigurisë të prononcohesha para medieve. Udhëheqja grupin punues në mes Kryeministrit dhe Shtyllës së Parë të UNMIK-ut për formimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në këto takime sidomos dallohej për profesionalizëm juristi Dr. Robert Muharremi, i cili dha një kontribut të madh në sqarimin e shumë çështjeve që kanë të bëjnë me këtë ministri. Në fakt, ne bëmë punë të madhe në formimin e dy ministrive që ishin dhe mbetën segmente të rëndësishme të shtetit të Kosovës.

Kuptohet se në këtë aktivitet timin pati edhe probleme dhe vështirësi në punë. Nuk i takoja asnjë partie politike dhe disa persona nga koalicioni qeveritar i atëhershëm (AAK dhe LDK) filluan të më trajtojnë si jo i "përshtatshëm". Me rastin e ditës së akademisë së TMK-së, ku ishte paraparë të fliste kryeministri, edhe pse ia kisha shkruar fjalimin që do të duhej të lexonte, ai për disa shkaqe dhe probleme që i dolën në një mbledhje të qeverisë, nuk shkoi në solemnitet në akademinë e TMK-së dhe as që i ra ndërmend të më dërgojë mua. Me atë rast ishte krijuar një pakënaqësi tek disa eprorë të TMK-së dhe të tjerë. Gabimisht ishte formësuar mendimi se unë gjoja e paskam penguar (këshilluar) kryeministrin që të mos shkojë në këtë solemnitet. Po atë ditë në orët e vona të ditës e mora një thirrje telefonike shumë kërcënuese për jetën time e që më brengosi pa masë. Hetimet nga organet e UNMIK-ut lidhur me këtë rast filluan të zhvillohen por rezultati konkret mungoi. Nuk insistova në hetimet e mëtejme për këtë rast, edhe pse kisha indicje lidhur me grupacionet që më kërcënuan. Përkundër kësaj, vazhdova punën si këshilltar për siguri dhe atë në mënyrë shumë profesionale. Në veçanti profesionalizmin tim e çmonte shefi i UNMIK-ut z. Jesen Petersen dhe amerikani Lari Rosin, zëvendës i tij. Ndërkohë

me shkarkimin e kryekuvendarit të atëhershëm, z. Nexhat Daci, i krijua një atmosferë dëshpëruese dhe u kërkua dorëheqja edhe e ish-kryeministrit Kosumi, i cili, edhe pse kishte mungesë më të avancuar menaxheriale, megjithatë, dha një kontribut të rëndësishëm në shtetndërtimin tonë.

Në vend të tij, kryeministër i Kosovës do të vijë Agim Çeku një ish-ushtarak i APJ-së dhe komandant i TMK-së. Faktikisht kjo ndodhi sepse ai nga AAK u propozua dhe me një automatizëm u zgjodh kryeministër nga Kuvendi i Kosovës. Bazuar në përvojën e mëhershme të punës sime në TMK dhe menaxhimin që ai e bëri, isha më se i bindur se me ardhjen e tij për kryeministër të Kosovës, unë nuk do të vazhdoj detyrën e këshilltarit për siguri. Një pjesë e stafit civil që më rrethonin sikur filluan të më bindin se unë do të mbetem në këtë post aq më parë që në këtë funksion po vjen një koleg i imi ushtarak, dhe se bartja e gjëseneve të mia personale nga zyra ku punoja, sikur disa personave iu duk se ky ishte si gjest jo i qëlluar. Me rastin e bisedës me mua, z. Çeku më bëri më dije se mbetem jashtë kabinetit të tij qeveritar.

Pas vdekjes së presidentit Rugova dhe zgjedhjes së z. Fatmir Sejdiu në postin e presidentit të Kosovës, gjërat sikur filluan të ndryshojnë. Me rastin e urimit tim për zgjedhjen e tij në këtë post, z. Sejdiu sikur ma bëri me dije se nuk ka nevojë për këshilltar për siguri edhe pse vendin e kishte vakant. Në të vërtetë derisa ai ishte sekretar i LDK-së, pas një debati televiziv me gazetaren Jeta Xharra e në të cilin unë mora pjesë në cilësinë e këshilltarit të kryeministrit, në një takim të rastësishëm me z. Sejdiu në hollin e Kuvendit të Kosovës, më dha “vërejtje” pse unë nuk paskam qenë më i zëshëm në gjykimin e një shërbimi informativ partiak. Gjoja ai e paska mbajtur ndërmend këtë fakt dhe kjo i shërbeu si shkak për të më refuzuar nga kabineti i tij presidencial. Sidoqoftë kjo ishte çështje e tij.

Kështu unë do të mbetem i paangazhuar për një kohë jo të shkurtër. Fillova të merrem me shkrime, përkatësisht analiza të sferës së sigurisë. Pata rastin të marrë pjesë në disa konferenca, në të cilat trajtoheshin çështjet e sigurisë si në vend ashtu edhe jashtë vendit. Qëndrimi se unë si ekspert i çështjeve të sigurisë do të kontribuoja për shtetformimin, nuk doli të jetë i saktë, sepse mosangazhimi im në asnjë

parti politike, bile edhe si militant, ishte shkaku kryesor i mosfrimit tim në institucione.

Në gjysmën e dytë të vitit 2006, filloi së formuari një subjekt i ri politik i quajtur Aleanca Kosova e Re, udhëhequr nga z. Behgjet Pacolli. M'u dha rasti që aty të angazhohem si këshilltar i kryetarit për siguri dhe shpresoja se ky subjekt i ri do të jetë një fytyrë e re për Kosovën ku unë do të mund të kontribuoja. Në këtë subjekt politik filluan të hyjnë shumë njerëz-ekspertë të fushave të ndryshme. Përceptimi në fillim ishte se këtu do të ishte një mundësi e mirë për personat të cilët do të mund të kontribonin. Mirëpo, kishte edhe njerëz të cilët duke punuar dhe vepruar atij sikur i krijonin një bllok, për të kundërshtuar të gjithë ata njerëz, siç thashë ekspertë, të cilët ishin mjaft të njohur për opinionin e gjerë. Fjala ishte për një grup oportunistësh që, për t'i arritur qëllimet e tyre, ishin në gjendje të përdornin të gjitha mjetet. Qëllimi i tyre ishte që, me eliminimin tonë, domosdoshmërisht do të merrnin votat e mjaftueshme për të hyrë në Kuvend. Filluan fyerjet, shantazhet e kështu me rradhë. Kishte prej atyre që edhe në start kishin ardhur me detyrë për ta dobësuar këtë parti. Kryetari i saj, z. Behgjet Pacolli, i cili shumë pak gjente kohë për procesin e formimit dhe përfaqësimit të kësaj partie, në fakt ishte i pafuqishëm për t'i luftuar këto dukuri negative. Ndërkohë, disa njerëz të merituar sikur filluan të largohen.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2007, mua do të më fusin në listën zgjedhore, por i renditur poshtë, në numrin 53. Përkundër kësaj, unë, duke e ditur se do të jem i votuar mjaftueshëm, pavarësisht numrit rendor (dhe me gjithë hezitimet), vendosa të mbetem në listën zgjedhore. Në ditën e zgjedhjeve, rreth orës 16:00, duke hyrë në selinë e partisë, një i afërm i z. Behgjet Pacolli do të më kumtojë lajmin se deri atëherë unë jam personi më i votuar pas kryetarit. Mirëpo, ndodhi që votat u vodhën dhe iu dhanë personave të tjerë të pazëvendësueshëm të partisë. Kjo u bë nga qarqe dhe grupe të ndryshme të partisë. Kryesisht kjo u bë me sinkronizimin e komisionarëve të partisë, të cilët kishin marrë instruksione që të plotësoheshin votimet e kandidatëve në mënyrë të jashtëligjshme. Përkundër kësaj, siç më thanë, do të arrija numrin 18 sipas radhitjes dhe atë me rreth 5700 vota. Pasi që përqindja e tërësishme e votave të partisë ishte vetëm 13%, ndërsa

kuota e domosdoshme prej femrave 30% e cila do të caktohet në ad-hoc, rezultoi që unë të mos kem mundësi të hyjë në Kuvend të Kosovës. Pasi që në jetë kisha pasur shumë thyerje, tatëpjeta, ngritje, etj., këtë moment nuk e mora edhe shumë për zemër, aq më parë që ky ishte realiteti ynë i gjoja pluralizmit. Kuptohet se nga ky moment unë do të tërhiqem nga AKR-ja.

## Aktiviteti në Shoqërinë Civile

Edhe më herët, e në veçanti në gjysmën e dytë të vitit 2007, i bëra disa përpjekje që ta regjistroj një institut për çështje të sigurisë si organizatë joqeveritare. Mirëpo, në pamundësi që të kem ndonjë përkrahje nga njerëzit që e njihnin këtë sferë e që në fakt ishin të pakët, për një kohë u tërhoqa nga kjo tentativë. Pas mbarimit të studimeve master nga sfera e sigurisë në Angli të djalit tim, Florianit, edhe pse i ri në moshë, në fillim të vitit 2008, ai më këshilloi regjistrimin e kësaj organizate. Kështu më 17 prill të vitit 2008 regjistrova organizatën joqeveritare të quajtur Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Pas disa përgatitjeve teknike, gjetjes së hapësirës për punë dhe atë fillimisht në Kolegjin “Universum”, më 10 maj, me ndihmën e pa kursyer të Florianit dhe në prani të një numri mysafirësh të ftuar, e bëra promovimin e fillimit të punës së kësaj qendre në hotelin Grand. Me atë rast mediat sidomos ato elektronike i dhanë publicitet kësaj nisme. Kështu aktivizova qendrën, dhe përkundër skepticizmit tim për shkak të mungesës së fondeve, filloi aktivitetin ky institucion, duke i ngritur disa çështje të rëndësishme të sferës së sigurisë. Kuptohet se për shkak të disa rrethanave nuk arrita të gëzoj përkrahje nga institucionet vendore. Fillimisht arrita të siguroj një përkrahje modeste nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) e që në Kosovë e udhëheq z. Luan Shllaku. Në fakt ishte ky, ashtu ta quajmë, gurthemel i punës së mëtejme të kësaj organizate. Në gjashtë muajt e parë të aktivitetit roli im në ngritjen e kësaj qendre ishte mjaft domethënës. Më pas ky rol iu delegua një ekipi të ngushtë hulumtuesish të rinj, të udhëhequr nga Florianit, i cili shumë shpejt, duke i përdorur metodat bashkëkohore të vlerësimit të sektorit të sigurisë, qendrën gradualisht do ta ngriste në një institut shumë relevant të sferës për çka edhe e kishte dedikimin. Brenda një kohe shumë të shkurtër, Qendra filloi të luajë një rol proaktiv në kuadër të sektorit joqeveritar, duke reflektuar një ndër organizatat

e vetme të specializuara në Kosovë. Pas katër viteve të ekzistimit të saj, qendra në fjalë karakterizohet me një stabilitet kadrovik, hulumtues, shkencor dhe financiar. Në suaza të Kosovës e në veçanti në mesin e instituteve (think tank) të tjera në rajon, qendra gëzon epitelin e një qendre shumë relevante. Në shtator të vitit 2011, me vendim unanim të Bordit të QKSS, në pozitën e drejtorit emërohet Florian Qehaja dhe ndërkohë u bënë ndryshime të brendshme kadrovike e menaxhuese. Kjo ndodhi pas dorëheqjes sime si rezultat i emërimit tim (në qershor të vitit 2011) nga ana e Kuvendit të Kosovës, si mbikëqyrës shtetëror i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, institucion ky i themeluar për herë të parë në Kosovë.

# **FOTOGALERIA**





Fotografia e bërë në vitin 1955 me nxënësit e klasës së V-të, të shkollës tetëvjeçare në fshatin Rogaçicë. Nga e djathta, reshti i parë në këmbë, i treti me radhë. Dukshëm shihet një leckë e qepur në fanellën time.



Foto nga viti 1975. Prindërit: nëna Hazbije dhe babai Bahtijari, pozojnë para shtëpisë së tyre në Rogaçicë.



Në shkollën e nënoficerëve gjatë orës së topografisë, në vendin e quajtur "Trubaçeva Kosa" afër Sarajevës. Në rreshtin e parë në këmbë nga e majta, i pesti me radhë. Lëndën e ligjëronte një major slloven me emrin Bartolla.



Rreshter i APJ-së në garnizonin e Travnikut në Bosnën qendrore.  
I veshur në rroba ushtarake të terrenit.



Me babain tim Bahtjarin në fillim të vitit 1962, gjatë vizitës që ai më bëri në Travnik derisa shërbeja si nënoficer.



Kadet i Akademisë Ushtarake të ushtrisë tokësore në Beograd, tetor 1963.



Gjatë një pushimi pas kryerjes së një ushtrimi fushor në afërsi të akademisë në Beograd. I pari nga e djathta në këmbë.



Në poligonin e kulturës fizike në hapësirën e Akademisë Ushtarake në Beograd. Pengesat e ndryshme gjithsesi është dashur të kalohen. I pari nga e djathta.



Gjatë përgatitjes për një ushtrim fushor si kadet i akademisë ushtatake në rrethinën e Beogradit. Mihjën e transhesë e bënin vetë kadetët, qershor 1964.



Tetor i vitit 1967 si oficer nëntoger i caktuar për tu takuar me komandantin suprem të Forcave të Armatosura të Jugosllavisë, Josip Broz Tito. Fotografuar në Ohër pranë villvs së quajtur Gorica, me oficerë të tjerë të paraparë për këtë takim. Nga e djathta i pari, rreshti i dytë.



Gjatë një pushimi pas kryerjes së qitjes me armë të zjarrit në fshatin Kramovik, derisa isha komandant i batalonit dhe garnizonit në Gjakovë. Foto nga viti 1975



Foto në nëntor 1975 gjatë ushtrimit të quajtur “Drenica 75” derisa isha komandant i batalonit të Gjakovës. Spjegimet për të arriturat gjatë këtij ushtrimi ishin të domosdoshme.



Në shkollimin më të lartë ushtarak-shkollën e mbrojtjes nacionale të Focave të Armatosura të Jugosllavisë. I pari nga e majta në këmbë.



Gjatë një fjalimi para oficerëve, nënoficerëve, oficerëve dhe qytetarëve në kazermën e garnizonit të Zajeçarit (Serbia lindore) në vitin 1987.



Foto në vitin 1988 në kazermen e Zajëçarit gjatë një reviste.



Revistë një njësi të brigadës së Zajëçarit pas një solemniteti në vitin 1989. Të pranishëm ishin edhe shumë qytetarë të rajonit të qarkut të Timokut.





Si komandant i brigadës, përgjegjësia për njerëz ishte shumë e madhe. Kontakti me ushtarë ishte i domosdoshëm. Foto e vitit 1989 gjatë dhënies së betimit solemn të ushtarëve.



Në oborrin e Akademisë së Mbrojtjes së Trupave Mbrojtëse të Kosovës, fundi i vitit 1999. Çdo ditë pune fillonte me ngritjen e flamurit kombëtar dhe leximin e urdhërit të komandantit.



Prill 2000, në Akademinë e Mbrojtes së TMK-së, duke u përshëndetur me prindërit dhe nxënësit e shkollës fillore të Reçakut, Shtime.



Në shtabin e përgjithshëm të TMK-së gjatë një solemniteti, në vitin 2001.



Në uniformën solemne të TMK-së me bashkshorten Nazen dhe djemtë binjakë: Adrianin dhe Florianin, 2001.



Si komandant i Akademisë së TMK-së në vitin 2000, në mesin e donatorëve të shumtë që ndihmuan ngritjen e këtij institucioni.



Fotografuar në vitin 1973 me bashkshorten Nazen.



Gjashtë fëmijët e mi. Nga e majta në të djathtë: vajza Feime (mjeke), vajza Emine (mjeke), djali Adriani (muzicient), djali Floriani (doktorant), vajza Fatbardha (doktorante) dhe vajza Hyrije (jur. e dip.).



Angazhimi permanent në përgatitjen e ushqimit cilësor nga bashkshortja Naza, asnjëherë nuk mungoj.



Maj 2012, gjatë drekimit me bashkshorten.



Në oborrin e shtëpisë me nipat dhe mbesat.



Vajza Eminja me fëmijët. Nga e majta Festa dhe Erna.



Vajza ime Feimja me fëmijët. Nga e majta: me vajzen Doniken, djalin Markun dhe vajzen Rrona. Nipi i talentuar Mark Marku ka bërë paraqitje senzacionale muzikore në ngjarjen “Kroacia zgjedh yllin” në Kroaci, në vitin 2011 duke u ranguar i treti. Është nderi i familjes.



Vajza ime Hyrija me fëmijët. Nga lart: Arita, Fiona dhe Eda.



Vajza ime Fatbardha me djemtë: Doni, Liri dhe Narti.





Djemtë binjakë: Adriani e Floriani pozojnë gjatë një ndeje.



Në shoqëri me një grup intelektualësh me rastin e festimit të 70 vjetorit të lindjes të prof.Dr. Shaban Gecit (2006), para shkollës fillore "Metush Krasniqi" Rogaçicë.

# **FAKTOGRAFIA**

# NËNTOGËRI RAMADAN QEHAJA - DELEGAT NË KONGRESIN IX TË LKJ

Më 6 tetor të këtij viti në lokotet e shpërndes së APJ në Prishtinë u mbajt konferenca e LKJ, në të cilën komunistët e njëzete ushtarake të gar nizonëve nga territori i KAKM e zgjedhën delegatin e vot për Kongresin IX të LKJ.

Në këso rastesh, komunistët për të zgjedhë delegatin e vot nisen nga ajo se perso në duhet të jetë pa të meta, i ndërgjegjshëm, aktiv dhe përgjegjës, si në vendin e tij të punës ashtu edhe në punë në LKJ dhe organizatë tjera shoqërore-politike, mendojë që jetë shpërndes e denjë e vijës së LKJ dhe politikës së von dit tonë, të jetë i armatosur

punon. Këtë ndër Konferenca ia beson me kënd rast një njëzite të ri - komunisti të ri dhe delegat të saj për Kongresin IX të LKJ e zgjedhi Ramadan Qehajën, nëntogër.

Ramadan Qehaja lindi më 10 shtator 1942 në fshatin Bo metocë, Kurvendri komunal i Mitrovicës, KAKM, me kom blesi - shqiptar, amëtar i LKJ prej rrorit të vitit 1960, anëtar i Konferencës së gar nizonit, në APJ, prej vitit 1960.

Se shoku Ramadan i ka të gjitha komponentët e përme timit, ma parë, tregon fakti se kjo asht mirënjohja e dy të që në ditë gjatë 12 muajve.

# NUK ËSHTË E LEHTË, POR ËSHTË E NDRERSHME PUNA E OFICERIT

Në prit e buzëqeshur në bazeën e tij majori i APJ RAMADAN QEHAJA, një mirnjohje shkurtr.

Bashkë me kafshë në edhe biseda, e tërë dhe e pasur, është ajo është edhe jeta e tij prej oficerit të djalur, në punën me ushtarëve, e cila, po tërësh, më 22 shtator të vitit të kaluar në mënyrë të jashtëzakonshme - një vit, para atëhri i sotit gradën e MAJORIT TË APJ (përkohshëm, në mënyrë të jashtëzakonshme, para atëhri e mori edhe gradën e NËNTOGËRI).



RAMADAN QEHAJA, Major i APJ

### (Kalkülizimet e babait për ushtarin)

Kus bledën e sotëm tës përkatimi i Major Ramadanit për profesionin e oficerit të APJ, nga parashkrimi i kartë recimit të tij vijetë për arreturë nga e Dija e Etnia, nënshes e klasës së kalërit të shëndetit filloren. Ai buzëqesh për atë recitim dhe flet:

— Si femja kanadur, për klasë shqiptar për ushtarë dhe jetën ushtarake. Kur nënk klasë par oficerë. Mirëpo, kanë-hë, babai gjente kohë të më frate për këto, për oficerat, për jetën në armë. Kështu të unë lindi një ëndërr, e cila më shpëtoi e parzime - të bëhesha oficer.

E më rezultat, shpë po e shëhni, kjo dëshirë e madhe.

E kreva filloren dhe, si pasmbledhjet ushtarë e regjistrova në Qilicën e miajme ushtarake të Ushtrisë Tokësore në Sarajevë më 1960. Nuk mund t'i harroj ajo ditë e para, priten e mësi që në organizatën aty. Atëherë, për jetën në armë më pengonte monejona e gjuhës serbokroatishe, mirëpo me ndihmën e shokëve, atë e përmbledha shkollë mëngjet.

Pas katër vjetësh, me gradën e rezultitë

të punon në Travnik dy vitet si oficer i ri dhe për herë të parë e ushtroja profesionit tim. Nuk mund të harrohet as ajo ditë, kur mëngjet ishte interesantë punë me ushtarët. Pasi dy vjetësh me ndihmën e shokëve të mi, u regjistruva në Akademinë Ushtarake të Ushtrisë Tokësore në Beograd, të cilën po arëta e kreva si njëri ndër kadetët më të mirë të Akademisë.

Për një kohë të shkurtër, tregon Ramadan - punon në Prishtinë e pastaj u kthye edhe një herë në Beograd, ku për dy vit e kreva Akademinë Komando-Shtabore të Ushtrisë Tokësore.

(Për sukseset - diskutora)

Pas kryerjes së klasës Akademisë në Beograd, Ramadan Qehaja u bëas nëklasë në Gërmocin e Qilicës.

Me njëzitet tim të Qilicës, thotë major Ramadan Qehaja, arrita rezultate të mëdha sidomos në gabërmënia dhe përgatitjet ushtarake në dita ushtarë.

Për këtë Ramadan u diskutua me Madhën e APJ e që i angazhimi. Kësë, në kujtohet, e shëoi edhe e përvojësja e

# NGA STËRVITJET E PJESËTARËVE TË NJËSISË SË RAMADAN QEHAJËS

## STËRVITJE E SHKËLQYESHME

Ditën e dukur pranverore, si Porositën përmbajtjen e stërvitjeve, e shfrytëzuan maksimalisht pjesëtarët e njësisë së Ramadan Qehajës për t'i përtëritur njohuritë e fituara më herët dhe për të fituar njohuri të reja nga stërvitja praktike.

Kryhen punët dhe veprimet të ndryshme taktike. Njësia eprori i së cilës është Zheko Jovanoviqi realizoi temën "Togu shqiptar në sulm". Eprori i ri Dushan Pajjevski, tash dash herë gjatë kohës së fushimit po e zbaton këtë temë. Megjithatë, thotë ai, edhe nëse ushtarët e kanë zotuar në mënyrë solide këtë temë gjithmوند mund të mësohet diçka e re e që është e rëndësishme për punën taktike të njësisë.

Paralella shqiptare e dhjetarit Fikret Ramiq veçanërisht shqihet me punë dhe stërvitje të mira. Po veçojtë emrin e Pece Spirovskit me pushkëmiraloz, të snajperistit Enes Mahmutoviq dhe shqiptarit Petar Prekeraj. Këta djem kanë kondicion të shkëlqyeshëm fizik dhe gjatë stërvitjeve, si me shaka e kapër-



Ramadan Qehaja. Bozhoviq. Ky sukses njësisë nuk i solli vetëkënaqësi, por kjo ishte

# CASTE ME PJESËTARËT E NJËSISË SË EPJORIT RAMADAN QEHAJA

## KU JANË USHTARËT - EDHE KOMANDANTI

Detyrë parëson në këtë kolektiv me përgatitje të lartë luftarake është zhvillimi i marrëdhënieve të mira ndërpersonale e ndërmjetonale, e në këtë drejtim, me angazhimin e të gjitha subjekteve, po arrihen rezultate shumë të mira, të cilat po shprehin pozitivisht në aktivitetet dhe punët e gjithmوندshme. — Duart e forta të ushtarëve, në vapë edhe dori në 40 shkallë centuzur thyenë shkëmbitje e fortë nëpër terren të vështirë malor.

Nëor vapë e madhe atë ditë rritja gradës në tërë të vështirë, ma të fortë për të punësuar, ku ushtarët e ushtarët, prorr me ushtarët e tij, që tërë dhe e angazhonte. Për këto si thotë këto komandantët dhe këto kërmi bashkë ushtarë për angazhimin e ushtarëve, besueshëm e komandantët, jone edhe me atë ushtarët e tij, që tërë dhe e angazhonte. Për këto ushtarët e tij, që tërë dhe e angazhonte. Për këto ushtarët e tij, që tërë dhe e angazhonte.

Për këtë kategoria shqiptar e ushtarëve të tij, që tërë dhe e angazhonte. Për këto ushtarët e tij, që tërë dhe e angazhonte. Për këto ushtarët e tij, që tërë dhe e angazhonte. Për këto ushtarët e tij, që tërë dhe e angazhonte.



Ramadan Qehaja



Pjesë nga shkrimet e të përditshmës së atëhershme "Rilindja" në vitet e 80-ta për aktivitetin tim në APJ.

UNIVERSITETI I PRISHTINË — UNIVERSITETI I LIGJIT  
FAKULTETI I MËSIMIT — DEPARTAMENTI I MËSIMIT

Nr. 451  
Dt. 12 V. 80

PRISHTINE — PRISTINA

M A R R V E S H T J E

**PËR MBAJTJEN E MËSIMIT TEORIK NGA LËNDA E MBROJTJES POPULLORE**

Marrëveshja e nënshkruar më dt. 1.II.1979, në mes të Fakultetit të mjekësisë Universiteti në Prishtinë (në tekstin e më tutjeshëm Fakultetit), të cilën e përfaqëson Dekani i Fakultetit Prof.dr.sci.Talat Pallaska, dhe Ramadan QAHAJA, major APJ, i lindur më 6.nëntor 1942, në Prishtinë, me banesë në Prishtinë, A<sub>3</sub>-26 (në tekstin e më tutjeshëm ligjerues).

**Neni 1.**

Fakulteti obligohet që Ligjeruesi të ja bëjë pagesën për mbajtjen e mësimit nga lënda MF studentëve të Fakultetit të mjekësisë në gjuhën shqipe, në bazë të orëve të mbajtura.

**Neni 2.**

Numri i orëve caktohet sipas plan-programit për mësim të Fakultetit, kurse pagesa do të bëhet në bazë të specifikacionit të orëve të mbajtura e që duhet të jetë nënshkruar dhe e vërtetuar nga ana e prodekanit për mësim të Fakultetit të mjekësisë në Prishtinë.

**Neni 3.**

Lartësia e kompensimit për një orë do të jetë 120,00 dinarë (një-qindnjehzetë dinarë e oo-loo), pagimi do të bëhet nga dt. 1.nëntor 1979deri në fund të vjetit shkollor 1980, për çdo muaj, nëpërmes të xhiro-llogarisë 8007-50-el-11510-5-3219.

**Neni 4.**

Ligjëruesi obligohet që studentëve të Fakultetit do të ju mbaj mësimin në gjuhën shqipe në bazë të plan-programit të Fakultetit për vitin 1979-80.

**Neni 5.**

Ligjëruesi obligohet që specifikacionin e përmendur në nenin 2. të kësaj marrëveshje të ju paraqes shërbimit për çështje studenteske në mënyrë që të bëhet pagesa.

**Neni 6.**

Marrëveshja e përpluar në 5.kopje identike prej të cilave katër i mbesin Fakultetit e një nënshkruesit të marrëveshjes.

**Neni 7.**

Në rast kontestit lidhje me aplikimin të kësaj marrëveshje është i autorizuar për kontest te Gjykata komunale në Prishtinë.

MAJOR APJ,  
Ramadan QEHAJA

PËR FAKULTETIN E MJEKËSISË  
NË PRISHTINË

FASULLI I MËRKESISE  
 OTHB RPSHP  
 Nr. 375 / 127 / 85  
 Prishtinë

Ne baze te nenit 46-61 te Rregullorës shtetëse bazat e kri-  
 teret per percaktimin e te ardhurave te pastarta, ndarjes se njete-  
 ve per te ardhura personale, konsumit te perbashket dhe te ardhurave  
 tjere, te punetoreve ne organizaten shkollore te punes se bashkuar,  
 si dhe ne baze te nenit \_\_\_\_\_ te Statutit te kesaj OTHB-je marr

**A R T I K U L I T**

Punetori-ja Neukolonel Ramadan Gheaja la kryon punet  
 dhe detyrat e Ligjilartësi MPP i caktohen 423 poena  
 ne muaj ne omer te punes dhe detyrave te caktuara.

Vlera e poenit eshte 35,50 dinare.

Te ardhurat personale sipas ketyj aktven imi duhet t'i  
 llogariten prej dates 15.2.1985 dhe ne kete aktvendim nderrohet  
 aktvendimi i separshem nr. \_\_\_\_\_ i dt. \_\_\_\_\_ per shkak  
 te gjer ne 15.2.1985 eshte paguar ne baze te oreve te mbajtura.

**A R T I K U L I T**

Ne baze te tabelës që i ka prezentuar OTHB-ja  
 Shërbimet kadrovik, shtetësit dhe kriteret te  
 cilat jane provuar ne referendun kete Kriteriume per pune dhe detyrat  
 te cilat i kryon punetori ne fjale jane shprehur ne poena permes ta-  
 belës si vijon:

- per kriteriumet e percaktuara nga nr. \_\_\_\_\_ poena
- rend.2gjer ne nr.ren.porfu.9 te tab. ....
- per koordinimin e punes..... "
- per thirrje ne arste Ligjëruesi larte 423 "
- per dygjuhesi..... "
- per pjesemarrje ne ligj..... "
- per punen e kaluar ..... "
- GJIA.SBJ..... 423 poena,

Punetori i lartpamur i parket kategorise XV  
 sipas tabelës se pergjithshme dhe shprehjes votoqeverisese.  
 Sundur ketyj aktvendimi punetori i paktanagur ka te drejte  
 te ushtroje ankese ne shikim te ushtroveve te kesaj OTHB ne afat  
 prej 30 ditesh nga dita e marrjes se tij

AKTVEGJINDI I MËRKESISE:  
 - te permendurit-es,  
 - sherb.kadrovik,  
 -sherb.finansier dhe  
 - a r k i v i t.

D E S T I N O I  
 Prof.dr Boshidar Gollakovic



## UNIVERSITETI I KOSOVES — UNIVERZITETI KOSOVA

Fakulteti i Mjekësisë — Medicinasi fakultet  
Prishtinë — Prishtina

198

Tel. 25-100 (Dekan-i)  
Tel. 25-101 (Sekretar-i)  
Tel. 20-858 (Central-a)KOSOVË — PRISHTINË  
No. 580  
10 XI-81  
127  
PRISHTINË — PRISHTINË

Ne baze te nenit 543 te LPB, te nenit 55 te Statutit te BPSHP dhe te nenit 4 te Rregullores per organizimin e brendshem dhe sistematizimin e puneve te BPSHP te Fakultetit te Mjekësisë, duke zbatuar vendimin e Keshillit punetoreve te ketij fakulteti te dt. 6. nentor 1981, leshoi kete

## A K T V E N D I M

I. Ramadan QAHAJA, major i APJ, nga Prishtina, emerohet ligjerues i larte i lendes mesimor, Mbrotjtja popullore I dhe II ne gjuhen shqipe.

II. Te emruarit, ne emer te te ardhurave personale per ligjerim te rregullt te lendes se MP I dhe II ne gjuhen shqipe i percaktohen nga 423 poena ne muaj .

III. Ky aktvendim zbatohet prej dt. 6. nentor 1981, dhe e zavendeson aktin e meparshem per angazhim dhe pagese.

## A r s y e t i m i

I emeruari eshte paraqitur ne konkursin e rregullt per aresimtare te MPP I dhe II ne gjuhen shqipe ; ne proceduren e zbatimit te konkursit, Komisioni per kuadre e zhvillim i fakultetit, nga katedra per mbrotjtjen e pergjithshme popullore, per te emeruarin morri mendim afirmativ per ta emeruar aresimtar te kesaj lende. Komisioni i ka propozuar Keshillit te aresimtareve te Fakultetit qe i emeruari te zgjidhet per ligjerues te larte te mbrotjtjes se pergjithshme popullore I dhe II ne gjuhen shqipe, te cilen propozim Keshilli ne fjale e ka miratuar dhe te njejtin ja ka percjellur Keshillit te punetoreve te Fakultetit, i cili ne seance e II te rregullte te dt. 6 nentor 1981, majorin e APJ Ramadan QAHAJEN e meroi ligjerues te larte te MP I dhe II per mesim te rregullt ne gjuhen shqipe.

Nd aj, ne baze te nenit 543 te Ligjit mbi punen e bashkuar, te nenit 55 te Statutit te Fakultetit dhe te nenit 4 te Rregullores mbi organizimin e sistematizimin e puneve te BPSHP, duke u zbatuar vendimi i Keshillit te punetoreve te Fakultetit, i dt. 6 nentor 1981, u muarr ky Aktvendim.

2.-

Te ardhurat personale ne emer te ushtrimit te Rregullt te detyres se ligjeruesit te larte ~~te~~ mbrojtjes se pergjithshme popullore I dhe II ne gjuhen shqipe te emeruarit i jane percaktuar sipas nenit 46 a te Marreveshjes veteqeverisese per ndryshimet dhe plotesimet e marreveshjes veteqeverisese per fitimin e te ardhurave dhe sistemin e tyre si dhe per ndarjen e te ardhurave personale te punetoreve te ketij Fakulteti, e cila eshte miratuar me 6 mars 1979, ndersa emerimi i tij eshte bere sipas nenit 88 te Ligjit mbi shkolimin e larte dhe nenit 262 te Statutit te ketij Fakulteti.

Kunder ketij aktvendimi pala e paknaqur mund t'i ushtroi ankese Keshillit punetoreve te Fakultetit te Mjekesise te Universitetit te Kosoves ne Prishtine, ne afatin 15 ditesh prej dorezimit te tij. Ky aktvendim i dorezohet te emeruarit, prodekanit per mesimi e ceshtje shkencore, sherbimit per kadro, arkes dhe arkivit te BPSHP te Fakultetit.

SEKRETARI,

Mr. Riza SMAKA

*R. Smaka*

**UNITED NATIONS**United Nations Interim  
Administration Mission in  
Kosovo**UNMIK****NATIONS UNIES****NATIONS UNIES**  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies au  
Kosovo**RAMADAN QEHAJA****FLETË EMËRIM**

Sipas autorizimit i cili më është dhënë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe në mbështetje të Rregullores 1999/8 emëroj Ramadan Qehajën për Komandant të Akademisë së Liderëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK).

Si anëtar i lartë i TMK-së, ju keni besim të madh publik dhe mbani përgjegjësi të rëndësishme për rindërtimin e Kosovës dhe për ofrimin e shërbimeve emergjente për gjithë popullin e saj. Përveç kësaj, juve ju takon si një nga anëtarët themelues të TMK-së të siguroni që të gjithë anëtarët e TMK-së nën autorizimin e juaj t'iu përmbahen standardeve më të larta të sjelljes.

Oferta juaj për emërim hyn në fuqi më 21 janar 2000 dhe zgjatë për një periudhë njëvjeçare. Emërimi i përhershëm në TMK kushtëzohet me përmbushjen e kënaqshme të detyrave dhe përgjegjësi tuaja dhe nga sjellja juaj gjatë vitit të parë të emërimit. Pranimi i kësaj oferte për emërim nënkupton pranimin tuaj që t'iu përmbaheni rregulloreve dhe politikës së punës së TMK-së ashtu siç është shpallur me Rregulloren 1999/8 të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe atyre politikave të punës dhe prioriteteve të cilat mund t'i caktojë unë për të lehtësuar operacionet e TMK-së dhe ofrimin e shërbimit për banorët e Kosovës.

Me detyrat dhe përkushtimin tuaj ndaj gjithë qytetarëve të Kosovës, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, religjioze dhe bindjet e tyre, ju do të kontribuoni në mënyrë kuptimplote për një paqe të qëndrueshme dhe për zhvillimin e Kosovës. Ndiej kënaqësi që vërtetoj emërimin tuaj në këtë çast historik për Trupat Mbrojtëse të Kosovës.

Bernard Kouchner

Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm



**UNITED NATIONS**  
United Nations Interim  
Administration Mission in  
Kosovo



UNMIK

**NATIONS UNIES**  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies au  
Kosovo

**RAMADAN QEHAJA**

**LETTER OF APPOINTMENT**

By the authority granted to me by United Nations Security Council Resolution 1244 and in support of United Nations Mission in Kosovo Regulation 1999/8, I hereby appoint Ramadan Qehaja as Commander of the Leadership Academy of the Kosovo Protection Corps (KPC).

As a senior ranking member of the KPC, you have great public trust and bear significant responsibility for the rebuilding of Kosovo and for provision of emergency services to all of its people. Further, as one of the founding members of the KPC it is incumbent upon you to ensure that the highest standards of conduct are met by all KPC members under your authority.

Your offer of appointment is effective 21 January 2000 and extends for a one-year period. Permanent appointment to the KPC is conditional upon satisfactory completion of your duties and responsibilities and your conduct during this first year of appointment. Acceptance of this offer of appointment constitutes your agreement to abide by the regulations and policies of the KPC as promulgated by United Nations Mission in Kosovo Regulation 1999/8 and by such policies and priorities as I may establish to facilitate the operations of the KPC and service delivery to the residents of Kosovo.

By your duty and devotion to all persons of Kosovo regardless of ethnicity, creed or religion, you will contribute meaningfully to the lasting peace and development of Kosovo. I am pleased to confirm your appointment at this historic moment for the Kosovo Protection Corps.

A handwritten signature in dark ink, which appears to read 'Bernard Kouchner', is written over a light-colored background.

Bernard Kouchner  
Special Representative of the Secretary-General



TRUPAT E MBROJTJES SË KOSOVËS  
SHTABI I PËRGJITHSHËM  
Nr. i prot. 01/067, më 19.06.2000  
PRISHTINË

**I DEDIKOHET:** Komandantit të Akademisë së Mbrojtjes dhe Z. Rexhep Selimit.

**LËNDA:** Urdhëresë për marrjen dhe dorëzimin e detyrës.

**PËRMBAJTJA:**

Në mbështetje të kreut të shtabë, pika tre e Rregullores së Jetës së Brendshme në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës e në përputhje me qëndrimin e Bordit për vendime strategjike, lidhur me marrjen dhe dorëzimin e detyrës Komandant i Akademisë së Mbrojtjes

## U R D H Ë R O J

1. Të bëhet marrja dhe dorëzimi i detyrës së Komandantit të Akademisë së Mbrojtjes ndërmjet zotëriajve Ramadan Qehaja, i cili e dorëzon, dhe Rexhep Selimi, i cili e marr detyrën e Komandantit.
2. Marrja dhe dorëzimi i detyrës të kryhet duke filluar prej datës 19 e deri më 22 qershor 2000, në ora 1500, kur do të bëhet edhe marrja dhe dorëzimi definitiv në prezencë të Komandantit të TMK-së.
3. Komandanti, i cili e pranon detyrën, deri në afatin e lartpërmendur të njëjtit nga Komandanti i deritanishëm i Akademisë me strukturën organizative, personelin (prezentimin e vartësve) e Akademisë dhe shkallën moralo-psikologjike të tij, si dhe përgatitja për realizimin e detyrave me të cilat janë të ngarkuar, me mjetet materiale, godinat, pajisjet dhe gjendjen e tyre.
4. Komandanti i deritanishëm, pashtu, ta njohjë zotin Rexhep Selimi edhe me rregulloret, urdhëresat dhe aktet për funksionimin e Akademisë, për planin e punës si dhe deri ku ka arritur zbatimin e tyre.
5. Në përfundim të marrjes dhe dorëzimit të detyrës, të hartohet akti për marrjen dhe dorëzimin e detyrës, në të cilin të shënohet gjendja e objekteve dhe pajisjeve, ajo moralo-psikologjike e personelit, gatishmëria për kryerjen e detyrave, zbatimin e deritanishëm i planeve, urdhërave etj. dhe ky akt, i firmosur nga të dy palët, t'i dorëzohet Komandantit të TMK-së.
6. Kjo urdhëresë hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e saj i bej përgjegjës dorëzuesin dhe marrësin e detyrës.

KOMANDANTI i TMK-së  
Gjeneralkolonel  
AGIM CEKU



E punoi : G.O.  
E daktiflografoi: A.H.

**I dedikohet:**

- Komandantit të Akademisë së Mbrojtjes
- Z. Rexhep Selimit
- Arkivit



SEKRET USHTARAK

TRUPAT E MBROJTJES SË KOSOVËS  
 AKADEMIJA E MBROJTJES  
 Nr.1 prot. 744, më 29.06 2000  
 PRISHTINË

## PROCESVERBAL

Për dorëzim – pranimin e detyrës së Komandantit të Akademisë së Mbrojtjes të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Në bazë të urdhërit të Komandantit të TMK-së, numër 01/067 të datës 19.06.2000, Komandantin e ri Z. Rexhep Selimi, e njoftova me strukturën e Akademisë, personelin, gjegjësisht stafin e saj, për gjendjen e tyre morale - psikologjike, planet, urdhëresat, mjetet materiale – financiare, objektin dhe gjendjen e tij; me të arriturat e deritanishme në formimin e këtij institucioni si dhe planprogramet e shkollave, problemet dhe vështërsitë me të cilat ballafaqohet Akademia.

Posaçërisht i prezentova kompetencat, detyrat që ka komandanti si dhe metodën e deritanishme të punës.

Detyrën ia dorëzoi në gjendje të rregulltë me një stabilitet kadrovik, materialo-technik dhe financiar dhe me një kolektiv plotësisht të formuar në të gjitha aspektet.

Nga dokumentacioni i dorëzohet:

1. Plani vjetor i punës;
2. Plani mujor për muajin maj – qershor;
3. Kodi disiplinor për TMK-në;
4. Dokumentacioni për lejimin e shfrytëzimit të këtij objekti nga UNMIK-u, KFOR-i dhe Rektorati i UP-së;
5. Rregullorja e jetës së brendshme të TMK-së;
6. Urdhëresa për organizimin dhe rregullimin e jetës së brendshme në AM;
7. Detyrat për Komandantët e Zonave, gardës dhe njërive vartëse nga takimi i punës me 15.06.2000; dhe
8. Inventari dhe pajisjet në kabinetin e Komandantit sipas listës së inventarit;

### Shënim:

Ndihmesa ime edhe në të ardhmen sipas nevojës dhe kërkesave, nuk do të mungoj.

Detyrën e dorëzoi  
 Gjeneral-major

Ramadan QEHAJA

Detyrën e pranoi  
 Rexhep SELIMI

Miratoi: Komandanti i TMK-së  
 Gjeneral-Lojtnant  
 Agim ÇEKU





TRUPAT E MBROJTJES SË KOSOVËS  
SHTABI I PËRGJITHSHËM  
DEPARTAMENTI I PERSONELIT  
Nr. i prot. 08/1082/A, më 29.11.2000  
PRISHTINË

Në pajtim me listën përfundimtare të TMK-së, aktet e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës si dhe në bazë të nevojës për plotësimin me kuadra adekvat në TMK, bëj këtë:

## V E N D I M

I. Zotëri, RAMADAN QEHAJA EMROHET në detyrën SHEF I SHËRB. MBËSHITËSE NË SHP, duke filluar nga data 16.08.2000.

II. Z. RAMADAN QEHAJA, i rradhitur me shifrën 25 në strukturën zyrtare të TMK-së, është oficer aktiv i rangut të 2-të.

III. Eprori është i obliguar që gjatë shërbimit në detyrën e caktuar t'iu përmbahet të gjitha të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësiive që dalin nga aktet normative të TMK-së

IV. RAMADAN QEHAJA i caktohet grada GJENERALMAJOR i Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

V. Z. RAMADAN QEHAJA është i obliguar që të mbajë gradën në përputhje me rregulloren për bartjen e gradave.

Në korrespondim me KFOR-in, UNMIK-un dhe me organet tjera Ndërkombëtare përdoret titulli i detyrës.

Në jetën e përditshme të TMK-së dhe në opinionin kosovar përdoret grada ushtarake e cekur më lartë.

VI. Vendimi është në fuqi deri më 01.02.2001.

**I dedikohet:**

Arkivit  
Dep. të personelit  
Dosje e eprorit  
SHP/HSB



UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies  
au Kosovo

**Për : Komandantin e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës**  
Gjen.Lajtn. Agim Qeku

**Datë : 12.02. 2001**

**Prej : Departamentit të SC & GE**

Bashkëkryesuesit : Z Bislim Zyrap

Z Roland Nilson

*Boj*  
*Roland Nilson*

**Lënda : K ë r k e s ë për plotësim të vendit të punës në Departament**

Në bazë të bisedës zyrtare të dates 05.02.2001, lidhur me nevojen për plotësimin e Vedit të punës : **Oficier në politikë dhe strategji dhe udhëheqës i Sektorit për Qështje të TMK-së, Ju, drejtohem i me këtë k ë r k e s ë** që të caktoni një Oficier të Lartë nga përbërja e TMK-së për shkak të peshës dhe rëndësisë të vendit të punës në Departament.

Jemi të mendimit se për vendin e punës së lartë përmendur, mundësisht të caktohet se **Gjen.maj. Ramadan Qehaja**.

Mbesim me shpresë se do të përgjigjeni pozitivisht kërkesës sonë.

Me respekt ;



**SHTABI I PERGJITHSHEM I TMK-SË**  
**DEPARTAMENTI I PERSONELIT**  
NR.PROT. 01/327 12.02.2001  
**PRISHTINE**

Duke u bazuar në nevojën e plotsimit të vendit të punës në Departamentin e sigurisë dhe emergjencës pran UNMIK-ut si pas bisedës zyrtare të datës 05.02.2001.

## U R D H Ë R O J

**Gjeneral major Ramadan Qehaja** epror aktiv i TMK-së radhitur në detyrën e Shefit të Shërbimeve mbështetëse në SHP me numrin e PE 0025 prej datës 19.02.2001 të kaloj në Departamentin e Sigurisë dhe Emergjencës pran UNMIK-ut në detyrën e: Oficer për politik dhe strategji dhe udhëheqës i sektorit për qështje të TMK-së.

- të ardhurat personale dhe të drejtat tjera do ti realizoj në Departamentin e sigurisë dhe emergjencës.

SHP



**KOMANDANTI I SHP TÇ TMK-së**  
Gjeneral i Ejtman Agim Çeku

From: Major General A R Freer OBE

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies  
au Kosovo

Office of the KPC Coordinator

Tel: +381 (0)38 504604, Ext 4693

Mob: 00377 (0) 44 502 795

18 January 2005

Dear General Qehaja,

I write a short note to thank you very much indeed for your kind words to me and to Sally at last night's farewell party.

You were very generous in your remarks and I take it as a considerable compliment that, as the senior national staff member, you spoke about our contribution to the Office of the KPC Coordinator.

We have come a long way this year and

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

18 janar 2005

I dashur gjeneral Qehaja,

Po te shkruaj nje leter te shkurter dhe per te te falenderuar per fjalet e mira qe i thate per mua dhe Sally-in ne ahengun e mbremshem lamtumires.

Fjalet tua ishin shume fisnike dhe une e konsideroj kete si nje kompliment te larte qe ti si nje zyrtar i larte i personelit vendor fole per kontributin tone ne Z/K TMK-se.

Nje vit kemi bere rrugetin te gjate dhe une I kam çmuar keshillat tua dhe menyren se si je kujdese ti per personelin vendor.

Sikur thash mbreme viti 2005 do te jete per Kosoven nje vit skajshemrisht i rendesishem. Une sinqerisht besoj se shpresat e te gjithethe ne Kosove, pavaresisht nga perkatesia e tyre etnike, do te plotesohen. E ardhmja nuk do te jete e hapur-ajo kurre nuk eshte e tille por eshte koha qe vendoret ta marin ne duar te veta fatin e tyre.

Ju faleminderit shume per librin te cilin tashme e shikova me interesim. Kanuni i Leke Dukagjinit eshte fascinues dhe gjithmone do t'ma kujtoje kohen e kaluar me ju.

Dhe ne fund ty ty dhe familjes tende dhe gjithë personelit vendor ju deshiroj fat te mire ne te ardhmen. Qendrimi i m ketu ka qene per mua nje privilegj i pamase dhe me vjen keq qe s'mund te rri per te pare realizimin e suksesshem te punes sonte te perbashket. Shpresoj qe privilegji do t'I takoje suksesit tim.

Sinqerisht ,

Adrian Freer

Faksimil (përkthim) i një letre që më dërgoi gjenerali anglez Adrian Freer, me rastin e largimit të tij nga shefi i zyrës së koordinatorit të TMK-së pranë UNMIK-ut, e që unë isha këshillëtar i tij special në vitin 2005.





INSTITUCIONET E PËRKOSSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMËNE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

ZYRA E KRYEMINISTRIT  
URED PREMIJERA  
OFFICE OF THE PRIME MINISTER

Prishtinë, 6 Mars 2006

Z. Ramadan Qehaja  
Këshilltar Politik i Kryeministrit

*I nderuar z. Qehaja*

Duke pas parasysh ndryshimet në Qeverinë e Kosovës,

kam kënaqësinë të shprehë falënderimin tim më të lartë për bashkëpunimin që kam pasur me Ju gjatë një viti të qeverisjes sime si Kryeministër i Kosovës.

Ne kemi udhëhequr me sukses në vitin më historik të Kosovës.

Ne e kemi sjellë Kosovën nga një kaos politik që e kërcënonte në mars 2005 deri te stabilizimi, progresi dhe hapja e suksesshme e bisedave për statusin final të Kosovës. Ne e kemi mbyllur punën e Qeverisë së Kosovës me krijimin e një vizioni të qartë për realizimin e shtetit të pavarur e demokratik të Kosovës në vitin 2006.

Ne besojmë se Kosova si shtet i qytetarëve, pa dallim përkatësie etnike, fetare e gjuhësore, do të jetë faktori më i lartë i paqes e stabilitetit në Kosovë, rajon dhe më gjerë.

Ky ka qenë edhe qëllimi im parësor e përfundimtar si Kryeministër i Kosovës.

Me nderimet,

Bajram Kosumi  
Kryeministër i Kosovës



Mirënjohje që më është dhënë në vitin 1980 nga komandanti i Shkollës së Mbrojtjes Nacionale të Forcave të Armatosura të Jugosllavisë.

MBROJTJA TERRITORIALE — TERITORIJALNA ODBRANA



# LAVDATË      POHVALA

Majore  
 ÇEHAJU Bektijare BAKADANA

Për përpjekjet e jashtëzakonshme, sukseset e arritura në stërvitje, edukim, forcimin e unitetit moralno-politik dhe të gatishmërisë luftarake

Za izvanredno zalaganje, postignute uspehe u obuci, vaspitanju, jačanju moralno-političkog jedinstva i borbene gotovosti

Data 22.12.1961.g.  
 Datum

KOMANDANTI



KOMANDANT PËTO BAFK  
 General-major  
 Fadilj Çuranoli



1961 — 1981  
FAKULTETI JURIDIK NË PRISHTINË

me rastin e njëzetëvjetorit  
të themelimit dhe punës

i jep këtë

fletëmirënjohje  
*Ramadan Çehajës*



për kontribut të veçantë për zhvillimin  
dhe afirmimin e Fakultetit

Pristinë, më **11.06.** 1982



KRYETARI I PLEQËSË  
Mr. Drigolub Morociq

DEKANI I FAKULTETIT  
Prof. dr. Kurirgah Salliu

*Kurirgah Salliu*

KONFERENCA KRAHINORE E LIDHJES  
SË EPRORËVE USHTARAKE REZERVË  
TË KOSOVËS



NDAN KËTË

## PLAKETË

TË LIDHJES SË EPRORËVE USHTARAKE  
REZERVË TË JUGOSLLAVISË

### Ramadan Qehajës

*Si shenjë mirënjohjeje për kontribut të  
posaçëm në punën e LEURJ, forcimit të  
mbrojtjes së përgjithshme popullore dhe  
vetëmbrojtjes shoqërore, zhvillimit dhe  
afirmimit shoqëror të LEURJ*

Në Prishtinë  
22.12.1984.



Kryetari

*Shitko*



Mirënjohje që më është dhënë në vitin 1990 nga kryeshefi i Qendrës së Lartë shkollore në Beograd e ku unë isha ligjërues i lëndës: “Strategjia ushtarake”.



Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

355(=18)(092)

929(496.51) Qehaja, Ramadan

Qehaja, Ramadan

Të bësh një karrierë ushtarake / Ramadan Qehaja. -  
Prishtinë: Autori, 2012. – 175 f.: ilustr. me ngjyra; 21 cm.

Parathënie: f. 7-8

**ISBN 978-9951-19-063-3**





ISBN 978-9951-19-063-3



9 789951 190633